# Si mund të mbështetet nga të gjithë mësuesit edukimi për qytetari dhe të drejta të njeriut: një kornizë për zhvillimin e kompetencave

**Peter Brett, Pascale Mompoint-Gaillard dhe Maria Helena Salema**

**Kontributet nga Virgílio Meira Soares, Vedrana Spajic-Vrkasˇ,**
**Sulev Valdmaa dhe Ulrike Wolff-Jontofsohn**

**Redaktuar nga Sarah Keating-Chetwynd**

Publikimet e Këshillit të Evropës

*Opinionet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdo politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.*

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet apo të transmetohet, në cilëndo formë apo përmes cilido mjeti, elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë këtu fotokopjimin, regjistrimin, apo sistemin e ruajtjes apo të rikthimit të informatave, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Divizioni i informacionit publik dhe publikimit, Drejtoria e komunikimit dhe hulumtimit (F-67075 Strasbourg Cedex or publishing@coe.int).

Dizajni i ballinës: Departamenti për prodhim të dokumenteve dhe publikimeve (DPDP), Council of Europe Layout: Ogham/Mourreau

Publikimet e Këshillit të Evropës

http://book.coe.int F-67075 Strasbourg Cedex

ISBN 978-92-871-6555-8 ©

Këshilli i Evropës, mars 2009

Shtypur në Belgjikë

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive 4

Falënderimet 6

1. Parathënie 7

2. Hyrje 10

3. Pasqyrë përmbledhëse e kompetencave dhe e dokumentit të përgjithshëm 14

4. Grupi A: Njohuria dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ 18

5. Grupi B: aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ në klasë dhe në shkollë 32

6. Grupi C: aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ përmes partneriteteve dhe përfshirjes së komunitetit 49

7. Grupi D: implementimi dhe vlerësimi i qasjeve të EQD/EDNJ me pjesëmarrje 63

8. Resurset për grupet tjera të interesit 73

9. Konkluzion 79

10. Shtojcë 80

11. Referencat dhe resurset 83

# Përmbledhje ekzekutive

Në kontekst të fazës aktuale të programit të Këshillit të Evropës (EQD/EDNJ) të mësuarit dhe të jetuarit e demokracisë për të gjithë (2006-09), ky publikim është përgjigje ndaj objektivit kyç të forcimit të "kapacitetit për trajnim dhe zhvillim të mësuesve brenda dhe përgjatë shteteve anëtarë, si në edukim ashtu edhe në partneritet me palët nga shoqëria civile, veçmas komunitetet dhe OJQ-të".

Roli i mësuesve në promovimin e vlerave demokratike përmes mësimdhënies aktive dhe me pjesëmarrje është i pranuar gjerësisht. Me shfaqjen e trendeve shoqërore të reja, me ndërvarësinë e shtuar, dhe me ndryshimet në komunitetet lokale dhe ato në nivel global, suksesi i edukimit për qytetari demokratike (EQD) dhe edukimi për të drejtat e njeriut (EDNJ) varet në masë të madhe nga edukatorët dhe mësuesit.

Ky publikim paraqet kompetencat thelbësore që definojnë aftësitë esenciale të mësuesve në implementimin e EQD/EDNJ në klasë, si gjatë tërë mësimdhënies në shkollë ashtu edhe në komunitetin më të gjerë. Është menduar tu shërbejë të gjithë mësuesve në të gjitha fazat e edukimit (jo vetëm specialistëve të EQD/EDNJ por mësimdhënësve në të gjitha lëndët); dhe edukatorëve mësimdhënës që punojnë në institucionet e arsimit të lartë apo në institucionet tjera, në trajnimin para dhe gjatë shërbimit.

Rreth 15 kompetenca janë prezantuar dhe grupuar në katër grupe progresive që korrespondojnë me pyetjet dhe çështjet me të cilat do të ndeshen mësuesit dhe edukatorët mësimdhënës gjatë implementimit të EQD/EDNJ:

. • njohuritë dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ;
. • aktivitetet e mësimdhënies dhe të të mësuarit që bëjnë zhvillimin e EQD/EDNJ në klasë dhe në shkollë (planifikimi, menaxhimi i klasës, mësimdhënia dhe vlerësimi);
. •aktivitetet e mësimdhënies dhe të të mësuarit që zhvillojnë EQD/EDNJ përmes partneriteteve dhe përfshirjes së komunitetit (EQD/EDNJ në veprim);
. • implementimi dhe vlerësimi i qasjeve të EQD/EDNJ me pjesëmarrje.

Secili grup i kompetencave korrespondon me një kapitull, brenda të cilit kompetencat përshkruhen në hollësi dhe ilustrohen me shembuj. Lexuesi do ti gjejë grafikët e avancimit për secilën kompetencë: këta grafikë synojnë tu ndihmojnë mësuesve dhe edukatorëve në përcaktimin e nivelit me të cilin korrespondon praktika profesionale e tyre, dhe kështu ata mund të identifikojnë përmirësimet në të cilat mund të përqendrohen. Palët tjera do të gjejnë gjithashtu resurse që janë relevante për praktikën dhe implementimin e EQD/EDNJ: krijuesit e politikave, drejtorët e shkollave dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky libër mbledh së bashku vargun e pasur të materialeve të hartuara nga programi i EQD/EDNJ të Këshillit të Evropës gjatë dekadës së fundit, dhe është njëkohësisht shoqërues i tri publikimeve të tjera të rëndësishme të Këshillit të Evropës për EQD/EDNJ:

• *Mjeti për trajnim të mësuesve për edukimin për qytetari demokratike dhe për edukimin për të drejtat e njeriut* (Huddleston, T. (ed.), 2005), që paraqet rekomandimet për qeveritë dhe për autoritetet arsimore në njohjen e nevojës për qasje sistematike dhe të koordinuara ndaj trajnimit të mësuesve në fushën e EQD/EDNJ;

• *Qeverisja demokratike e shkollave* (Backman, E. dhe Trafford, B., 2007), që eksploron çështjet në nivel të shkollës si tërësi dhe të lidershipit që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ.

• *Mjeti për sigurim të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike në shkolla* (Bîrzea, C. et al., 2005), që është një dokument/vegël referimi që zbaton parimet dhe proceset e sigurimit të cilësisë për EQD/EDNJ.

Përmes drejtimit të këtyre aktiviteteve dhe sugjerimeve të propozuara në këtë publikim, shpresojmë që mësuesit do të fuqizohen për të adresuar çështjet – shpesh të vështira dhe kundërthënëse – të EQD/EDNJ, dhe për të krijuar atë mjedis të mësimdhënies që është i përshtatur në mënyrën më të mirë për edukimin e të rinjve që të bëhen qytetarë të përgjegjshëm, aktiv dhe të angazhuar të së nesërmes.

# Falënderimet

Kjo përpjekje është pikë kulmore e një pune njëvjeçare të gjenerimit të ideve, konsultimeve dhe hartimit të materialit. Prandaj, është me rëndësi të falënderohen aktorët e ndryshëm që kanë kontribuar në këtë udhëzues, si dhe rolet specifike të tyre.

Grupi origjinal i hartimit të materialit është takuar fillimisht në qershor të vitit 2007 dhe përbëhej nga Peter Brett, Virgílio Meira Soares, Maria Helena Salema, Vedrana Spajic-Vrkasˇ dhe Sulev Valdmaa.

Ndonëse nuk ishte vendosur kush do të ishte autori kryesor që në fillim, pas rundit të parë të konsultimeve grupi emëroi Peter Brett që të marrë rolin drejtues në hartimin e udhëzuesit. Pra, ai ka qenë përgjegjës për hartimin e pjesëve që nuk janë përmendur më poshtë dhe ka kryer gjithashtu rol drejtues redaktues gjatë tërë projektit.

Virgílio Meira Soares ka siguruar plotësimin me programin e arsimit të lartë të Këshillit të Evropës dhe ka hartuar pjesët që kanë të bëjnë me arsimin e lartë.

Maria Helena Salema ka hartuar kompetencat nr. 5, 9, 13 dhe 14 dhe ka qenë pjesërisht përgjegjëse për pjesët e ndryshme të udhëzuesit si dhe për sfondin teorik të hulumtimit për EQD dhe për edukimin e mësimdhënësve, dhe për zhvillimin e mësimdhënësve. Ajo ka qenë e përfshirë drejtpërdrejtë në proces gjatë tërë vitit.

Vedrana Spajic-Vrkasˇ ka kontribuar në konceptualizimin e gjithmbarshëm të udhëzuesit.

Sulev Valdmaa ka kontribuar për kompetencat nr. 1 dhe 8 dhe ka bërë lidhjen me programin trajnues Pestalozzi të Këshillit të Evropës për mësuesit edukatorë dhe për koeficientet në fushën e arsimit.

Në shtator 2008, Ulrike Wolff-Jontofsohn i është bashkuar grupit të ekspertëve dhe ka kontribuar për pjesët rreth arsimit të lartë dhe për trajnimin e mësimdhënësve para shërbimit.

Pascale Mompoint-Gaillard, pas konsultimeve të thella me grupin Pestalozzi për EQD në mars të vitit 2008, ka bërë ri-hartimin gjithëpërfshirës të udhëzuesit, si në aspekt të strukturës ashtu edhe të përmbajtjes plotësuese.

Ólöf Ólafsdóttir, Drejtues i Departamentit të shkollës dhe jashtë shkollës në Këshillin e Evropës, ka siguruar themelin e fuqishëm për të drejtat e njeriut – përfshirë këtu barazinë gjinore – për udhëzuesin. Josef Huber ka mbështetur hartimin e udhëzuesit përmes programit Pestalozzi. Heather Courant dhe Sharon Lowey kanë ofruar përkrahje të pakursyer administrative.

Dhe në fund, do të doja të falënderoj koordinatorët e EQD, rrjetit të EQD për Evropën Juglindore dhe grupin këshillëdhënës ad hoc për edukimin për qytetari demokratike (ED-EQDHR) – në veçanti, kryesuesin e tij, Reinhild Otte, që kanë dhënë përkrahje dhe këshilla të vazhdueshme dhe të vlefshme.

Do të doja të falënderoj të gjithë autorët dhe kontribuuesit. Ka qenë kënaqësi të jem përgjegjëse për këtë projekt, jo vetëm për atë që besoj se produkti final do të jetë i dobishëm, por për shkak se vet procesi ka qenë një mundësi e pasur për të punuar me edukatorë të përkushtuar, me përvojë dhe novatorë.

*Sarah Keating-Chetwynd*
*Drejtuese e ekipit të projektit dhe*
*redaktore Strasburg, dhjetor 2008*

# 1. Parathënie

Është një gjë e pranuar botërisht që roli i mësuesve në promovimin e mësimit demokratik përmes qasjeve aktive dhe me pjesëmarrje është jetik. Suksesi i edukimit për qytetari demokratike (EQD) dhe i edukimit për të drejtat e njeriut (EDNJ) varet në masë të madhe nga profesioni i mësimdhënies.

Kjo është padyshim shkaku pse ministrat e arsimit nga të 47 vendet anëtare të Këshillit të Evropës, në Deklaratën finale të tyre të konferencës së përhershme të ministrave evropian të arsimit (Stamboll, Maj 2007), kanë cituar kompetencën në qytetari si një nga pesë kompetencat për promovim të kulturës demokratike dhe kohezionit social (të tjerat janë: kompetenca ndërkulturore; kompetenca plurilinguale; përkushtimi social; perspektiva e bazuar në solidaritet; dhe multi perspektiva). Ky udhëzues është përgjigje në këtë deklaratë ministrore, dhe së këndejmi përfiton nga mbështetja e fuqishme politike.

Më 3 tetor 2008, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka shkuar një hap para duke miratuar Rekomandimin 1849 (2008) për promovimin e kulturës së demokracisë dhe të drejtave të njeriut përmes edukimit të mësuesve[1]

Asambleja ka rekomanduar, *inter alia*, që:

> Komiteti i Ministrave tu bëj thirrje të gjitha qeverive dhe autoriteteve përkatëse të shteteve anëtare që të shfrytëzojnë në dobi të tyre përvojën dhe ekspertizën e Këshillit të Evropës në këtë fushë, dhe veçmas:
>
> …
>
> 5.2. kompetencat e kërkuara për promovim të kulturës së demokracisë dhe të të drejtave të njeriut në klasë, duhet të futen në programin mësimor për edukimin e mësuesve të të gjitha lëndëve;

Në kuadër të këtyre kornizave politike, ky instrument i ri duhet parë gjithashtu në kontekst më të gjerë të punës ndërqeveritare të Këshillit të Evropës për EQD/EDNJ që nga viti 1997 dhe në përgjigje ndaj synimeve dhe objektivave kyçe të fazës aktuale të punës së Këshillit të Evropës në EQD/EDNJ – të mësuarit dhe të jetuarit e demokracisë për të gjithë (2006-09) –

> Për të forcuar kapacitetin për trajnim dhe zhvillim të mësueseve brenda dhe nëpër shtetet anëtare, si në arsim ashtu edhe në partneritet me anëtarët e shoqërisë civile, veçmas komunitetet dhe OJQ-të.[2]

Ekziston mjaft shpesh një boshllëk në shumë shtete evropiane ndërmjet politikës zyrtare dhe retorikës për EQD/EDNJ dhe praktikës në terren nëpër shkolla.[3] Një hulumtim i Eurydice ka vërejtur që përkundër faktit që edukimi për qytetari është bërë më i përhapur brenda programeve mësimore në shkolla, vetëm një numër i vendeve evropiane e kanë përfshirë atë si element i edukimit fillestar të mësuesve[4].

Një nga sfidat e identifikuara kohët e fundit është kapaciteti për të "[zhvilluar] trajnime më efektive dhe më gjithëpërfshirëse të mësuesve në nivelet para dhe gjatë shërbimit":

> Në rajonin e Evropës perëndimore ekziston një model i gjithmbarshëm i trajnimit të limituar dhe sporadik të mësuesve në lidhje me EQD/EDNJ, ku shumica e kësaj është e përgjithshme në trajnimin

---

[1] Teksti i miratuar nga Asambleja më 3 tetor 2008 (Seanca e 36-të).
[2] Këshilli i Evropës, Edukimi për qytetari demokratike dhe të drejta të njeriut, *Programi i aktiviteteve (2006-2009) "Të mësuarit dhe të jetuarit e demokracisë për të gjithë"* DGIV/EDU/CAHCIT (2006) 5, 14 mars 2006, 3.
[3] Naval, Print and Iriate (2003) *edukimi civil në Spanjë: shqyrtim kritik i politikës*, (Online) *Revista e edukimit në shkencat shoqëror*; dhe Osler e Starkey (2005). Shih "Referenca dhe resurse" në kapitullin 10.

[4] Eurydice, *Edukimi për qytetari në shkolla në Evropë*, 2005.

fillestar të mësuesve dhe opsionale në aspekt të trajnimit gjatë shërbimit. Kjo nuk përshtatet me rolin jetik të mësuesve në zhvillimin e praktikave efektive të EQD/EDNJ. Kjo parashtron pyetje serioze sa i përket aftësisë dhe efikasitetit të mësuesve për të promovuar qasje më aktive dhe me pjesëmarrje në lidhje me reformat e edukimit për qytetari në shumë vende.[5]

Ky publikim mbledh së bashku vargun e pasur të materialeve të hartuara nga programi i EQD/EDNJ të Këshillit të Evropës, dhe është njëkohësisht shoqërues i aktiviteteve/publikimeve të tjera të Këshillit të Evropës:

• edukimi i mësuesve ka qenë i rëndësishëm që nga fillimi, duke u dalluar në masë të madhe në mesin e aktiviteteve të Këshillit të Evropës në sferën e edukimit, përfshirë këtu zhvillimin dhe aranzhimin për Vitin Evropian të Qytetarisë (2005). Si pjesë e kësaj të fundit, Këshilli i Evropës ka publikuar *Mjetin për trajnim të mësuesve për edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut*,[6] që ka bërë rekomandime për qeveritë dhe për autoritetet arsimore në shtetet anëtare për të njohur nevojën për qasje sistematike dhe të koordinuara ndaj trajnimit të mësuesve në fushën e EQD/EDNJ. Teksti ka përshkruar dhe ka përmendur qasjet e praktikës së mirë në trajnimin e mësuesve para shërbimit. Ai ka kërkuar bërjen e punës shtesë në zhvillimin dhe ilustrimin me shembuj të kompetencave thelbësore në edukimin për qytetari dhe për të drejtat e njeriut për qëllimet e edukimit të mësuesve, dhe projekti në të cilin bazohet ky publikim përfaqëson një përgjigje ndaj asaj thirrjeje:

janë mu ata vet (mësuesit) që fusin në përdorim dhe shpjegojnë konceptet dhe vlerat e reja për nxënësit, lehtësojnë zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave të reja, dhe që krijojnë kushtet që u mundësojnë atyre aplikimin e këtyre shkathtësive në jetën e përditshme në shtëpi, në shkollë dhe në komunitetin lokal. [7]

• puna e grupit të autorëve mund të shihet si vëllim shoqërues i publikimit *Qeverisja demokratike e shkollave*[8], që ka shqyrtuar çështjet për shkollën si tërësi dhe të lidershipit që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ. Puna jonë për kompetencat synon të adresojë nevojat e mësuesit individual në nivel të klasës.

Sot i kushtohet mjaft vëmendje të arriturave akademike të nxënësit, por ne nuk duhet të harrojmë një rol tjetër me rëndësi të arsimit: promovimi i vlerave dhe shkathtësive sociale që janë parakusht për bashkëjetesë paqësore në shoqërinë moderne të globalizuar[9]

• "Studimi i shtrirjes së praktikës efektive në qeverisjen demokratike të shkollave në Evropë" [10] ka gjetur që mundësitë për pjesëmarrje të nxënësve në qeverisjen e shkollës ka pasur më tepër gjasa të jenë efektive kur ato janë të ndërlidhura ngushtë me mësimdhënien në programin formal mësimor të shkollës:

Për të nxjerrë në pah potencialin mësimor të aktiviteteve me pjesëmarrje, nxënësit duket se kanë nevojë për mundësinë për pasqyrim kritik në lidhje me atë që janë duke e mësuar nga ato aktivitete, si dhe

---

5 Bîrzea, C. et al., *Studim mbarë-evropian mbi edukimin për politikat e qytetarisë demokratike*, publikimet e Këshillit të Evropës, Strasburg, 2004.

6 Huddleston, T. (ed.), *Mjeti për trajnim të mësuesve për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut*, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2005.

7 Ibid., faqe 15.

8 Backman, E. dhe Trafford, B., *Qeverisja demokratike e shkollave*, Publikimet e Këshillit të Evropës, Strasburg, 2007.

9 Ibid., faqe 43.

10 Huddleston, T., *Nga zëri i nxënësit tek përgjegjësia e përbashkët: praktika efektive në qeverisjen demokratike të shkollave në shkollat evropiane*, Rrjeti i fondacioneve evropiane dhe Këshilli i Evropës, 22 Maj 2007, faqe 28.

të jenë në gjendje të shohin “tablonë më të gjerë” të mënyrës se si çështjet e qeverisjes demokratike në shkollë ndërlidhen me çështjet e qeverisjes demokratike përgjithësisht në botë. Kjo sugjeron për zhvillimin jo vetëm të një mjedisi me reflektim kritik brenda klasës, por edhe për mundësitë brenda klasës për të reflektuar në lidhje me standardin e praktikës demokratike brenda vet shkollës, si dhe për gjuhën dhe konceptet me të cilat ajo diskutohet.

. • *Mjeti për sigurim të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike nëpër shkolla*[11] është dokument/mjet referimi që aplikon parimet dhe proceset e sigurimit të cilësisë në EQD/EDNJ:

Për të qenë e suksesshme, shkolla duhet të mishërojë parimet e njëjta sikurse në programin mësimor për EQD.

Në fund, ky udhëzues ka përfituar nga një seri e konsultimeve. Në mars të vitit 2008, programi trajnues Pestalozzi për edukatorët mësues dhe koeficient në fushën e arsimit ka qenë instrumental në përkrahjen e procesit të zhvillimit të këtyre kompetencave të mësuesve. Ky publikim është ripunuar pas konsultimeve me rrjetin Pestalozzi të trajnuesve të mësueseve, ku përfaqësohen 14 vende evropiane dhe ka nisur të provohet në kontekste të ndryshme trajnuese në nivel nacional, përmes programit në pranverë dhe verë të vitit 2008.

Koordinatorët e EQD, që janë takuar në prill të vitit 2008 në Vjenë, kanë ofruar gjithashtu këshillat e tyre, njëlloj sikur rrjetet rajonale në Evropën Juglindore, në qershor 2008 në Zagreb, dhe rrjeti i Baltikut/Detit të zi.

[11] Bîrzea, C. et al., *Mjeti për sigurim të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike në shkolla*, Publikimet e Këshillit të Evropës, Këshilli i Evropës, 2005.

# 2. Hyrje

## 2.1. Qëllimet e udhëzuesit dhe grupit të synuar

Qëllim specifik i këtij udhëzuesi është të definojë dhe të ilustrojë me shembuj kompetencat themelore të mësuesve në EQD/EDNJ, si dhe të adresojë nevojën e mësuesit individual në nivel të klasës.

Mësuesit edukator nga Kroacia, Estonia, Anglia, Franca, Gjermania dhe Portugalia kanë punuar si një ekip me qëllim të identifikimit dhe të definimit të kompetencave kyçe të EQD/EDNJ. Ata më pas janë përpjekur të hartojnë ilustrimet me shembuj përkatës për të demonstruar si mund të përkthehen kompetencat në mjediset e ndryshme (potencialisht nëpër të 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës) për mësuesit edukator dhe praktikantët në klasë, gjatë punës në adresimin dhe zhvillimin e çështjeve për EQD/EDNJ, të shkathtësive, vlerave dhe projekteve të qytetarisë aktive në klasat e tyre.

Ky mjet është menduar të përdoret nga mësuesit dhe edukatorët mësues për plotësuar trajnimin e mësuesve para dhe gjatë shërbimit. Kompetencat nuk janë dizajnuar vetëm për specialistët e EQD/EDNJ, por synojnë të jenë relevante për të gjithë mësuesit, në fazat fillore dhe të mesme të arsimit.

Kompetencat e përmendura në këtë dokument nuk janë të detyrueshme. Ato synojnë tu ndihmojnë mësuesve dhe ofruesve të trajnimeve, dhe jo ti frikësojnë ata. Nga kompetencat nuk duhet të kihet frikë (apo të përdoren si shkop nga autoritetet). Fryma në të cilën janë dizajnuar këto kompetenca është ajo e dhënies së mundësive më të mëdha për mësuesit. Synimi është të përkrahen dhe të përmirësohen metodat e mësimdhënies dhe të mësimxënies në EQD/EDNJ dhe jo për të gjykuar. Idetë dhe udhëzimet e prezantuara këtu mund të përdoren plotësisht apo pjesërisht si material për trajnim të mësuesve. Ne presim fleksibilitet dhe përshtatje përkatëse në përdorimin e tyre në kontekstet e ndryshme nacionale, pasi që njohim faktin që shtetet e ndryshme bëjnë inkorporimin e EQD/EDNJ në sistemet e tyre nacionale të edukimit në forma të ndryshme.

## 2.2. Definicionet

### Definicionet e EQD/EDNJ janë të hapura për interpretim

Përgjithësisht, edukimi efektiv për qytetari demokratike kontribuon drejt zhvillimit të dijes së orientuar nga vlerat, shkathtësive të bazuara në veprim dhe kompetencave që përqendruara në ndryshime, që i fuqizojnë njerëzit e rinj dhe forcojnë drejtësinë sociale.

Këshilli i Evropës nënvizon rëndësinë esenciale të EQD/EDNJ për përgatitjen dhe fuqizimin e njerëzve për të jetuar dhe për të vepruar në shoqërinë demokratike. Ai nënvizon gjithashtu objektivin thelbësor të EQD/EDNJ si inkurajim dhe përkrahje për nxënësit për tu bërë qytetarë aktiv, të informuar dhe të përgjegjshëm. Ata qytetarë karakterizohen nga të qenit:

- të ndërgjegjshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si qytetarë;
- të informuar lidhur me botën shoqërore dhe politike;
- të interesuar për mirëqenien e të tjerëve;
- të qartë në opinionet dhe argumentet e tyre;
- të aftë të ushtrojnë ndikim në botë;
- aktiv në komunitetet e tyre;
- të përgjegjshëm në mënyrën e veprimit të tyre si qytetarë[12].

[12] Bîrzea, C. et al., 2005, op. cit., p. 25.

Mësuesit duhet të jenë shumë të qartë sa i përket mënyrës se si dhe pse bëjnë zhvillimin e arsyetimit logjik për EQD/EDNJ brenda konteksteve nacionale të ndryshme:

Një numër i temave, koncepteve dhe dimensioneve të lidhura janë të përbashkëta për EQD/EDNJ. Ato përfshijnë temat e: ruajtjes së një gjëje sikur që është shoqëria demokratike dhe të drejtat që lidhen me të; nocionin e pjesëmarrjes në shoqëri; përgatitjen apo ngritjen e kapaciteteve të njerëzve të rinj për pjesëmarrje aktive dhe të informuar; fokusin në përfshirjen apo në integrimin në shoqëri; koncentrimin në shoqërinë moderne; inkurajimin e partneriteteve; dhe promovimin e një perspektive ndërkombëtare …

Konceptet kyçe që rrethojnë EQD/EDNJ përfshijnë demokracinë, të drejtat, përgjegjësitë, tolerancën, respektin, barazinë, diversitetin dhe komunitetin. Këto koncepte, sikur edhe vet EQD/EDNJ, mund të kontestohen dhe të jenë problematike në kontekstet e ndryshme.

EQD/EDNJ përmban në vete edhe dimensionet e dijes dhe të të kuptuarit, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Këto dimensione janë bërë bashkë përmes qasjeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies, që kanë si synim primar formësimin dhe ndryshimin e qëndrimeve dhe të sjelljes së njerëzve të rinj gjatë jetës së tyre si persona të rritur[13].

## Shumë definicione të termit "kompetencë" janë në përdorim

Konteksti për projektin ka përfshirë gjithashtu mendimet e mëhershme lidhur me rolin dhe natyrën e kompetencave të mësuesve. Si pjesë e strategjisë së Lisbonës, Komisioni Evropian ka hartuar Parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimet e mësuesve[14]. Një numër gjithnjë në rritje i kompetencave të reja kërkohet nga mësuesit dhe këto nuk janë ekskluzivisht individuale apo definitive dhe statike. Kompetencat e reja janë zhvilluar më tej si rezultat i nevojave të reja shoqërore dhe të komunitetit që janë identifikuar në mjediset shkollore (sikur që është menaxhimi i konflikteve, përgjegjësia kulturore, ndjeshmëria ndërkulturore dhe komunikimi, perspektivat globale dhe të shumëfishta, dhe këshillimi).

Të zhvilluara fillimisht në fushën e menaxhimit, shprehjet "kompetencë", "kompetenca", "kompetencë" dhe "kompetencat " përdoren shpesh në mënyrë të këmbyeshme. Këtu nuk jemi në gjendje të artikulojmë një definicion gjithëpërfshirës të "kompetencës". Shprehja ka një mori të gjerë kuptimesh, dhe mund të kapet me shprehjet "aftësi", "zotësi", "mundësi", "efikasitet" dhe "shkathtësi". Kompetenca mund tu atribuohet individëve, grupeve shoqërore apo institucioneve "kur ato posedojnë apo përvetësojnë kushtet për arritje të synimeve specifike zhvillimore dhe për përmbushje të kërkesave të rëndësishme të paraqitura nga mjedisi i jashtëm"[15]

OECD ka bërë definimin e kompetencës si:

---

13 Kerr, D., "Qytetaria: lokale, nacionale dhe ndërkombëtare", në Gearon, L. (ed.), *Të mësuarit për të dhënë mësim për qytetarinë në shkollë të mesme*, 2003, faqe 7-8.

14 Komisioni Evropian, Drejtoria e përgjithshme e arsimit dhe kulturës, *Parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimet e mësuesve*, të prezantuara në Konferencën testuese evropiane për parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimet e mësuesve. 20-21 qershor 2005, Bruksel.

15 Weinert, Franz E., *Konceptet e kompetencës*, Instituti Max Planck për kërkime psikologjike, Munih, 1999.

> Më tepër se vetëm dije dhe shkathtësi. Ajo përfshin aftësinë për përmbushje të kërkesave komplekse, duke përdorur dhe mobilizuar resurset psiko-sociale (përfshirë këtu shkathtësitë dhe qëndrimet) në një kontekst të veçantë[16]

E-Forumi i UNESC-s për qasjet nga kompetencat, i mbajtur në vitin 2006, ka pasur si synim ofrimin e një hapësire plurale, të hapur dhe konstruktive për këmbimin ndër-rajonal të përvojave në ndryshimin dhe zhvillimin e programeve mësimore, në bazë të qasjes sipas kompetencave. Ky aktivitet tri javor i EDNJ ka qenë i bazuar në dokumentin për zhvillim të konceptit të "kompetencave të lokalizuara":

> Që sot e tutje, përtej hartimit të listave apo të regjistrave të kompetencave të de-kontekstualizuara, duhet dhënë prioritet përshkrimit të veprimit kompetent të një personi në situatën e caktuar, me qëllim të zhvillimit të qasjes së lokalizuar ndaj kompetencës.[17]

Këtu, me kompetencat thelbësore, ne kemi nënvizuar një qëndrim të përbërë nga shumë aspekte për kompetencat, që përfshin aftësitë e gjera që bashkëveprojnë në sinergji drejt objektivit të mësimdhënies së EQD/EDNJ.

Përgjithësisht, mund ti definojmë kompetencat si një qasje që përfshin aspekte si:

- dija (të dihet çfarë);
- qëndrimet dhe sjelljet (të qenit të vetëdijshëm për mënyrën si veprojmë, në kontekst dhe pse);
- prirjet (të qenit të hapur ndaj ndryshimeve, ndjenja e motivimit);
- shkathtësitë procedurale (të dihet si bëhet një gjë);
- shkathtësitë njohëse (trajtimi i informacionit, të menduarit kritik dhe analiza kritike);
- shkathtësitë e përvojës (të dihet si të reagojmë dhe si të përshtatemi në bazë të dijes së mëhershme, shkathtësitë sociale).

## 2.3. Cilat janë përfitimet nga EQD/EDNJ?

- EQD/EDNJ u ofron njerëzve të rinj dhe të rriturve mundësinë për tu përfshirë në çështjet bashkëkohore që u interesojnë atyre;
- EQD/EDNJ inkorporon shumë forma aktive të mësimit dhe mundësi për të rinjtë dhe të rriturit për të diskutuar dhe debatuar për çështjet kundërthënëse;
- mësimdhënia për EQD/EDNJ është kënaqësi. Klasat dhe ambientet mësimore jashtë klasës gumëzhijnë nga idetë, opinionet dhe pasioni;
- çfarë është më e rëndësishme se sa të mundësohet që njerëzit në nivel lokal, nacional dhe global të bashkëjetojnë në paqe dhe bashkëpunim? EQD/EDNJ është një formë e edukimit të "të ardhmes" (të rinjtë që mendojnë në mënyrë aktive se si mund ta bëjnë botën një vend më të mirë);
- EQD/EDNJ siguron mundësi natyrore dhe "reale" për njerëzit e rinj (si dhe për mësuesit dhe të rriturit tjerë) që të "bëjnë ndryshim" dhe të lobojnë për ndryshim;
- EQD/EDNJ është e rrënjosur në nocionet e përfshirjes së komunitetit – njerëzit e rinj dhe mësuesit mund të angazhohen në dialog me partnerët përtej portës së shkollës;
- EQD/EDNJ krijon hapësirë brenda programit mësimor për tu mundësuar të rinjve që të mësojnë

[16] OECD, "Definimi dhe përzgjedhja e kompetencave kyçe", publikimet DeSeCo, 2005, www.oecd.org/dataoecd/47/61/35070367.pdf.

[17] ORE (Observatoire des Reformes en Education), Rishikimi i konceptit të kompetencës si një parim organizues për programet e studimit: nga kompetenca në veprim kompetent, Montreal, 2006.

më tepër për çështjet si ligji, të drejtat e njeriut, si dhe çështjet politike e mjedisore që ndryshme nuk do të gjenin vend në mësimet e tyre;

. • EQD/EDNJ ofron mundësi për të marrë një qëndrim pozitiv ndaj forcave negative në shoqëri (për shembull, racizmi, stereotipat në media dhe perceptimet e gabuara lidhur me migrimin global);

. • EQD/EDNJ u mundëson të gjithë mësuesve (cilado që të jetë lënda e tyre) që të lidhin mësimdhënien e tyre me temat e ndryshme – kjo ndihmon që procesi i të mësuarit të bëhet i rëndësishëm dhe relevant;

. • EQD/EDNJ mund ti fuqizojë mësuesit në kohën kur përmes presioneve të ndryshme, ata mund të ndjejnë se janë të privuar nga ndikimi, që imponohet përmes urdhrave nga lart.

## 2.4. Reagimi ndaj sfidave për implementim të EQD/EDNJ

Ekipi zhvillimor që ka punuar në këtë projekt nuk ka pasur asnjë lloj iluzioni. EQD/EDNJ është i vështirë për tu përfshirë si një element i ri i programeve mësimore në arsim. Shumica e vendeve evropiane janë përpjekur ti qasen atij përmes lëndëve të tjera ekzistuese, për shembull përmes historisë apo shkencave shoqërore.

Nuk është e domosdoshme që ky mjet që arrijë në gjykime dogmatike sa u përket meritave përkatëse të modeleve të ndryshme të programeve mësimore për EQD/EDNJ, ndonëse duhet përmendur që qasjet e programit të tërthortë shpesh kanë tendencë të jenë më të fuqishme në letër se sa që mund të vërehet në realitetin e klasës, ku edukimi për qytetari mund të jetë i nënkuptuar, fragmentar apo iluzor[18]. Rezultatet shpesh nuk kanë arritur ti përmbushin pritjet dhe këto përpjekje po braktisen gradualisht në dobi të një qasjeje më të fokusuar: për shembull, edukimi diskret për qytetari me një program mësimor të definuar, një qasje ndër-disiplinore më origjinale, mësimdhënie të bazuar në projekt, projekte të qytetarisë aktive, ditë/javë të pasurimit të fokusuara në temat e veçanta të EQD/EDNJ, apo vërtetë me një kombinim të pasur të këtyre qasjeve.

Ndërsa mësuesit janë specialistë për lëndët e tyre – për shembull, historianët, gjeografët dhe shkencëtarët – ata janë gjithashtu shumë më tepër se kaq. Të gjithë mësuesit duhet të jenë në gjendje të konsiderojnë bazën e lëndëve të tyre, tu qasen në mënyrë kritike, të bëjnë lidhjet me fushat dhe sferat tjera si qytetaria, dhe të studiojnë dobinë shoqërore të tyre, relevancën dhe raportin me kulturën bashkëkohore, duke promovuar tolerancën, çështjet e barazisë, diversitetin si një pasuri kolektive dhe respektin për dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut.

---

18 Për shembull, shih Bolivar, *Non scholae sed vitae discimus: limites y problemas de la transversalidad [Limitet dhe problemet e qasjes së programit të tërthortë] Revista de Educacion*, 309, pp. 23-65, Enero-Abril 1995.

# 3. Pasqyrë përmbledhëse e kompetencave dhe e dokumentit të përgjithshëm

## 3.1. Përshkrim i shkurtër i mënyrës si dhe pse kompetencat janë grupuar në katër grupe

Pas konsultimeve me grupet e ndryshme të interesit – sikur që është rrjeti Pestalozzi i Këshillit të Evropës për trajnimin e mësuesve për EQD/EDNJ, që përfaqëson 14 shtete të ndryshme, me koordinatorët e EQD/EDNJ dhe me ekspertët që punojnë në këtë fushë – kemi identifikuar një numër total prej 15 kompetencave, përvetësimi dhe posedimi i të cilave mund të fuqizojë mësuesit në mësimdhënien e EQD/EDNJ me besim në vete dhe me efikasitet.

Këto 15 kompetenca janë grupuar në katër grupe (A, B, C dhe D) dhe korrespondojnë me pyetjet dhe me çështjet me të cilat edukatorët mësuese do të mund të ndeshen në praktikën e tyre të EQD/EDNJ. Këtu do ti përmbledhim këto katër grupe, dhe do të japim një pasqyrë të përmbledhur të 15 kompetencave, para se të hyjmë në më tepër hollësi.

| Emri i grupit | Pyetjet lidhur me të |
|---|---|
| Njohuria dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ | Çfarë mund të bëjmë? |
| Aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies që bëjnë zhvillimin e EQD/EDNJ në klasë dhe në shkollë: planifikimi, menaxhimi i klasës, mësimdhënia dhe vlerësimi | Si mund ta bëjmë atë? |
| Aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies që bëjnë zhvillimin e EQD/EDNJ përmes partneriteteve dhe përfshirjes së komunitetit: EQD/EDNJ në veprim | Me kënd mund ta bëjmë atë? |
| Implementimi dhe vlerësimi i qasjeve të EQD/EDNJ me pjesëmarrje | Si mund ta bëjmë më mirë atë? |

**Tabela 1: Katër grupet dhe kodet e tyre të ngjyrave**

Grupet janë identifikuar me një shqetësim pragmatik. Ato korrespondojnë me pyetjet të cilat mësuesit dhe edukatorët e mësuesve (trajnuesit) do t'ia bëjnë vetes gjatë implementimit të EQD/EDNJ në mjedisin profesional të tyre:

| |
|---|
| **Grupi A: "Çfarë mund të bëjmë për tu përgatitur për implementimin e EQD/EDNJ?"** |
| **Grupi B: "Si mund të implementojmë EQD/EDNJ në shkollën time?** |
| **Grupi C: "Me kënd mund ta zhvillojmë qytetarinë aktive të njerëzve të rinj?"** |
| **Grupi D: "Si mund të përmirësojmë atë që po e bëjmë tani /cili zhvillim profesional nevojitet?"** |

**Tabela 2: emërtimi i grupeve dhe pyetjet lidhur me to**

## 3.2. Si të gjeni atë që po kërkoni: struktura e dokumentit dhe kodet me ngjyra

Për secilin grup është dhënë një kod me ngjyrë si një mjet ndihmës vizual për të lehtësuar leximin dhe gjetjen e shpejtë të informacionit. Kodi i njëjtë me ngjyrë është përdorur nëpër tërë dokumentin (shih Tabelat 1 dhe 2).

Autorët kanë qenë të vendosur që ta bëjnë këtë mjet sa më praktik që është e mundur, të arritshme për vet mësuesit dhe gjithashtu për edukatorët e mësuesve në mjediset e ndryshme. Për secilin grup dhe për secilën kompetencë, kemi përvetësuar një format të ngjashëm (por fleksibil):

. • për secilin grup (Kapitujt 3, 4, 5 dhe 6): lexuesi do të gjejë një përmbledhje të shkurtër të bazës teorike me referencë në hulumtimet përkatëse, dëshmitë dhe sfondin për rekomandimet tona;
. • për secilën kompetencë (Kapitujt 3.1 deri në 3.4, 4.1 deri në 4.4, 5.1 deri në 5.4 dhe 6.1 deri në 6.4): lexuesi do të gjejë:

– definicionin e shkurtër të kompetencës;

– shembuj të mënyrave në të cilat mësuesit dhe edukatorët e mësuesve mund të ofrojnë dëshmi të përmbushjes së kompetencave të ndryshme gjatë praktikës së tyre;

– një grafik progresiv që u ndihmon mësuesve dhe trajnueseve për të identifikuar "ku kanë qenë" në raport me dijen e tyre dhe me të kuptuarit e përmbushjes së kësaj kompetence, dhe së këndejmi, "cilët mund të jenë hapat e ardhshëm të tyre".

Përveç këtij modeli të kompetencave, lexuesi do të gjejë resurse të tjera në shtojcat:

• materialet për grupet tjera të interesit: ndërsa ky dokument është i menduar për mësuesit dhe edukatorët e mësuesve, ne njohim faktin që implementimi i EQD/EDNJ nënkupton pjesëmarrjen aktive të një morie grupesh të interesit, sikur që janë krijuesit e politikave, drejtuesit e shkollave, drejtorët dhe akterët në sistemin e arsimit të lartë, për ti përmendur këtu vetëm disa prej tyre. Lexuesi do të gjejë këtu disa sugjerime për mënyrën në të cilën këto grupe të interesit mund të përdorin modelin e kompetencave të cilin e propozojmë ne, për tu bërë lehtësues të aftë të EQD/EDNJ. Grafikët progresiv, ngjashëm me grafikët që paraqiten në kapitujt për kompetencat, janë dhënë për tu ndihmuar këtyre grupeve të interesit të identifikojnë "ku qëndrojnë" në raport me përmbushjen e kompetencave nga ana e tyre dhe – së këndejmi – "cilët mund të jenë hapat e ardhshëm të tyre";

• mjetet për vetë-vlerësim: procesi i vetë-vlerësimit është sugjeruar për tu ndihmuar mësuesve dhe edukatorëve të mësuesve që të paraqesin në grafik dhe në mënyrë sistematike progresin e tyre në zhvillimin e njohurive të veta apo të nxënësve, në të kuptuarit dhe në planifikimin e EQD/EDNJ.

## 3.3. Përmbledhje e 15 kompetencave

| **Grupi A**<br>**Njohuria dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ** | **Grupi B**<br>**Planifikimi, menaxhimi i klasës, mësimdhënia dhe vlerësimi** | **Grupi C**<br>**EQD/EDNJ në veprim – Partneritetet dhe përfshirja e komunitetit** | **Grupi D**<br>**Implementimi dhe vlerësimi i qasjeve me pjesëmarrje** |
|---|---|---|---|
| **Kompetenca nr. 1**<br>**Synimet dhe qëllimet e EQD/EDNJ; dija e orientuar nga vlerat, shkathtësitë e bazuara në veprim, dhe kompetencat e përqendruara në ndryshime** | **Kompetenca nr. 5**<br>**Planifikimi i qasjeve për inkorporim të njohurive, shkathtësive, prirjeve dhe qëndrimeve e vlerave të EQD/EDNJ, në të cilat mësimi aktiv dhe angazhimi i nxënësit luan një pjesë kryesore** | **Kompetenca nr. 10**<br>**Mjedisi i mësimit që u mundëson nxënësve të analizojnë temat dhe çështjet politike, etike, sociale e kulturore apo ngjarjet në mënyrë kritike, me shfrytëzimin e informatave nga burimet e ndryshme, përfshirë këtu mediat, statistikat dhe resurset e bazuara në TIK** | **Kompetenca nr. 13**<br>**Vlerësimi i shtrirjes në të cilën nxënësit mund ta thonë fjalën e tyre për gjërat që i prekin ata dhe sigurimi i mundësive për nxënësit për të marrë pjesë në vendimmarrje** |
| **Kompetenca nr. 2**<br>**Kornizat ndërkombëtare kyçe dhe parimet që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ, dhe konceptet kyçe të EQD/EDNJ** | **Kompetenca nr. 6**<br>**Inkorporimi i parimeve dhe i praktikave të EQD/EDNJ brenda lëndëve të specializuara (programi i tërthortë i EQD/EDNJ) për të përmirësuar dijen, shkathtësitë dhe pjesëmarrjen, dhe për të kontribuar në fuqizimin e qytetarëve të rinj në një demokraci** | **Kompetenca nr. 11**<br>**Puna e përbashkët me partnerët e duhur (sikur që janë familjet, organizatat e shoqërisë civile, dhe me komunitetin e me përfaqësuesit politik) për të planifikuar dhe implementuar vargun e mundësive për angazhim të nxënësve në çështjet e qytetarisë demokratike në komunitetet e tyre** | **Kompetenca nr. 14**<br>**Modelimi i vlerave pozitive të EQD/EDNJ dhe i qëndrimeve e prirjeve që priten nga njerëzit e rinj; dhe stili demokratik i mësimdhënies, me përfshirjen e nxënësve në planifikimin dhe pronësinë mbi aktivitetet edukative** |
| **Kompetenca nr. 3**<br>**Përmbajtja e programit** | **Kompetenca nr. 7**<br>**Themelimi i rregullave të qarta** | **Kompetenca nr. 12**<br>**Strategjitë për të sfiduar të** | **Kompetenca nr. 15**<br>**Mundësia dhe vullneti për të** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **mësimor për EQD/EDNJ, që përfshin në vete dimensionet politike e ligjore; sociale e kulturore; ekonomike; dhe dimensionet evropiane e globale** | **bazë dhe i klimës së qëndrueshme të besimit, çiltërsisë dhe respektit të ndërsjellë. Menaxhimi i klasës dhe i sjelljeve njohin parimet e EQD/EDNJ me qëllim të sigurimit të etosit pozitiv në shkollë** | **gjitha format e paragjykimit dhe diskriminimit, dhe për promovim të anti-racizmit.** | **rishikuar, monitoruar dhe vlerësuar metodat e mësimdhënies dhe të mësuarit nga nxënësit, dhe shfrytëzimi i këtij vlerësimi për të mbështetur planifikimin në të ardhmen dhe zhvillimin profesional** |
| **Kompetenca nr. 4**<br>**Kontekstet e implementimit të EQD/EDNJ:**<br>**Qasjet e programit të tërthortë; kultura mbarë-shkollore; dhe përfshirja e komunitetit.** | **Kompetenca nr. 8**<br>**Vargu i strategjive dhe metodologjive të mësimdhënies – përfshirë këtu pyetjet cilësore në klasën si tërësi –**<br>**për të zhvilluar shkathtësitë e diskutimit të nxënësve, në veçanti për çështjet e ndjeshme dhe kundërthënëse** | | |
| | **Kompetenca nr. 9**<br>**Shfrytëzimi i vargut të qasjeve ndaj vlerësimit (përfshirë këtu vetë-vlerësimin e nxënësve dhe vlerësimin e shokëve/shoqeve të klasës) për të informuar dhe lartësuar progresin dhe të arriturat e nxënësve në EQD/EDNJ** | | |

**Tabela 3: Përmbledhje e kompetencave për përmirësim të EQD/EDNJ**

# 4. Grupi A: Njohuria dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ

Ky grup i kompetencave ka të bëjë me përcaktimin e asaj çfarë nënkupton EQD/EDNJ dhe me përgatitjen e themeleve të njohurive të mësuesit, për të siguruar që nxënësve do tu mbahet mësim me një ndjenjë të qartë të drejtimit. Kjo korrespondon me pyetjen "çfarë mund të bëjmë?" për implementimin e EQD/EDNJ në klasë, në shkollë dhe në komunitetin e gjerë. Mësuesit do të duan të identifikojnë përgjigjet në disa prej pyetjeve në vijim:

. • Cilat janë njohuritë dhe parimet esenciale të EQD/EDNJ?
. • Cilat janë konceptet kryesore?
• Cilat shkathtësi, vlera, qëndrime dhe prirje do të synohen të promovohen nga mësuesit gjatë planifikimit të mësimeve dhe përvojave të EQD/EDNJ?
. • Si mund të kategorizohen komponentët e programit mësimor për EQD/EDNJ në elemente të menaxhueshme për tu përshtatur më së miri me kontekstin shkollor?

## 4.1. Përmbledhje e shkurtër dhe mbështetje teorike

Të gjithë mësuesit duhet të përvetësojnë dhe të demonstrojnë njohuri dhe të kuptuar të sigurt të elementeve të mëposhtme:

**Kompetenca nr. 1: synimet dhe qëllimet e EQD/EDNJ**

Të kuptuarit e kontributit të veçantë të EQD/EDNJ, që ka si synim rritjen e dijes së orientuar nga vlerat, shkathtësitë e bazuara në veprim dhe kompetencat e përqendruara në ndryshime, që i fuqizojnë të rinjtë, dhe forcojnë drejtësinë sociale dhe lirinë demokratike.

**Kompetenca nr. 2: kornizat ndërkombëtare kyçe dhe parimet që ndërlidhen me EQD/EDNJ**

Njohuria për kornizat e zhvilluara nga sistemi i Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian mbi parimet dhe konceptet kyçe të EQD/EDNJ, që janë zhvilluar më tej përmes dialogut ndërkombëtar; përkthimi i tyre në politika nacionale, lokale dhe shkollore, si dhe për rolet profesionale të mësuesve në klasë dhe jashtë saj.

**Kompetenca nr. 3: përmbajtja e programeve të studimit të EQD/EDNJ**

Njohuria për katër dimensionet e ndërlidhura me njëra tjetrën: dimensioni politik dhe ligjor; dimensioni social e kulturor; dimensioni ekonomik; dhe dimensioni evropian dhe global. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë tek nxënësit njohuritë për qytetarinë, dhe shkathtësitë, vlerat, qëndrimet dhe prirjet për pjesëmarrje aktive, dhe ti ndërlidhin këto me aspektet e ndryshme të mësimit.

**Kompetenca nr. 4: kontekstet e ndryshme të mundura të implementimit të EQD/EDNJ**

Të kuptuarit e EQD/EDNJ si lëndë specifike shkollore; si pjesë e qasjes së programit të tërthortë;
si komponentë thelbësore të kulturës së gjithmbarshme shkollore; dhe rëndësia qendrore

e angazhimit dhe lidhjeve të komunitetit.

**Tabela 4: Grupi A – njohuria dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ**

## Sfondi teorik

Synimi i arritjes së niveleve më të larta të dijes qytetare dhe angazhimit, ka qenë në fokus të vëmendjes globale të kohëve të fundit nga ana e hulumtuesve të fushës së edukimit. Asociacioni Ndërkombëtar për Vlerësim të Arritjeve në Arsim (IEA), për shembull, ka konkluduar që "Nxënësit në shumicën e vendeve i kuptojnë vlerat dhe institucionet themelore demokratike – por thellësia e të kuptuarit është … shpesh sipërfaqësore[19]."

Ian Davies ka prezantuar argumente për një vështrim holistik të njohurive për temën e EQD/EDNJ, jo vetëm thjesht si një tërësi e fakteve të njohura, por si të kuptuar i mjaftueshëm i kornizave konceptuale, modeleve të lidhjeve, si dhe shkathtësive të nevojshme për zbërthimin e kuptimit[20]. Ai ka eksploruar natyrën e njohurive dhe të të kuptuarit të EQD/EDNJ në kontekst të edukimit të mësuesit përmes ideve të teoricienëve si Shulman[21] dhe McNamara[22]. Këta autorë kanë theksuar rëndësinë e paraqitjes së subjektit në atë mënyrë që do ta bënte atë të kuptueshme për të tjerët, veçmas për fëmijët dhe të rinjtë, për shembull me përdorimin e analogjive, ilustrimeve dhe shpjegimeve. Çelësi është ajo që mund të quhet njohuri "e aplikuar" për temën.

Njohuria dhe të kuptuarit e përmbajtjes, koncepteve, vlerave dhe të parimeve organizative të EQD/EDNJ është me rëndësi. Mësuesit që dinë më tepër për një temë, kanë gjasa të jenë më interesant, më efektiv dhe aventurierë në mënyrat në të cilat mbajnë mësim. Ata kanë më tepër gjasa të strukturojnë në mënyrë efektive mësimet individuale dhe renditjen logjike të procesit të mësimit. Ata janë në gjendje të krijojnë dhe përzgjedhin metodat e mësimdhënies/mësimnxënies dhe aktivitetet që ndihmojnë në zhvillimin e duhur të të kuptuarit tek nxënësit dhe shkathtësive të tyre. Nëse mësuesit kanë vetëm njohuri të limituara të koncepteve dhe parimeve të EQD/EDNJ, ata mund të mos jenë të vullnetshëm ti angazhojnë nxënësit në aspektet më komplekse të qytetarisë demokratike dhe të mbajnë mësimin në mënyrë didaktike, duke penguar kështu pjesëmarrjen e nxënësve dhe pyetjet, duke dështuar kështu në shfrytëzimin e përvojës së të rinjve.

Synimet dhe qëllimet e EQD/EDNJ mund të jenë radikale. Këto synime janë referuar si "ndryshim i kulturës politike"[23]. Njerëzit e rinj duhet të kuptojnë çfarë është qytetaria demokratike; ata duhet të kenë një nivel të arsyeshëm të shkrim këndimit për të kuptuar proceset politike dhe gjithashtu për të qenë në

---

19 Në Torney-Purta, J. et al., *Edukimi për qytetari në njëzet e tetë vende: njohuria dhe angazhimi qytetar në moshën katërmbëdhjetë vjeçare*, Sekretariati i IEA, Amsterdam, 2001.

20 Davies, I., "Cila njohuri e temës është e nevojshme për të mbajtur mësim për edukimin për qytetari dhe si mund të promovohet kjo? Dokument për diskutim dhe për shqyrtim nga tutorët e edukimit fillestar të mësuesve", 2003, Citized website: www.citized.info.

21 Schulman, L., "Ata që kuptojnë : rritja e dijes në mësimdhënie", *Educational Researcher*, 15, fq. 4-14, 1986.

22 McNamara, D., "Njohuria për temën dhe aplikimi i saj: problemet dhe mundësitë për edukatorët e mësuesve", *revista e edukimit për mësimdhënie*, 17 (2), fq. 113-128, 1991.

23 In Crick, B., *Edukimi për qytetari dhe mësimdhënia e demokracisë në shkolla*, raporti Crick, QCA, 1998.

gjendje të marrin vendime të informuara lidhur me dimensionet e ndryshme të qytetarisë. Së këndejmi, mësuesit duhet të promovojnë një varg të "alfabetizmave" të qytetarisë[24] në punën e tyre me njerëzit e rinj. Kemi veçuar katër lloje të "alfabetizmit": politik e ligjor; social e kulturor; ekonomik; dhe evropian e global:

• alfabetizmi politik e ligjor u referohet të drejtave dhe detyrimeve politike vis-à-vis sistemit politik dhe sundimit të ligjit. Të kuptuarit e sferës politike/ligjore nënkupton njohuritë dhe të kuptuarit e kornizave ndërkombëtare për EQD/EDNJ, të bazuara në idenë historike të vlerës së barabartë dhe të dinjitetit të të gjitha qenieve njerëzore pa marrë parasysh dallimet e tyre në aspekt të gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike apo nacionale, religjionit, apo sfondit social dhe ekonomik[25]. Mësuesit duhet të mësojnë për të drejtat e njeriut dhe për mekanizmat për mbrojtjen e tyre, si dhe të përvetësojnë shkathtësitë për aplikimin e tyre përditë. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të reflektojnë për vlerat, të zhvillojnë qëndrimet dhe të ndërmarrin veprime për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Kjo mund të duket si dije "e rëndë" dhe e thatë për tu përvetësuar nga mësuesit, por në fakt njohuria që duhet të "aplikohet" në klasë mund të mos jetë aq substanciale; për shembull, është një gjë e zakonshme që fëmijët e vegjël të marrin përsipër detyra në klasë në lidhje me dëshirat dhe nevojat, apo me të drejtat dhe përgjegjësitë;

• alfabetizmi social dhe kulturor u referohet raporteve ndërmjet individëve në një shoqëri; elementet sikur që janë vlerat e përbashkëta për ta, qëndrimet që ata i kanë për botën dhe mënyrës në të cilin ata vënë themelet e jetës së përbashkët. Mësuesit duhet të kenë njohuri për konceptet kyçe: diversiteti shoqëror, natyra dinamike e kulturës dhe identitetit, etj. Ata duhet të reflektojnë për vlerat shoqërore dhe të zhvillojnë kompetencat ndërkulturore, qëndrimet sociale dhe shkathtësitë që promovojnë përfshirjen shoqërore, anti-diskriminimin dhe anti-racizmin.

• alfabetizmi ekonomik i referohet raportit ndërmjet individëve/grupeve, dhe situatës ekonomik në një shoqëri (tregu i punës dhe i konsumit, mbrojtja sociale, paga minimale, fuqia blerëse, etj.). Mësuesit duhet të dinë dhe të kuptojnë si funksionojnë ekonomitë përfshirë këtu rolin e biznesit, të korporatave dhe të shërbimeve financiare; të drejtat dhe përgjegjësitë e konsumatorëve; raportet punëdhënës/punonjës; dhe efektet e konsumerizmit etik. Ata duhet ti angazhojnë nxënësit në nocionet e të drejtave të njeriut sikur që është e drejta për punë dhe për nivele minimale të mjeteve të jetesës;

• alfabetizmi evropian dhe global apo "qytetaria globale" mund të shihet si e veçantë. Ajo i referohet njohjes dhe promovimit të ndërvarësisë globale, çështjeve të qëndrueshmërisë dhe shqetësimeve për gjeneratat e ardhshme. Mësuesit duhet të jenë të informuar për unitetin dhe diversitetin e shoqërive evropiane, ta kuptojnë botën si komunitet global dhe të njohin implikimet politike, ekonomike, mjedisore dhe sociale të kësaj. Ata duhet të jenë në gjendje tu ndihmojnë nxënësve për të kuptuar nocionin e ndërvarësisë,duke përdorur kontekste që janë të njohura për të rinjtë dhe fëmijët.

---

24 Në Reece, P. dhe Blackall, D., "Bërja e lajmit: alfabetizmi për qytetari", http://makingnewstoday.uow.edu.au (Mars 2008). Referencat e cituara në Habermas J., *Teoria e veprimit komunikativ*, Vëllimi 1, Kembrixh, Britani e Madhe: Polity Press, 1984, Habermas, J., *Teoria e veprimit komunikativ*, Vëllimi 2, Kembrixh, Britani e Madhe: Polity Press, 1987, Luke, A., Muspratt, S., & Freebody, P. (eds), *Ndërtimi i alfabetizmave kritik: mësimdhënia dhe mësimnxënia e praktikës tekstuale*, Cresskill NJ: Hampton Press, 1997.

25 Tekstet fundamentale përfshijnë: deklaratën e OKB për të drejtat e njeriut (1948) dhe Konventën pasuese të OKB për të drejtat e fëmijës (1989); Kartën e Bashkimit Evropian për të drejtat themelore, ku theksohen të drejtat dhe liritë universale, të patjetërsueshme dhe të pandashme të njeriut, që janë ligjërisht të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare; dhe Konventën evropiane për të drejtat e njeriut (1950).

Në shumicën e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, EQD/EDNJ shihet si një parim organizativ që mbështetë synimet e programit mësimor për arsimin fillor dhe të mesëm. Është referuar si një synim i përgjithshëm edukativ që mund të lexohet në mënyra të ndryshme nëpër tërë programin mësimor dhe në struktura më të gjera të shkollës. Megjithatë, mënyra në të cilën EQD/EDNJ është përfshirë në programin mësimor mund të dallojë në masë të madhe nga një sistem arsimor në tjetrin – sipas traditave dhe koncepteve të edukimit për qytetari, shkallës së edukimit etj. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Ministrave Rek.(2002)12 mbi edukimin për qytetari demokratike, e bën të qartë që të gjitha nivelet dhe linjat e sistemit arsimor duhet të angazhohen në implementimin e EQD/EDNJ në programin mësimor, qoftë si lëndë specifike shkollore, si një lëndë të integruar në kuadër të lëndëve të tjera, apo si temë e programit të tërthortë. Rekomandimi thekson nevojën për qasje shumë-disiplinare, për të lehtësuar përvetësimin e dijes, qëndrimeve dhe shkathtësive që kërkohen për tu mundësuar njerëzve jetë të përbashkët në një shoqëri pluraliste dhe demokratike.

Varësisht nga mosha e nxënësve, faza e edukimit dhe nga organizimi i programit mësimor në vendin përkatës, edukimi për qytetari mund të ofrohet:

. • si lëndë e veçantë dhe e pavarur, që mund të jetë qoftë e detyrueshme apo opsionale;
. • si një program mësimor i integruar në një apo më tepër lëndë të ndryshme (shpesh në lëndën e historisë, studimeve shoqërore, edukimit moral dhe religjioz, etikës, filozofisë, gjeografisë dhe të gjuhës);

- apo në fund, si temë apo parim edukativ i programit të tërthortë, në mënyrë që perspektivat e EQD/EDNJ të jenë të pranishme në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar në të gjitha lëndët e programit mësimor dhe në të gjitha nivelet e edukimit, si brenda ashtu edhe jashtë shkollës.

Rreziku me këtë qasje të fundit është që një sferë e cila është menduar të shtrihet kudo, duke mbushur tërë programin mësimor, mund të përfundojë askund. Kur një fushë është përgjegjësi e të gjithëve, nganjëherë mund të bëhet përgjegjësi e askujt.

Është me rëndësi të theksohet këtu që këto qasje të ndryshme për programet mësimore nuk janë reciprokisht përjashtuese, dhe në fakt mund të përforcojnë njëra tjetrën.

## 4.2. Kompetenca nr. 1

**Kompetenca nr. 1: synimet dhe qëllimet e EQD/EDNJ**
Të kuptuarit e kontributit të veçantë të EQD/EDNJ që si synim ka rritjen e dijes së orientuar nga vlerat, shkathtësitë e bazuara në veprim dhe kompetencat e përqendruara në ndryshime, të cilat i fuqizojnë të rinjtë dhe forcojnë drejtësinë sociale e lirinë demokratike.

### 4.2.1. Përshkrimi dhe shembujt: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ mund të demonstrojnë në mënyrë specifike, për shembull, që ata:

. ➜janë të vetëdijshëm për mënyrën si janë të definuara shtrirja e njohurive dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ. Pjesa më e madhe e kurseve për edukim të mësuesve, në pjesën më të madhe të vendeve dhe të lëndëve, do të kërkojnë nga mësuesit në trajnimet e tyre që të eksplorojnë natyrën, filozofinë dhe qëllimet e edukimit, dhe për mësimdhënësit e shkollave të mesme disiplinat e tyre të specializuara të

lëndëve. Ky aktivitet është veçmas me rëndësi në kontekst të EQD/EDNJ ku në planin afatmesëm, vetëm disa prej mësuesve mund të kenë provuar vet këtë lëndë në shkollë apo në institucionet e arsimit të lartë.

➝janë në gjendje të përçojnë emocionin, shtrirjen dhe tiparet dalluese të EQD/EDNJ aktiv dhe të cilësisë së lartë

Kjo nënkupton programet trajnuese që krijojnë hapësirë, për të shqyrtuar për shembull:

. ➝pse EQD/EDNJ po i kushtohet rëndësi e shtuar në shoqërinë moderne;

. ➝çfarë roli mund të luajnë shkollat dhe mësuesit në ato zhvillime;

. ➝natyrën e definicioneve konkurruese në lidhje me EQD/EDNJ, që kanë implikime për shtrirjen dhe drejtimin e qasjeve ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies;

. ➝mundësitë dhe sfidat për EQD/EDNJ (çfarë e bën atë të jetë ndryshe?);

. ➝çfarë lloji të dijes, gjuhës, shkathtësive, vlerave, qëndrimeve e prirjeve synon ti promovojë EQD/EDNJ;

. ➝konceptet kyçe të organizimit të EQD/EDNJ;

. ➝çfarë na tregojnë hulumtimet në lidhje me EQD/EDNJ – në nivel nacional, nëpër Evropë dhe në botë.

### 4.2.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 1: synimet dhe qëllimet e EQD/EDNJ** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Nuk jeni të familjarizuar me EQD/EDNJ, me rëndësinë e tij, synimet apo qëllimet. Keni një të kuptuar të pakët të vargut të "alfabetizmave" të qytetarisë dhe si mund të zhvillohen këto në shkolla.* | **Provoni këtë:**<br>• familjarizohuni me esencën e EQD/EDNJ, me synimet dhe qëllimet e tij;<br>• qartësoni në mendjen tuaj "alfabetizmat" e ndryshme që përbëjnë EQD/EDNJ-në;<br>• mendoni për fushën tuaj të mësimdhënies dhe gjeni lidhjet me EQD/EDNJ për praktikën tuaj profesionale;<br>• vendosni cilat "alfabetizma" mund të zhvillohen nga ana juaj duke dhënë lëndën tuaj dhe programin mësimor përkatës**;**<br>• kërkoni informata për praktikën e mirë të kolegëve lokal, nacional dhe evropian në implementimin e EQD/EDNJ në mësimdhënien në klasë;<br>• filloni të mendoni rreth mënyrave për inkorporim të dijes për EQD/EDNJ të orientuar nga vlerat, të shkathtësive për EQD/EDNJ të bazuara në veprim dhe të kompetencave të EQD/EDNJ të përqendruara në ndryshime, gjatë mësimdhënies suaj |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Jeni të familjarizuar me elementet bazë të EQD/EDNJ dhe e dini në teori si mund të promovohet ai nga sistemi arsimor dhe nga politikat nacionale, por edhe më tej rrallëherë bëni inkorporimin e EQD/EDNJ në mësimdhënien tuaj.* | **Provoni këtë:**<br>• shikoni nëpër programin tuaj mësimor për të gjetur disa fusha dhe motive pjellore për temën, brenda të cilat mund ta përfshini EQD/EDNJ në mësimdhënien tuaj;<br>• përcaktoni disa caqe afatshkurtra dhe afatmesme për të zhvilluar vendin dhe statusin e EQD/EDNJ në programin tuaj mësimor dhe/apo në lëndën tuaj;<br>• gjeni në programet mësimore njësitë e përshtatshme ku do të mund të avanconi dijen e orientuar nga vlerat, të zhvilloni shkathtësitë e bazuara në veprim dhe të përfshini kompetencat e përqendruara në ndryshime;<br>• vendosni cilat do të jenë metodat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që do ti përdorni për avancim të dijes, shkathtësive dhe kompetencave të |

| | |
|---|---|
| | EQD/EDNJ;<br>• planifikoni dhe mbani disa mësime për EQD/EDNJ. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Keni përgatitur mësimet për mësimdhënie lidhur me EQD/EDNJ në klasat tuaja dhe jeni duke krijuar më tepër besim në aspekt të njohurive dhe shpjegimeve të arsyeshme për EQD/EDNJ. Megjithatë, ndjeheni të pasigurt në trajtimin e çështjeve dhe koncepteve komplekse dhe në përvetësimin e metodave më të rrezikshme dhe më 'të hapura' të mësimdhënies. Nuk jeni të sigurt sa i përket efikasitet dhe efektit të mësimdhënies suaj.* | **Provoni këtë:**<br>• jini të qartë sa u përket synimeve dhe qëllimeve tuaja me nxënësit tuaj, ndërsa bëni përfshirjen e EQD/EDNJ në mësimdhënien tuaj;<br>• përcaktoni "alfabetizmin" për qytetari të cilën synoni ta zhvilloni secilën herë;<br>• planifikoni të keni prapaveprim në lidhje me efikasitetin e mësimdhënies suaj (për shembull, qartësoni që përpara kriteret e suksesit për detyrat specifike);<br>• analizoni dhe shqyrtoni të mësuarit nga ana e nxënësve pas secilit mësim, duke bërë ndryshime sipas nevojës;<br>• kontrolloni përfshirjen e "alfabetizmave" të ndryshëm të EQD/EDNJ në mësimdhënien tuaj. |
| **Hapi 4 (i avancuar)**<br>*Keni përvetësuar njohuri të mira teorike dhe shkathtësi praktike për të mbajtur mësim për EQD/EDNJ në lëndën tuaj të caktuar. Kuptoni si zhvillohen nxënësit në "alfabetizmat" e ndryshëm të EQD/EDNJ përmes mësimdhënies suaj. Jeni në gjendje të vlerësoni arritjet e tyre sa i përket qytetarisë.* | **Provoni këtë:**<br>• ndani praktikën tuaj të mirë me kolegët në lëndët tjera;<br>• gjeni partnerë në komunitet për tu ndihmuar në zhvillimin e synimeve tuaja dhe përgatituni për implementim të projekteve të EQD/EDNJ me studentët tuaj;<br>• ndihmoni në zhvillimin e EQD/EDNJ si një qasje mbarë-shkollore dhe si pjesë e etosit të shkollës. |

## 4.3. Kompetenca nr. 2

**Kompetenca nr. 2: politikat dhe parimet ndërkombëtare kyçe që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ**

Njohuria për kornizat e zhvilluara nga sistemi i Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian mbi parimet dhe konceptet kyçe të EQD/EDNJ, që janë zhvilluar më tej përmes dialogut ndërkombëtar; përkthimi i tyre në politika nacionale, lokale dhe shkollore, si dhe për rolet profesionale të mësuesve në klasë dhe jashtë saj

### 4.3.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ mund të demonstrojnë për shembull që do të jenë në gjendje të reflektojnë në mënyrë kritike për disa prej çështjeve dhe pyetjeve në vijim:

. ➔Cilat janë idetë dhe vlerat themelore të dialogut ndërkombëtar dhe evropian?

. ➔Si funksionon sistemi ndërkombëtar dhe evropian për mbështetje dhe promovim të EQD/EDNJ? Cila është natyra e obligimeve ndërkombëtare dhe evropiane sa u përket parimeve universale të të drejtave të njeriut? Cili është dallimi ndërmjet dokumenteve ligjërisht të detyrueshme dhe atyre moralisht apo politikisht të detyrueshme?

. ➔Cilat janë rolet e posaçme të organizatave ndërkombëtare dhe evropiane, dhe i qeverive nacionale e lokale, institucioneve dhe organizatave të tjera, në përmbushjen e zotimeve ndërkombëtare dhe evropiane?

. ➔Cilat janë vlerat, politikat, parimet dhe programet kyçe ndërkombëtare dhe evropiane që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ, përfshirë këtu ato të zhvilluara nga Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës, Unioni Evropian dhe OSBE? Si janë zhvilluar ato? Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet e tyre në raport me konceptet kyçe dhe metodologjitë? Si bëhet lidhja në mes të koncepteve të ndryshme?

. ➔Si ndërlidhen politikat dhe parimet ndërkombëtare dhe evropiane të EQD/EDNJ me ndryshimet edukative në nivelet nacionale, lokale dhe institucionale, përfshirë këtu ndryshimet në trajnimin e mësimdhënësve?

. ➔Cilat janë rolet e krijuesve nacional dhe lokal të politikave, institucioneve për trajnim të mësuesve, instituteve kërkimore, institucioneve arsimore, organizatave të shoqërisë civile dhe individëve në promovimin e synimeve dhe vlerave të përbashkëta ndërkombëtare për EQD/EDNJ? Pse qytetarët individual kanë rol qendror në promovimin e vlerave dhe parimeve ndërkombëtare dhe evropiane?

. ➔Si mund të kontribuojnë mësuesit për promovimin e parimeve dhe politikave ndërkombëtare të EQD/EDNJ në shkollat dhe klasat e tyre?

. ➔Cilat janë përparësitë dhe mangësitë në promovimin e parimeve dhe politikave ndërkombëtare të EQD/EDNJ? Si mund të përmbushen këto ideale të larta përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe evropian?

## 4.3.2. Grafiku i progresit

| Kompetenca Nr. 2: politikat dhe parimet kyçe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Nuk jeni të familjarizuar me kontekstin ndërkombëtar të parimeve, politikave dhe praktikave të EQD/EDNJ. Në fakt, të gjitha këto duken të tepërta, abstrakte dhe shterpë. Jeni konfuz sa u përket roleve specifike të organizatave ndërkombëtare dhe evropiane. Parimet e OKB-së dhe konventat evropiane duken të largëta nga praktika juaj e përditshme në klasë.* | **Provoni këtë:**<br>• familjarizohuni me disa përmbledhje të përvetësueshme lehtë të dokumenteve kryesore ndërkombëtare në këtë fushë – Deklarata e OKB për të drejtat e njeriut, Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës dhe konventa evropiane për të drejtat e njeriut. Ekzistojnë përkime të konsiderueshme. Identifikoni ato që i shihni si 10 parimet kryesore që lidhen me rolin tuaj si një edukator;<br>• informohuni dhe nëse keni mundësi provoni të siguroni ndonjë trajnim në këtë fushë. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Jeni të informuar që ekzistojnë politika dhe parime ndërkombëtare lidhur me EQD/EDNJ, dhe e dini në teori si mund të promovohen ato nga politikat nacionale dhe shkollore, por edhe më tej rrallëherë bëni inkorporimin e EQD/EDNJ në mësimdhënien tuaj.* | **Provoni këtë:**<br>• gjeni se si krijuesit nacional dhe lokal të politikave janë munduar ti shndërrojnë synimet dhe vlerat e përbashkëta ndërkombëtare të EQD/EDNJ në praktikë, në kontekstin tuaj specifik? Ku mund ta shihni këtë në programin tuaj mësimor dhe në librat e mësimit?<br>• identifikoni disa aktivitete në klasë, të përshtatshme për moshën e caktuar, që mund të përdoren për të eksploruar çështjet rreth të drejtave dhe përgjegjësive. Këshilli i Evropës dhe UNICEF-i kanë zhvilluar disa resurse edukative të shkëlqyeshme për këtë në shumë prej vendeve anëtare të Këshillit të Evropës;<br>• identifikoni filmat dhe/apo fragmentet e filmave që mund të shërbejnë për të ilustruar politikat dhe parimet e EQD/EDNJ. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Jeni duke zhvilluar më tepër besim në aspekt të njohurive dhe shpjegimit logjik për EQD/EDNJ. Mësimdhënia juaj përfshin një dimension më global dhe është gjithnjë e më ndërkombëtare. E kuptoni bazën e të drejtave të njeriut të kësaj sfere. Megjithatë, jeni paksa të hutuar sa i përket mësimdhënies në lidhje me dimensionin evropian dhe mësimdhënia juaj është edhe më tej e fokusuar kryesisht në klasë.* | **Provoni këtë:**<br>• kërkoni partnerë të jashtëm dhe aleatë – për shembull, nga OJQ-të ndërkombëtare për zhvillim apo nga organizatat si Amnesty International dhe UNICEF, për tu ndihmuar juve që tu ndihmoni nxënësve të angazhohen më tepër në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut;<br>• shqyrtoni potencialin e binjakëzimit të shkollave– mund të shqyrtoni mënyrat për ta bërë këtë dhe në vendet anëtare të BE-së, identifikoni mundësitë e financimit përmes projektit Comenius;<br>• mendoni për angazhimin e grupit të një vit apo tërë shkollës në një ditë ndërkombëtare të Evropës (këto ndodhin në bazë mjaft të rregullt). Kjo do të ndihmojë në zgjerimin e të kuptuarit të kulturave dhe çështjeve të ndryshme evropiane nga ana e të rinjve, përmes angazhimit në aktivitete të ndryshme praktike dhe tërheqëse (për shembull, klasat e ndryshme mund të bëjnë hulumtime për vendet e ndryshme, të përgatisin prezantime dhe të ngrenë ekspozita si pjesë e pazarit evropian). |
| **Hapi 4 (i avancuar)**<br>*Përmes mësimdhënies suaj në klasë dhe përkushtimit më të gjerë për dimensionin ndërkombëtar, keni nisur të zhvilloni një ndjenjë të rrënjosur thellë të qytetarisë globale tek njerëzit e rinj. Njohja e politikave ndërkombëtare në lidhje me EQD/EDNJ ka ndihmuar që shkolla vërtetë të shikojë nga jashtë.* | **Provoni këtë:**<br>• merrni pjesë në iniciativat ndërkombëtare që u mundësojnë të rinjve të ndërmarrin projekte të përbashkëta përgjatë kufijve ndërkombëtarë;<br>• gjeni partnerë në komunitet që do tu ndihmojnë në zhvillimin e synimeve tuaja;<br>• angazhoni tërë stafin dhe drejtuesin e shkollës në këto iniciativa;<br>• vazhdoni të krijoni koherencë më të madhe dhe përparim në kuadër të programit mësimor të shkollës suaj, për gjërat që kanë të bëjnë me dimensionin evropian dhe global. Mendoni për mënyrën në të cilën mund të rishqyrtohen temat në nivele më të larta të vështirësisë, nga viti në vit. |

## 4.4. Kompetenca nr. 3

**Kompetenca nr. 3: përmbajtja e programeve mësimore apo planeve të studimit të EQD/EDNJ**

Njohja e katër komponentëve të ndërlidhur: dimensionin politik dhe ligjor; dimensionit social e kulturor; dimensionit ekonomik; dhe dimensionit evropian e global.
Mësuesit duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë njohuritë e nxënësëve për qytetarinë, dhe shkathtësitë, qëndrimet, vlerat dhe prirjet për pjesëmarrje aktive, dhe që të bëjnë ndërlidhjen e këtyre aspekteve të ndryshme të të mësuarit.

### 4.4.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ mund të demonstrojnë për shembull që:

. ➜kuptojnë mënyrën në të cilën njohja dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ ndikon në mësimdhënien e tyre në klasë. Kjo mund të nënkuptojë për shembull, demonstrimin e të kuptuarit të koncepteve dhe shkathtësive të EQD/EDNJ dhe njohjen e ideve të gabuara dhe gabimeve më të shpeshta të nxënësve;

. ➜mësuesit do të mund të tregojnë gjithashtu që mund të bëjnë strukturimin e mirë të informacionit, përfshirë këtu përvijimin e përmbajtjes dhe të synimeve, sinjalizimin e tranzicioneve dhe përmbledhjen e pikave kyçe me avancimin e mësimit. Ata do të jenë në gjendje të bëjnë një prezantim të qartë të përmbajtjes përreth një serie të ideve kyçe të EQD/EDNJ, me përdorimin e fjalorit të përshtatshëm për temën specifike dhe duke shfrytëzuar pyetje efektive që përshtaten me drejtimin e mësimit;

. ➜njohin nivelin në të cilin janë duke menduar nxënësit dhe si janë gjasat e tyre për përparim të njohuritë, shkathtësitë dhe pjesëmarrjen e tyre në EQD/EDNJ. Ata do të mbështesin të mësuarit nga ana e nxënësve me një ide të qartë të destinimit, duke menduar në mënyrë koherente lidhur me mbështetjen në të mësuarit e mëhershëm dhe në themelet e nevojshme për mësim dhe të arritura të mëtejme në EQD/EDNJ. Ata duhet të identifikojnë aspektet e ndryshme të të mësuarit, për shembull:

. • njohuritë dhe konceptet kyçe: konceptet e demokracisë dhe qytetarisë të drejtat dhe përgjegjësitë civile të qytetarëve (përfshirë këtu Kartën e të drejtave themelore të Unionit Evropian); të drejtat e njeriut; alfabetizmi politik; sundimin e ligjit; diversitetin social e kulturor dhe identitetet; zhvillimin e qëndrueshëm; ndërvarësinë globale; forca ekonomike që veprojnë në nivelet lokale, nacionale e globale; konsumerizmi etik; dhe proceset e pjesëmarrjes, solidaritetit dhe kohezionit social;
. • shkathtësitë: të menduarit kritik, kërkimin e të dhënave; zgjidhjen e problemeve; punën ekipore; planifikimin dhe vendimmarrjen; përdorimin e TIK për qëllime të kërkimit dhe komunikimit; vështrimin e çështjeve nga perspektivat e njerëzve të tjerë; arsyetimin racional të opinioneve dhe vendimeve; argumentimin dhe debatin; mbrojtjen e qëndrimeve; zgjidhjen e konflikteve; komunikim me shkrim dhe me gojë të ideve; rishikimin dhe vetë-reflektimin;
. • qëndrimet dhe prirjet: respekti për dallimet sociale e kulturore dhe trashëgiminë; të kuptuarit e ndërvarësisë së të drejtave dhe përgjegjësive të qytetarëve; bashkëpunimi dhe partneriteti me të tjerët; mendja e hapur; përkushtimi ndaj së vërtetës; toleranca; ndjeshmëria; respekti për diversitetin kulturor, anti-racizmi dhe drejtësia sociale; prirja për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve; përkushtimi për të bërë punë vullnetare në dobi të komuniteteve;
. • vlerat: të drejtat e njeriut (respekti për dinjitetin njerëzor, përgjegjësia për ti mbështetur të drejtat e të tjerëve); respekti për vlerat dhe praktikat demokratike – përfshirë këtu sundimin e ligjit, pluralizmin politik, liritë demokratike dhe nocionet e barazisë; gatishmëria për të menduar në mënyrë

të qëndrueshme; përkushtimi për paqe/jo-dhunë, drejtësi dhe barazi; dhe vlerësimi i angazhimit dhe i qytetarisë aktive;

- pjesëmarrja aktive: ndërmarrja e veprimeve të informuara dhe të përgjegjshme në nivele të ndryshme; votimi; përfaqësimi, lobimi, zhvillimi i fushatave dhe avokimeve.

### 4.4.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 3: përmbajtja e planeve apo programeve të studimit të EQD/EDNJ** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Keni të kuptuar të kufizuar të EQD/EDNJ, në aspekt të përmbajtjes së tij, shkallës dhe ambicies. Sigurimi i programit mësimor për EQD/EDNJ është i paplanifikuar dhe i fragmentuar. Nuk kuptoni lidhjet e mundshme që mund ti ketë EQD/EDNJ me lëndët tjera të programit mësimor. Nuk keni menduar shumë për vlerat demokratike në edukim* | **Provoni këtë:**<br>• gjeni mundësitë për të parë si duket dhe si përjetohet EQD/EDNJ i mirë, në mënyrë që të jeni komod lidhur me shpjegimin tuaj logjik për tu fokusuar më tepër në këtë temë gjatë mësimdhënies suaj. Përmes njohjes së praktikës së mirë, kontaktit me trajnuesit entuziastë apo ekspertët e jashtëm, apo përmes vizitave në shkollat tjera, mundohuni të siguroni ndjenjën e "vizionit" të EQD/EDNJ;<br>• identifikoni një fushë ku nuk keni njohuri të mjaftueshme rreth temës së EQD/EDNJ por ku ka mundësi për të zhvilluar disa plane për mësime të reja. Bisedoni për këto plane me mësuesit tjerë. Organizoni që të shihni një koleg më me përvojë se si mban mësim për një temë të ngjashme. Mbani mësimin dhe reflektoni për suksesin e tij;<br>• në planifikimin tuaj fillestar mbani mend që shkathtësitë dhe proceset e zhvillimit të EQD/EDNJ janë të rëndësishme sikur edhe njohuria. Në mënyrë të qartë caktoni prioritetet e mësimnxënies në planifikimin e mësimit tuaj. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Keni filluar të mbani mësim për disa nga elementet e EQD/EDNJ në klasën/lëndën tuaj. Keni prirje të mbështeteni në resurset e publikuara apo librat shkollor në vend se të përgatisni materialet tuaja për mësim. Edhe më tej keni disa "zbrazëti" të mëdha në njohuritë tuaja për temën – për shembull, jeni hezitues sa i përket adresimit të çështjeve dhe koncepteve politike. Keni marrë një lloj trajnimi por jeni në fazat e hershme të kalimit nga teoria në praktikë.* | **Provoni këtë:**<br>• filloni të sistemoni njohuritë për temën nga mediat – copat e prera nga gazetat apo fragmentet nga lajmet që fillojnë të ilustrojnë me shembuj çështjet, pyetjet dhe konceptet kyçe të EQD/EDNJ. Besimi juaj në njohjen e lëndës do të rritet dhe nxënësit do të çmojnë materialin në lidhje me temën;<br>• shqyrtoni në mënyrë kritike resurset nga librat shkollorë që i keni në përdorim. Çfarë funksionon dhe/apo i angazhon më tepër nxënësit? A ekzistojnë resurse të tjera të mira në internet ku mund të kyçeni – të prodhuara nga OJQ-të, organizatat bamirëse apo asociacionet që merren me çështjen? Pyesni veten si mund ti bëni aktivitet rreth EQD/EDNJ të jenë domethënëse, të paharrueshme dhe relevante për nxënësit;<br>• merrni një koncept qendror të EQD/EDNJ – sikur që është demokracia, barazia, liria apo drejtësia – dhe planifikoni mësimin apo serinë e mësimeve që u mundësojnë nxënësve të zhvillojnë të kuptuarit e këtyre ideve. Aplikoni konceptin në një çështje që është me interes për nxënësit tuaj. Sikur ju, ata mund ti konsiderojnë strukturat politike apo institucionet si "të mërzitshme" – testoni për të parë nëse mendojnë njësoj për çështjet politike. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Keni besim në vete për lëndën tuaj. Gjithnjë e më shumë, pak tema janë "të paprekshme". Rolin tuaj si mësues e shihni jo vetëm në bartjen e njohurive dhe shkathtësive të EQD/EDNJ tek nxënësit tuaj, por edhe të vlerave. Programi i EQD/EDNJ është në zhvillim e sipër në tërë shkollën, me përfshirjen në kuadër të lëndëve të ndryshme* | **Provoni këtë:**<br>• mendoni me kujdes për mënyrën në të cilën mund të përmirësoni shkathtësitë e nxënësve në EQD/EDNJ përmes aktiviteteve të planifikuara si pjesë e programit mësimor – për shembull, me rritjen e cilësisë, ashpërsisë dhe thellësisë së shkathtësive hulumtuese të nxënësve; duke shqyrtuar në mënyrë eksplicite zhvillimin e punës ekipore apo të mësimit me bashkëpunim; apo duke u ndihmuar nxënësve të arsyetojnë opinionet e tyre në mënyra gjithnjë e më të sofistikuara dhe bindëse;<br>• shfrytëzoni më mirë TIK në promovimin e të mësuarit të EQD/EDNJ, jo vetëm në hulumtimin e çështjeve por edhe në komunikimin dhe prezantimin e informatave në mënyra efektive;<br>• mendoni si mund të aplikoni dijen tuaj për aktivitetet mësimore në programin mësimor të EQD/EDNJ. |
| **Hapi 4 ( i avancuar)**<br>*Ju mund të shihni vlerën e angazhimit të nxënësve në bërjen e zgjidhjeve të informuara lidhur me mësimnxënien nga ana e tyre. EQD/EDNJ diskutohet rregullisht në takimet për lëndën dhe në takimet e tërë shkollës. Jeni gjithnjë e më të shkathtë në zhvillimin e thellësisë së kompetencave të nxënësve në aspektet e ndryshme të EQD/EDNJ.* | **Provoni këtë:**<br>• ju njihni faktin që një nga tiparet definuese kyçe të EQD/EDNJ është kapaciteti i tij për angazhim të nxënësve në adresimin e çështjeve reale dhe në përkrahjen e një lloji të "veprimit për ndryshim" (shih Kompetencën 11). Përpiquni të bëni më tepër – si një mësues individual – për të promovuar dhe angazhuar përfshirjen e komunitetit.<br>Si munden partnerët nga komuniteti të përmirësojnë përvojën e nxënësve rreth EQD/EDNJ në klasën tuaj?<br>• vazhdoni të fokusoheni në shkathtësitë tuaja për bërjen e pyetjeve, për të ndihmuar në zbërthimin e qëndrimit të nxënësëve rreth EQD/EDNJ. Kërkoni nga kolegët që të vëzhgojnë mësimdhënien tuaj si një fushë potenciale për përkrahje nga kolegët dhe për zhvillim profesional të vazhdueshëm;<br>• ndani praktikën tuaj me shkollat tjera – mendoni për binjakëzimin e shkollave – qoftë brenda vendit tuaj apo në nivel ndërkombëtar. |

## 4.5. Kompetenca nr. 4

**Kompetenca nr. 4: kontekstet e ndryshme potenciale të implementimit të EQD/EDNJ**
Të kuptuarit e EQD/EDNJ si një lëndë shkollore specifike; si pjesë e qasjes së programit të tërthortë; si komponentë thelbësore të kulturës së shkollës si tërësi, si dhe e rolit qendror të përfshirjes së komunitetit dhe të lidhjeve.

### 4.5.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë ..."

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ mund të demonstrojnë për shembull që:

. ➜kuptojnë dhe mund të ofrojnë shembuj nga përvoja e tyre, për ato që mund të karakterizohen si tri K-të e EQD/EDNJ: EQD/EDNJ në veprim përbrenda kulturës së shkollës si tërësi; EQD/EDNJ të mësuar brenda klasës së tyre si pjesë e programit mësimor; dhe EQD/EDNJ për aq sa përqafon – dhe punon në partneritet me – komunitetin jashtë klasës dhe përtej portave të shkollës;

. ➜posedojnë kompetencë profesionale për të menaxhuar sfidat e mjediseve edukative komplekse dhe për të bërë zgjidhjet e duhura në përdorimin dhe përshtatjen e strategjive të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky kapacitet profesional synon të sigurojë përvojat në klasë (dhe jashtë klasës) për të rinjtë, që bëjnë shndërrimin e parimeve të EQD/EDNJ në aktivitete specifike të të mësuarit që u përshtaten moshës, pjekurisë, aftësisë dhe nevojave të nxënësve të ndryshëm;

. ➜zgjedhin, përshtatin dhe zbatojnë metodologjitë e duhura për EQD/EDNJ;

➜kuptojnë – dhe janë në gjendje të zhvillojnë – pjesëmarrjen dhe angazhimin aktiv në shkollë dhe në komunitetin e gjerë;

. ➜aftësia e tyre profesionale duhet të ndërlidhet gjithashtu me:

. • njohurinë e tyre lidhur me mundësitë që janë në dispozicion për përfshirje;

.

• kapaciteti i tyre për të planifikuar dhe menaxhuar pjesëmarrjen aktive brenda komunitetit shkollor si dhe në komunitetin e gjerë dhe në mjedisin global.

### 4.5.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 4: Kontekstet e ndryshme të mundura të implementimit të EQD/EDNJ** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Nuk vlerësoni sa duhet faktin që ka kontekste të ndryshme të implementimit të EQD/EDNJ. Përgjithësisht kufizoheni në çështjet që kanë të bëjnë me mësimdhënien tuaj në klasë. Në këtë drejtim, ju jeni të vetëdijshëm që EQD/EDNJ ekziston dhe që përkon pjesërisht me lëndën të cilën e keni mbajtur mësim në të kaluarën.* | **Provoni këtë:**<br>• shikoni "tablonë më të gjerë". Pyesni veten si përjetohet EQD/EDNJ nga nxënësit në shkollën tuaj. Hartoni një diagram të cikleve përkuese për klasën tuaj ku shënohet mënyra e përjetimit të EQD/EDNJ nga ana e tyre në kontekstet e ndryshme. Kultura e mbarë shkollës mund të inkorporojë votimin, pjesëmarrjen në klube, "sistemet e miqve" apo aktivitetet mësimdhënëse me shokët. Cilat eksperienca nga programi mësimor po i përvetësojnë ata aktualisht? Si ndërlidhet programi mësimor me çështjet dhe shqetësimet e komunitetit? |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Keni nisur të vlerësoni faktin që EQD/EDNJ mund të jetë më efektiv kur merr parasysh çështjet dhe ngjarjet përtej klasës. Mund të shihni dobinë e inkorporimit të dimensionit të komunitetit brenda mësimdhënies suaj.* | **Provoni këtë:**<br>• identifikoni tri mënyra në të cilat mësimdhënia juaj mund të lidhet me përmbajtjen e temës së EQD/EDNJ. Tani shqyrtoni listën e mundshme të "veprimeve për ndryshime" në fq. 66. Kush mund të jetë një aleat i dobishëm në komunitet në lidhje me fushën e zgjedhur të çështjeve/njohurive për EQD/EDNJ? |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Në të kaluarën nuk keni menduar vërtetë që politikat mbarë-shkollore dhe etosi në lidhje me EQD/EDNJ kanë të bëjnë edhe aq shumë me ju. Kjo është parë si një përgjegjësi e mësuesve të vjetër dhe e drejtuesve të shkollës. Por gjithnjë e më shumë po ndërgjegjësoheni për strukturat shkollore të ndryshueshme që po u japin studentëve më shumë hapësirë për tu shprehur për gjërat nga të cilat preken ata.* | **Provoni këtë:**<br>• njihuni me strukturat ekzistuese në shkollë që u mundësojnë nxënësve shprehjen e opinioneve të tyre për çështjet me interes për ta. Në çfarë mase qëndrimet dhe idetë e nxënësve në klasën tuaj ka mundësi ti përcillen një niveli më të lartë përfaqësues? Pyesni veten nëse ka ndonjë gjë që mund ta bëni personalisht në mbështetje të një kulture më demokratike brenda shkollës suaj;<br>• vazhdoni të shikoni nëse mund të krijohen lidhje më të fuqishme dhe më koherente ndërmjet ngjarjeve në shkollë dhe përvojës së nxënësve nga programi mësimor. |
| **Hapi 4 (i avancuar)**<br>*Jeni duke zhvilluar një vizion të EQD/EDNJ duke bërë lidhjet ndërmjet politikave dhe praktikave të shkollës si tërësi, mundësive që ofrohen në klasë dhe me programin mësimor, dhe partneriteteve me komunitetin. Personalisht jeni të përfshirë në një mënyrë ose një tjetër në të tri dimensionet e EQD/EDNJ: EQD/EDNJ në veprim në kuadër të kulturës së shkollës si tërësi; EQD/EDNJ që mësohet në klasë si pjesë e programit mësimor; dhe EQD/EDNJ në masën sa ajo përfshin –dhe punon në partneritet me – komunitetin jashtë klasës dhe përtej portave të shkollës.* | **Provoni këtë:**<br>• sugjeroni që shkolla juaj të vendosë sisteme që inkurajojnë prapaveprim të rregullt nga grupet kyçe të interesit – nxënësit, kolegët mësimdhënës dhe prindërit – për mësimdhënien dhe mësimnxënien e EQD/EDNJ;<br>• shqyrtoni mënyrën si TIK mund të përmirësojë shkathtësitë e nxënësve, shfrytëzimin e përbashkët të praktikës së mirë, dhe komunikimin më të mirë me partnerët e jashtëm;<br>• shikoni nëse mund të zgjeroni nocionin e shkollës për "komunitetin", për ti përfshirë komunitetet evropiane dhe globale me të cilat mund të punoni së bashku. |

# 5. Grupi B: aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ në klasë dhe në shkollë

Ky grup i kompetencave ka të bëjë me implementimin e qasjeve të EQD/EDNJ në klasë dhe në shkollë. Ai përgjigjet në pyetjen "si mund të implementojmë EQD/EDNJ në shkollën tonë?" Mësuesit do të duan të identifikojnë përgjigjet në disa prej pyetjeve në vijim:

. • Si do të bëj planifikimin e aktiviteteve të mia për ti inkurajuar nxënësit që të lozin një rol aktiv në mësimnxënie?
. • Me cilët mësues të tjerë mund të punoj për ta futur EQD/EDNJ në lëndët e ndryshme?
. • Cilat vlera do ta orientojnë mjedisin e klasës dhe si do të punojmë bashkë si një komunitet i personave që mësojnë?
. • Sa do të ndjehem komod dhe me vetëbesim kur të kem prekur çështjet kundërthënëse?
. •Cilat janë praktikat e mira për vlerësim të nxënies së mësimit nga nxënësit dhe që mund ti shfrytëzoj në praktikën time?

## 5.1. Përmbledhje e shkurtër dhe mbështetje teorike

Të gjithë mësuesit duhet të përvetësojnë dhe të demonstrojnë njohuri të sigurt dhe të kuptuar të:

**Kompetenca nr. 5: planifikimi i qasjeve, metodave dhe mundësive të mësimit**

Planifikimi i qasjeve, metodave dhe mundësive mësimore për inkorporim të njohurive, shkathtësive, prirjeve, qëndrimeve dhe vlerave të EQD/EDNJ, ku mësimi aktiv dhe angazhimi i nxënësit luan një rol kryesor.

**Kompetenca nr. 6: Inkorporimi i parimeve dhe i praktikave të EQD/EDNJ në mësimdhënie**
Inkorporimi i parimeve dhe i praktikave të EQD/EDNJ brenda lëndëve të specializuara (programit të tërthortë të EQD/EDNJ) për të përmirësuar dijen, shkathtësitë dhe pjesëmarrjen, dhe për të kontribuar në fuqizimin e qytetarëve të rinj në demokracinë pluraliste

**Kompetenca nr. 7: themelimi i rregullave të qarta bazë për një etos pozitiv shkollor**
Themelimi i rregullave të qarta bazë dhe i klimës së qëndrueshme të besimit, çiltërsisë dhe respektit të ndërsjellë. Menaxhimi i klasës dhe i sjelljeve njohin parimet e EQD/EDNJ me qëllim të sigurimit të mësim të qëllimshëm dhe efektiv.

**Kompetenca nr. 8: zhvillimi i vargut të strategjive për lehtësim të shkathtësive diskutuese të nxënësve**

Vargu i strategjive dhe metodologjive të mësimdhënies – përfshirë këtu pyetjet cilësore në klasën si tërësi –për të zhvilluar shkathtësitë e diskutimit të nxënësve, në veçanti për çështjet e ndjeshme dhe kundërthënëse
**Kompetenca nr. 9: shfrytëzimi i serisë së qasjeve ndaj vlerësimit**

Shfrytëzimi i vetë-vlerësimit të nxënësve dhe vlerësimit të shokëve/shoqeve të klasës) për të informuar dhe lartësuar progresin dhe të arriturat e nxënësve në EQD/EDNJ

**Tabela 5: Grupi B – Aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ në klasë dhe në shkollë**

### Sfondi teorik

Shënim: Kompetencat e këtij grupi, veçmas ato me nr. 5 dhe 6, janë të lidhura ngushtë me

kompetencën Nr. 4, pasi që aktivitetet e planifikimit dhe definimi i qasjeve të programit të tërthortë kërkojnë njohuri të mira të kontekstit të implementimit të EQD/EDNJ dhe mund të arrihen vetëm përmes përpjekjeve bashkëpunuese brenda ekipeve të mësuesve. Tani do të përshkruajmë në hollësi çfarë përfshin secila nga të pesë kompetencat.

Zhvillimi i kompetencës për planifikim kërkon kohë, përkrahje, reflektim dhe punë bashkëpunuese. Në këtë mënyrë, kjo lidhet me Kompetencën nr. 4 në lidhje me kontekstin e implementimit të EQD/EDNJ: kjo nënkupton që mësuesi kupton cili "model i mbajtjes së mësimit" do të përdoret: disiplinor, ndërdisiplinor, në nivel të shkollës si tërësi apo qasja e multi perspektivës.

Planifikimi i aktiviteteve mësimore për qytetari demokratike dhe aktive është kompetencë kyçe pasi që nënkupton:

. • formulimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të objektivave të qarta të mësimit;
. • përcaktimin e fokusit të aktiviteteve mësimore, përzgjedhjen e temave dhe të orarit të mësimeve;
. • themelimin e relevancës së temës për nxënësin dhe përzgjedhjen e aktiviteteve të larmishme, të përshtatshme, të arritshme, por edhe sfiduese;
. • identifikimin e resurseve që më së miri mbështesin pjesëmarrjen aktive;
. • lejimin e prapaveprimit efektiv nga nxënësit sa u përket proceseve të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Kjo kompetencë nënkupton dizajnimin e aktiviteteve mësimore që janë të përshtatura për stilet e ndryshme të të mësuarit të nxënësve, ku nxënësit ndërtojnë domethënien dhe në mënyrë aktive mbështeten në strukturat dhe përvojat e njohurive të mëhershme të tyre për temat dhe çështjet e EQD/EDNJ[26].[26] Cilado që të jetë lënda që mësohet, mësuesi do të drejtojë pjesëmarrjen e nxënësit në planifikimin e procesit mësimor duke bërë përfshirjen e nxënësve në diskutime, duke përvetësuar kështu një pozicion të informuar dhe të hapur në lidhje me programin mësimor, metodat e preferuara të mësimdhënies, zgjedhjen e resurseve për mësim dhe mjetet e duhura të vlerësimit.

Inkorporimi i EQD/EDNJ në qasjen e programit të tërthortë synon të përmirësojë njohuritë për përmbajtjen e EQD/EDNJ përmes mësimit të lëndëve të ndryshme. Kjo është një çështje me rëndësi që meriton vëmendje nga të gjithë mësuesit. Shumë koncepte dhe fusha të përmbajtjes së EQD/EDNJ (për shembull, kontestet brenda shoqërisë civile, qëndrueshmëria mjedisore, etj) mund të materializohen nga këndet e ndryshme në programet mësimore të lëndëve të ndryshme. Mësuesit duhet të kontrollojnë planin mësimor dhe të punojnë bashkërisht për të gjetur një terren të përbashkët. Kjo është një çështje e shmangies së fragmentimit dhe e krijimit të një përvoje koherente të të mësuarit për nxënësit. Integrimi ndërmjet lëndëve bëhet gjithashtu në raport me shkathtësitë e përbashkëta. Për shembull, nëse zhvillimi i aftësisë së të shprehurit tek nxënësit si një tipar i rëndësishëm i EQD/EDNJ është synimi ynë, atëherë të gjithë mësuesit duhet të kontribuojnë për këtë qëllim. Cilat lëndë do të mund apo do të duhej të përfshiheshin është një çështje për shkollat dhe mësuesit individual.

Në praktikë, mund të jetë më mirë nëse EQD/EDNJ limitohet në një numër të menaxhueshëm të "lëndëve bartëse". Lëndë "bartëse" është ajo që ka një lloj afiniteti natyror apo që përkon në përmbajtjen e programit mësimor me EQD/EDNJ. Kandidatet më të dallueshme për statusin e "bartëses" janë lëndët e shkencave humane dhe të shkencave shoqërore – por kjo nuk do të duhej ti përjashtonte lëndët tjera si matematika, shkenca, arti dhe dizajni nga përfshirja entuziaste. Për shembull, mënyra në të cilën angazhohemi në sporte dhe qëndrimet të cilat i zhvillojmë drejt "ndjenjës së sportit" mund të jenë element "bartës" për EQD/EDNJ.

---

[26] Duerr, K., Spajic-Vrkasˇ, V. dhe Ferreira Martins, I., *Strategjitë për mësim të qytetarisë demokratike*, Këshilli i Evropës, 2000.

Menaxhimi i klasës dhe zhvillimi i rregullave themelore për një mjedis të mirë të klasës, janë parësore për EQD/EDNJ. Institucionet dhe shoqëritë demokratike kanë nevojë për më shumë se bindje të pamenduar ndaj rregullave dhe ligjeve nga anëtarët e tyre. Ato kanë nevojë për qytetarë që janë të aftë të mendojnë në mënyrë kritike dhe morale lidhur praktikat dhe institucionet e shoqërisë dhe që janë të aftë të veprojnë në mënyrë të drejtë, duke i interpretuar rregullat dhe ligjin në kontekst të vet jetëve të tyre. Bill Rogers thekson që politikat dhe metodat e sjelljes, në nivel të shkollës dhe të klasës, duhet të përmendin në mënyrë të qartë konceptet kyçe të të drejtave e përgjegjësive, dhe të drejtësisë:

> Qasja ndaj të gjitha disiplinave nga perspektiva e të drejtave të përbashkëta, rregullave dhe përgjegjësive. Kjo nënkupton që fokusi i disiplinës nuk është thjeshtë fuqia dhe autoriteti relativ i mësuesit (më shumë i fituar se sa i imponuar) por të drejtat e përbashkëta të të gjithë anëtarëve të klasës. … Është një tipar me rëndësi i disiplinës që mësuesit synojnë ti drejtojnë nxënësit që të marrin mbi vete përgjegjësi për sjelljen e tyre … duke përdorur gjuhën që thekson zgjidhjen e nxënësit në vend se kërcënimin e mësuesit[27]

Kompetenca "mësimi i çështjeve kundërthënëse" duhet të jetë një fokus të mësuesve që kanë nevojë të ndjehen aq komod dhe me vetëbesim sa të mos i shmangin ato çështje. EQD/EDNJ kërkon që të rinjtë të bëjnë këmbimin e opinioneve dhe të ideve për çështjet e jetës reale që ndikojnë në ta dhe në komunitetet e tyre (sikur që është krimi, padrejtësia, të drejtat e fëmijëve, mjedisi, etj.). Çështjet e kësaj natyre mund të jenë kundërthënëse apo të ndjeshme, apo që të dyja. Së këndejmi, mësuesit e EQD/EDNJ duhet të mësojnë si mund ti inkurajojnë të rinjtë për tu shprehur sinqerisht dhe me guxim, duke respektuar njëkohësisht qëndrimet që janë të ndryshme nga ato të tyret. Ata duhet gjithashtu të jenë të vetëdijshëm se kur ata – si mësues – kanë të drejtë të shprehin qëndrimet e tyre për një çështje kundërthënëse.

Në trajtimin e çështjeve kundërthënëse në mënyra të strukturuara dhe të ndjeshme, mësuesit mund ta konsiderojnë të dobishme listën kontrolluese të pyetjeve si më poshtë:

- Cilat janë tiparet dhe degëzimet kryesore të çështjes?
- Sa jemi të bindur ne për saktësinë e informatave?
- Cilat grupe janë të përfshira në çështjen?
- Cilat janë interesat dhe vlerat e këtyre grupeve?
- Si, ku dhe nga kush mund të trajtohen këto çështje?
- Cilat opsione të tjera kanë ekzistuar?
- Si mund/duhet të binden njerëzit që të veprojnë apo ti ndryshojnë qëndrimet e tyre?
- Si mund të ndikojmë ne në përfundimin – si ndikon ai në ne?

Vlerësimi i të mësuarit të nxënësve përfshin përdorimin e një vargu qasjesh ndaj vlerësimit për të mësuarit në kontekstet e EQD/EDNJ. Ka mjaft debate sot lidhur me çështjen e vlerësimit. Në vitet e fundit, komuniteti edukativ ka peshuar të mirat e vlerësimit sumativ kundrejt atij formativ[28]. Qasjet me pjesëmarrje janë të përshtatshme, sikur që janë vetë-vlerësimi i nxënësit dhe vlerësimi i shokëve/shoqeve, me qëllim të informimit dhe lavdërimit të progresit dhe arritjeve të nxënësit në njohuritë, shkathtësitë dhe pjesëmarrjen aktive në EQD/EDNJ. Nuk ka ndonjë "plan" për mënyrën e ndërtimit dhe të implementimit të vlerësimit. Sido që të jetë, qasjet mund të kombinohen, mjetet

---

[27] 27. Rogers, B., *Gjuha e disiplinës: një qasje praktike ndaj menaxhimit efektiv të klasës*, Northcote House Publishers, Plymouth, 1994, fq. 14-15.

[28] Black, P. et al., *Vlerësimi për mësim: vënia e tij në praktikë*, Open University Press, Nju Jork, 2003.

efektive të koordinimit dhe vlerësimi i progresit të nxënësit – cilësia e të mësuarit të tyre – duhet të përfshihen në të gjitha dispozitat. Të mësuarit e nxënësve do të përfitojë nga prapaveprimi i menduar mirë.

Mund të ketë shqetësime legjitime në shumë vende evropiane që një qasje tepër rigjide ndaj vlerësimit të EQD/EDNJ rrezikon mbytjen e shpirtit të projekteve aktive dhe angazhuese të EQD/EDNJ, që ndërmerren nga të rinjtë. Ky rrezik rritet nëse përvetësohen qasjet "sumative" dhe strategjitë e "vlerësimit të mësimit". Në anën tjetër, strategjitë e "vlerësimit për mësim" mund të jenë potencialisht në plan të parë në punën e EQD/EDNJ, ndonëse kjo qasje është përvetësuar vetëm pjesërisht nga vendet dhe shkollat nëpër Evropë. Një studim nga viti 2003 ka definuar "vlerësimin për mësim" si: "Proces i kërkimit dhe interpretimit të provave për shfrytëzim nga nxënësit dhe mësuesit e tyre, për të vendosur ku janë nxënësit në mësimet e tyre, ku duhet të shkojnë dhe cila është mënyra më e mirë për të arritur atje."[29] Qasja thekson ndarjen e objektivave të mësimit dhe kriteret e suksesit me të rinjtë dhe nënvizon vlerën e përfshirjes së nxënësve në proceset e vetë-vlerësimit dhe të vlerësimit të moshatarëve të tyre.

## 5.2. Kompetenca nr. 5

**Kompetenca nr. 5: planifikimi i qasjeve, metodave dhe mundësive për mësim**
Planifikimi i qasjeve për inkorporim të njohurive, shkathtësive, prirjeve, qëndrimeve dhe vlerave të EQD/EDNJ, në të cilat të mësuarit aktiv dhe angazhimi i nxënësve luajnë një rol kryesor

### 5.2.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ mund të demonstrojnë për shembull që:

. ➜janë në gjendje të zgjedhin dhe të planifikojnë aktivitete të përshtatshme të të mësuarit, që do të zhvillohen brenda konteksteve të ndryshme të mësimit të EQD/EDNJ: për shembull, në kontekst të lëndës shkollore specifike apo në kontekstin e programit të tërthortë, me zgjedhjen e temave specifike që në mënyrë specifike mund të vënë në plan të parë njohuritë dhe proceset e EQD/EDNJ. Për shembull: Synimet e Mijëvjeçarit të OKB-së do të mund të ishin tema për qasje mbarë-shkollore, apo një ditë e fokusuar jashtë kalendarit, e mbushur me mësime dhe aktivitete; energjia nukleare do të mund të mësohej në lëndën e fizikës, me përfshirjen e komponentëve të EQD/EDNJ;

. ➜dinë si të planifikojnë radhën e mësimeve për të siguruar avancimin e mësimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, në mënyrë të përshtatur me programin mësimor të shkollës dhe me referencë të tërthortë në objektivat mësimore me disiplinat tjera, i kuptojnë perspektivat e disiplinave të tjera, dhe bëjnë planifikimin e aktiviteteve në mënyra të strukturuara dhe kohezive;

. ➜kanë njohuri dhe stile njohës, dhe janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e mësimdhënies në mënyra që u përgjigjen stileve të ndryshme të të mësuarit: për shembull, qasjet e shqisave të shumëfishta për tu shërbyer nevojave vizuale, kinestetike, verbale dhe të dëgjimit të nxënësve në klasë; të mësuarit bashkëpunues/konkurrues; komunikimin e përqendruar në temë /në bërjen e asocimeve për temën; të mësuarit e varur/të pavarur; qasjet reflektive/impulsive; pavarësia në

[29] Ibid.

terren/ndjeshmëria, tolerancën e dykuptimësisë, etj.;

. ➜janë të informuar për njohuritë e mëhershme të nxënësve dhe për mënyrat e të menduarit dhe të ndijimit, dhe dinë si ti planifikojnë strategjitë dhe të testojnë njohuritë e mëhershme të nxënësve. Ata mund tu japin formë caqeve të mësimit dhe të ofrojnë struktura të qarta për mësimet në mënyra që sigurojnë se nxënësit do të kuptojnë atë që pritet nga ta, dhe mund të punojnë në mënyrë aktive dhe bashkëpunuese;

. ➜ i kushtojnë vëmendje renditjes së duhur të një vargu elementesh të përshtatshëm, sikur që janë: parathënia; pyetjet kyçe; mundësitë për tërë klasën, grupin, punën në çift dhe atë individuale; tranzicionet; resurset e nevojshme; dhe një mori të përshtaste të llojeve të ndryshme të aktiviteteve (për shembull, verbale, vizuale dhe zgjidhjes së problemeve të orientuara nga lëvizja, hetimet, strategjitë bashkëpunues, përdorimin e TIK dhe të resurseve të tjera, shqyrtimin plenar të mësimit dhe të mundësive për praktikë);

. ➜kuptojnë çështjet aktuale që janë me interes për të rinjtë në komunitetet e tyre. Më pas ata janë në gjendje, për shembull, tu ndihmojnë të rinjve në zhvillimin e projekteve të tyre mjedisore që do të realizohen në komunitet, sikur që është pastrimi i një parku lokal apo zhvillimi i fushatave për sigurinë në rrugë. Mësuesi planifikon mësimin që del nga këto projekte dhe u ndihmon të rinjve ti organizojnë ato në mënyra të strukturuara;

. ➜dinë si të bëjnë planifikimin e aktiviteteve, sikur që janë ditarët e reflektimeve të nxënësve, në mënyrë që nxënësit të jenë të njoftuar për përvojat dhe emocionet personale të tyre në lidhje me çështjet e qytetarisë në jetët e tyre;

. ➜janë të ndërgjegjshëm që aktivitetet e planifikimit për EQD/EDNJ janë një pikënisje e mirë për mësimdhënien, por që planifikimi duhet gjithashtu të jetë fleksibil. Reflektimet e mësuesve për veprimet e tyre të mësimdhënies janë esenciale për të bërë përshtatjen e strategjive dhe të aktiviteteve, për ti plotësuar stilet dhe nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve dhe për tu mbështetur në përvojat e mëhershme të nxënësve në fushën e EQD/EDNJ.

## 5.2.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 5: planifikimi i qasjeve, metodave dhe i mundësive** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Ndjeni që keni nevojë për më tepër informata dhe përkrahje rreth mënyrës së planifikimit të aktiviteteve mësimore. Ndjeni që keni nevojë për një plan të hollësishëm në lidhje me konceptet kryesore të temave, shkathtësive, qëndrimeve, vlerave dhe prirjeve të EQD/EDNJ që mund të inkorporohen në mësimet. Keni nevojë për një kohë të gjatë për të planifikuar. Ndjeni që keni nevojë për një lloj informacioni lidhur me strategjitë më efektive të mësimdhënies, për të promovuar prirjet pozitive për pjesëmarrje në shoqërinë civile apo në komunitet. Ndjeheni të pasigurt dhe ju duhen arsye pedagogjike për të ndryshuar praktikën tuaj. Pyesni veten si do të reagojnë nxënësit ndaj aktiviteteve të reja mësimore.* | **Provoni këtë:**<br>• gjeni raste për biseduar me mësuesit me përvojë më të gjatë;<br>• duhet të shihni shembuj të mirë të aktiviteteve që janë ushtruar në klasat e mësuese më me përvojë apo në shkollë si tërësi, dhe përpiquni të çmoni planifikimin (qëllimet, temat, qasjet dhe strategjitë e të mësuarit);<br>• reflektoni në lidhje me pritjet tuaja sa i përket asaj sa ka qenë i suksesshëm planifikimi juaj për nxënësit tuaj. Si ka ndikuar në ju personalisht ky aktivitet i planifikimit për EQD/EDNJ?<br>• dëgjoni mësuesit tjerë të papërvojë dhe shpjegoni shkurtimisht pritjet dhe shqetësimet tuaja;<br>• zgjidhni një aspekt të aktivitetit tuaj planifikues ku ndjeni që keni nevojë për më tepër ekspertizë. Për shembull, aftësia juaj për të analizuar problemet më të reja sociale e politike që duken relevante, bashkë me planifikimin dhe implementimin e tyre në mësimet tuaja. Kërkoni nga një kolegë të shpjegojë mënyrën se si ai/ajo bën përzgjedhjen e një teme, dhe si ai/ajo merr vendimet rreth planifikimit në bazë të nivelit dhe të moshës së nxënësve. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Keni filluar të mbani mësim për disa elementë të EQD/EDNJ në klasën tuaj. Ndjeheni të shqetësuar lidhur me cilësinë e rezultateve mësimore të aktiviteteve që keni planifikuar. Keni planifikuar një aktivitet por gjatë pas dhe pas aktivitetit keni ndjerë që keni humbur kontrollin dhe keni luftuar për ti menaxhuar debatet dhe pjesëmarrjen e nxënësve.* | **Provoni këtë:**<br>• zgjidhni dhe analizoni një aspekt të vetëm të procesit tuaj në klasë. Për shembull, si keni menaxhuar komunikimin ndërmjet jush dhe nxënësve dhe ndërmjet vet nxënësve; mund të kërkoni nga kolegët me më tepër përvojë që të vëzhgojnë komunikimin tuaj, dhe më pas bëni krahasimin e shënimeve;<br>• reflektoni lidhur me përmirësimet që mund ti bëni në komunikimin tuaj, duke pasur në mendje pjesëmarrjen demokratike të nxënësve dhe objektivat e mësimit. A keni bërë pyetje të hapura? A u keni ndihmuar nxënësve të qartësojnë të kuptuarit e tyre për konceptet e reja apo abstrakte? Cilat vlera të EQD/EDNJ kanë mbështjellë temën? |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Ndjeni vetëbesim në zgjedhjen e temave për EQD/EDNJ, në pajtim me relevancën e tyre për përmirësim të ndryshimeve të ardhshme jetësore dhe të kompetencave të qytetarisë tek nxënësit. Ndjeni vetëbesim në planifikimin e strategjive tuaja të komunikimit në përputhje me interesat e nxënësve. Ndjeni vetëbesim në zgjedhjen e proceseve të përshtatshme të mësimdhënies për një temë specifike të EQD/EDNJ. Ndjeheni të paduruar për ti këmbyer idetë me kolegët.* | **Provoni këtë:**<br>• reflektoni për supozimet dhe vlerat tuaja të padyshimta kur bëni planifikimin e aktiviteteve tuaja. Pse keni zgjedhur temën X? Pse keni vënë në praktikë strategjinë induktive të mësimit kundrejt asaj deduktive? Për hir të nxënësve tuaj apo për interesin tuaj? Pse keni vendosur të vëni në praktikë punën në projekt në vend se punën me moshatarët? Cilat kanë qenë supozimet dhe vlerat tuaja lidhur me kapacitetet për nxënie të mësimit tek nxënësit tuaj?<br>• vetë-vlerësoni supozimet tuaja përmes syve të nxënësve dhe incidenteve që ngjajnë gjatë klasës;<br>• këmbeni idetë tuaja me kolegët dhe prindërit. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Ju njihni përgjegjësinë tuaj si mësues për të tu dhënë nxënësve njohuri, shkathtësi dhe vlera për pjesëmarrje në shoqëri. Jeni të ndërgjegjshëm për funksionin tuaj si model. Ndjeni që duhet ti bashkë-planifikoni aktivitetet në kuadër të një qasjeje ndërdisiplinore dhe të shkollës si tërësi. Ju e njihni vlerën e pjesëmarrjes aktive të nxënësve tuaj në komunitet, duke pasur në mendje qytetarinë globale.* | **Provoni këtë:**<br>• vështroni në mënyrë të pandërprerë mungesën e koherencës ndërmjet përgjegjësisë suaj si mësues dhe asaj që ju planifikoni për nxënësit tuaj;<br>• kontrolloni nëse keni planifikuar aktivitete që bëjnë përfshirjen e nxënësve në planifikimin tuaj apo në bashkë-planifikim;<br>• bashkë-planifikoni aktivitetet duke i parë të gjitha grupet e interesit dhe partnerët si kontribuues të vlefshëm por edhe si pranues potencial të përfitimeve; më tepër se një partneritet, është një "angazhim demokratik" real në të cilin ju jeni të përfshirë kur bëni planifikimin dhe marrjen e vendimeve për aktivitetet. |

30. Bäckman, E. dhe Trafford, B., 2007, op. cit., fq. 28.

## 5.3. Kompetenca nr. 6

**Kompetenca nr. 6: inkorporimi i parimeve dhe praktikave të EQD/EDNJ në mësimdhënie**
Inkorporimi i parimeve dhe praktikave të EQD/EDNJ në kuadër të lëndëve të specializuara (programit të tërthortë të EQD/EDNJ) me qëllim të përmirësimit të njohurive, shkathtësive dhe pjesëmarrjes, dhe për të kontribuar në fuqizimin e qytetarëve të rinj në një demokraci pluraliste.

### 5.3.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ mund të demonstrojnë për shembull që:

➜ çmojnë çështjet e ngritura nga mbajtja e mësimit për EQD/EDNJ "përmes"lëndëve të tjera. Mësuesit do të duhet të adresojnë që në fillim disa prej çështjeve delikate që ngrihen nga EQD/EDNJ "përmes", për shembull lëndëve të historisë, gjeografisë, apo shkencave sociale apo humane;

➜ kuptojnë pikën në të cilën EQD/EDNJ bën "lidhjen" nga implicite dhe sipërfaqësore (rastësia e përmbajtjes së lëndës) drejt asaj eksplicite dhe të zhvilluar?

➜ përpiqen të sillen drejtë si me objektivat themelore mësimore të lëndës bazë dhe me objektivat mësimore të EQD/EDNJ (ata nisin të gjejnë atë që është dalluese lidhur me EQD/EDNJ kur merren me modelet e ndryshme të mbajtjes së mësimit, që padyshim u shërbejnë qëllimeve të ndryshme).

Shënim: katër apo pesë kontribute të cilësisë së lartë dhe mbase të lidhura nëpër programin mësimor në cilindo grup vit, kanë mundësi të jenë më efektive dhe koherente se sa një numër i madh i kontributeve të definuar dobët apo me lidhje sipërfaqësore. Përpjekja për të planifikuar përmbajtjen e EQD/EDNJ në tërësinë e programit mësimor prodhon aq shumë lidhje sa që është tepër e vështirë të menaxhohen pa një kornizë koherente.

**Histori**

Si janë zhvilluar të drejtat civile dhe të njeriut gjatë kohës?
A janë të arsyetuara në ndonjë rast protestat e dhunshme?
Krahasimi i skllavërisë në të kaluarën dhe skllavërisë në shekullin 21.

**Art**

Si mund të ndihmojnë arti dhe dizajni për ta bërë komunitetin tonë një vend më të mirë?
Çfarë mund të na mësojë arti për vlerësimin e diversitetit kulturor?
Si mund të përdoren artet vizuale në protesta dhe fushata?

**Gjeografi**

Cilat janë përparësitë e tregtisë të drejtë?
A kemi nevojë për më shumë apo më pak rrugë?
Çfarë duhet të bëjë Evropa për të promovuar qëndrueshmërinë?

**EQD: bërthama esenciale**

Konceptet e demokracisë dhe të qytetarisë;
Të drejtat civile dhe përgjegjësitë e qytetarëve
(përfshirë Kartën e të drejtave Themelore të Unionin Evropian);
të drejtat e njeriut, alfabetizmi politik;
roli i qeverisë;
e drejta penale dhe civile;
diversiteti social dhe kulturor dhe identitetet; anti-racizmi;
zhvillimi i qëndrueshëm;
ndërvarësia globale;
forcat ekonomike që veprojnë në nivel lokal, nacional e global;
çështjet aktuale; dhe proceset e pjesëmarrjes, solidaritetit dhe të drejtësisë sociale.

**Shkencë**

A duhet ndaluar klonimi i njerëzve?
A duhet supozuar pëlqimi për dhurim të organeve?
A duhen lejuar të korrat e modifikuara gjenetikisht?

**Gjuhë/literaturë**

Studioni paragjykimin racor dhe përcaktimin e karakterit për të vepruar me drejtësi.
Studioni dhe diskutoni nocionet e barazisë dhe të mos-diskriminimit.

**Matematikë**

Pse kanë rëndësi statistikat që kanë të bëjnë për shembull me varfërinë globale apo me punën e fëmijëve?
Si mund të manipulohen statistikat?

### 5.3.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 6: inkorporimi i parimeve dhe praktikave të EQD/EDNJ në mësimdhënie** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Ju gjithashtu nuk jeni të sigurt lidhur me atë se çfarë janë këto parime dhe praktika. Në të vërtetë, ju mund ta shihni EQD/EDNJ si "kërcënim" për lëndën tuaj. E shihni detyrën tua të mësimdhënësit si një mision akademik për të mësuar lëndën tuaj sipas planit mësimor, programit mësimor të shkollës dhe udhëzimeve më të gjera nacionale.* | **Provoni këtë:**<br>• familjarizohuni me konceptet e EQD/EDNJ, mësoni cilat janë parimet dhe praktikat e EQD/EDNJ;<br>• kontrolloni dhe analizoni programin tuaj mësimor për të gjetur një themel të përbashkët; dhe identifikoni përkimet (e mundshme) dhe "pikat e takimit" në përmbajtje, shkathtësi, koncepte dhe vlera;<br>• angazhohuni në diskutime me kolegët tuaj që mbajnë mësim në shkencat qytetare apo sociale në shkollën tuaj. Mendoni për dobitë që mund të kenë nxënësit nga një qasje koherente më "përfshirëse" që i sjell aspektet e EQD/EDNJ në programin mësimor në mënyra natyrore dhe të rrjedhshme. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Ju jeni përgjithësisht të familjarizuar me konceptet e EQD/EDNJ dhe me parimet dhe praktikat e tyre. Mund të identifikoni përkimet ndërmjet njohurive, shkathtësive dhe vlerave të EQD/EDNJ, dhe planit tuaj mësimor dhe/apo programit mësimor të shkollës.* | **Provoni këtë:**<br>• planifikoni si do të bëni inkorporimin e parimeve dhe praktikave të EQD/EDNJ në mësimdhënien tuaj: identifikoni fushat e përshtatshme të përmbajtjes dhe çështjet;<br>• takohuni me kolegët tuaj dhe këmbeni informata lidhur me mësimin e EQD/EDNJ. Konsolidoni përpjekjet tuaja. Në planin praktik, planifikoni takime të rregullta për të diskutuar çështjet e EQD/EDNJ në kalendarin e takimeve të shkollës;<br>• ndërsa mbani mësimin, përpiquni të siguroni që nxënësit do të vlerësojnë si duhet integrimin ndërmjet lëndëve dhe bëni që mësimi për EQD/EDNJ të jetë i qartë në vend se i nënkuptuar; |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Ekziston një vizion i qartë lidhur me qasjen ndaj EQD/EDNJ në programin mësimor të shkollës. Mësuesit planifikojnë bashkërisht dhe i ngulisin parimet dhe praktikat e EQD/EDNJ në mësimdhënien e tyre. EQD/EDNJ është gjithashtu pjesë përmbajtësore e etosit të shkollës.* | **Provoni këtë:**<br>• shikoni si do të mund zgjeroni proporcionin e aktiviteteve rreth EQD/EDNJ jashtë klasës dhe jashtë shkollës, në mësimin e lëndës suaj;<br>• shqyrtoni mundësitë për udhëtime dhe vizita në terren (për shembull, në muze, ekspozita, në selinë e këshillit/parlamentit, dhe në festivale);<br>• ftoni vizitorë të jashtëm në procesin e mësimdhënies;<br>• bëni që nxënësit të jenë partnerët tuaj në klasë. Ndajini objektivat me ta dhe u ofroni mundësinë të marrin pjesë në planifikim. Kërkoni prapaveprim nga ata. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*EQD/EDNJ është një element i rregullt, natyror dhe i qëndrueshëm brenda mësimdhënies suaj. Mundësitë për të ndërmarrë veprime në lidhje me çështjet e ngritura në klasë (në kontekstet e ndryshme të të mësuarit) u ofrohen nxënësve rregullisht.* | **Provoni këtë:**<br>• eksperimentoni dhe implementoni një larmi të metodave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies;<br>• u ndihmoni kolegëve tuaj në zhvillimin profesional të tyre, për të zgjeruar qasjet e tyre ndaj EQD/EDNJ në mësimdhënien e tyre;<br>• vazhdoni me pasurimin e praktikës suaj;<br>• gjeni partnerë në komunitet për tu ndihmuar në zhvillimin e synimeve tuaja. |

## 5.4. Kompetenca nr. 7

**Kompetenca nr. 7: përcaktimi i rregullave themelore për etos pozitiv të shkollës**
Përcaktimi i rregullave themelore të qarta për një klimë të qëndrueshme të besimit, sinqeritetit dhe respektit të ndërsjellë. Menaxhimi i klasës dhe i sjelljes njohin parimet e EQD/EDNJ për të siguruar mësimnxënie të qëllimshme dhe efektive

### 5.4.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë që …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ do të demonstrojnë për shembull, që:

. ➜synojnë rritjen e potencialit të të gjithë nxënësve, duke mbajtur pritje të larta sa i përket sjelljes së nxënësve;

. ➜modelojnë dhe promovojnë vlerat themelore të qëllimit të EQD/EDNJ, sikur që është kërkimi për të vërtetën dhe respekti për mendimet e të tjerëve;

. ➜ndërmarrin hapa për krijimin e raporteve individuale pozitive me nxënësit, bëjnë përpjekje për ti dëgjuar perspektivat e nxënësve rreth mësimnxënies së tyre, dhe i trajtojnë ata me respekt. Gjithashtu, ata janë konsistent, të hapur dhe të drejtë në komunikimin e tyre me nxënësit;

. ➜mund të themelojnë rregulla dhe rutina të qarta dhe eksplicite në klasën e tyre, shpërblime dhe ndëshkime, që janë të lidhura qartë me parimet më të gjera të EQD/EDNJ mbi të drejtat dhe përgjegjësitë dhe me politikën e sjelljes në shkollë. Kjo arrihet:

– duke përcaktuar një numër të vogël të rregullave të formuluara në mënyrë pozitive dhe që kuptohen nga nxënësit;
– duke u dhënë mundësinë nxënësve për të formësuar dhe për ti shqyrtuar rregullat sa herë që është e mundur;
– duke përdorur në mënyrë strategjike lëvdatat dhe shpërblimet për sjellje pozitive;
– duke përdorur gjuhën që refuzon sjelljen e papërshtatshme, por jo vet nxënësit.

. ➜u referohen katër R-ve të menaxhimit të sjelljes, domethënë: të drejtat e të tjerëve, nevoja për rregulla, vlera e rutinave dhe nevoja për të marrë përsipër përgjegjësi personale;

. ➜i shmangen të folurit me nxënësit në mënyra që dëmtojnë vetëbesimin dhe i dëmtojnë raportet, por në vend të kësaj përdorin lëvdata të shpeshta dhe gjuhë pozitive, të përshtatshme për moshën dhe rrethanat;

. ➜kuptojnë vargun e strategjive në nivel individual dhe të grupit, për tu ndihmuar nxënësve në menaxhimin më të mirë të sjelljes së tyre;

. ➜njohin tensionet që mund të përjetohen nga nxënësit ndërmjet normave të sjelljes "së rrugës" dhe pritjeve në lidhje me sjelljen në shkollë, dhe u ndihmojnë nxënësve që të jenë të qartë lidhur me dallimet dhe si diskutojnë çështjet përkatëse;

. ➜inkurajojnë vendimmarrjen e pavarur, duke krijuar mundësi për vendimmarrje demokratike në klasë; për shembull,: votimi me "sy të mbyllur" për të mos u ndikuar gjatë votimit në mënyrë të njëjtë sikurse bashkëmoshatarët.

## 5.4.2. Grafiku i progresit

| Kompetenca Nr. 7: përcaktimi i rregullave bazë për etos pozitiv të shkollës | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Mësuesit zbatojnë rregullat e përcaktuara nga vet ata në klasat e tyre – madje edhe atëherë kur nxënësit në mënyrë të qartë nuk i durojnë apo u rezistojnë atyre rregullave.*<br>*Ka pak ose aspak hapësirë për negocim. Përgjegjësitë janë të theksuara dhe të drejtat e minimizuara.*<br>*Rregullat janë rregulla dhe ka pak ose aspak hapësirë për diversitet, formim apo nevoja speciale.*<br>*Mungesa e rregullave të pajuara themelore pengon diskutimin e hapur dhe të respektueshëm në klasë.* | **Provoni këtë:**<br>• shtoni ndërgjegjësimin tuaj në lidhje me disa nga faktorët në shkolla dhe në klasa që nxjerrin në shesh sjelljen e padëshiruar;<br>• loboni për trajnimin e tërë stafit apo trajnimin e tërë shkollës, të mbështetur nga një ekspert i jashtëm, për të ngritur ndërgjegjësimin e komunitetit të shkollës për çështjen dhe mësoni strategjitë në nivel individual dhe grupor për tu ndihmuar nxënësve në menaxhimin më të mirë të sjelljes së tyre;<br>• ndërmerrni hapa për krijimin e raporteve individuale pozitive me nxënësit, përpiquni ti dëgjoni perspektivat e nxënësve për mësimnxënien e tyre, dhe i trajtoni me respekt ata;<br>• provoni zbatimin pozitiv, domethënë vendosni pikët në një shportë ku sjellja e mirë mund të shpërblehet, dhe, kur shporta i përmban 15 pikë, klasa fiton një trajtim special (aktivitet, lojë, etj.). |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Mësuesit përcaktojnë dhe zbatojnë rregullat në klasa. Ka disa përpjekje për tu konsultuar me nxënësit por reagimi mund të jetë zhgënjyes, mbase për faktin që konsultimi nuk shihet si i sinqertë.*<br>*Nxënësit nuk kanë mundësi të bëjnë asgjë që të dëgjohet zëri i tyre. Kur mbahen diskutimet në klasë, ka mungesë të dëgjimit të vëmendshëm dhe të respektit për qëndrimet e të tjerëve* | **Provoni këtë:**<br>• angazhoni nxënësit në përcaktimin e rregullave bazë të shkollës dhe të klasës. Kërkoni këshilla nga nxënësit për mënyrën e trajtimit të diversitetit në klasë (diversiteti në stilet e të mësuarit; nevojat dhe stilet e të mësuarit tek djemtë/vajzat); dhe nevojat në klasë (për shembull, nivelet e zotërimit të gjuhës, dhe paaftësitë apo vështirësitë në mësim).<br>• vini në plan të parë parimet dhe gjuhën e EQD/EDNJ – në vend se të flisni në aspekt të rregullave dhe ndëshkimeve, përdorni shprehjet si “përgjegjësi”, “të drejta”, “themel i përbashkët”, “respekt i ndërsjellë” dhe “tolerancë”;<br>• kur duhet ti përdorni sanksionet, përpiquni të jini të qartë, konsistent dhe i moderuar. Kritikoni veprimin jo personin.<br>Për shembull, theksoni përgjegjësinë e gjithsecilit për atmosferën në shkollë, duke bërë pyetje për pasojat e sjelljes individuale mbi të tjerët dhe mbi grupin. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Disa rregulla të shkollës dhe të klasës negociohen dhe pajtohen me organet përfaqësuese të nxënësve. Mësuesit përdorin gjuhën pozitive dhe i udhëzojnë nxënësit të marrin përgjegjësi për sjelljet e tyre duke theksuar zgjidhjet e nxënësve në vend se kërcënimet e mësuesve. Ka hapësirë për diskutime dhe dëgjim.* | **Provoni këtë:**<br>• përfshini nxënësit për së afërmi në përcaktimin e rregullave. Respektoni rolin e këshillit të shkollës (dhe këshillave përkatës të vitit/klasës) në vendosjen e rregullave themelore të klasës. Përvoja tregon që nxënësit do të pranojnë rregullat realiste dhe që ndiqen lehtë; klima në klasë është gjithashtu me rëndësi për ta;<br>• u caktoni nxënësve më të vjetër role specifike dhe shprehni shkallën e përgjegjësisë të cilën prisni ta marrin mbi vete ata.<br>Çiftëzimi i nxënësve më të vjetër me ata më të rinj është efektiv për të ndihmuar në vepruar në lidhje me vlerat e EQD/EDNJ;<br>• kërkoni në mënyrë aktive shprehjen e qëndrimeve nga nxënësit për çështjet sikur që janë ngacmimet dhe vandalizmi, dhe si mendojnë ata se shkolla mund të bëhet një komunitet më i mirë, më përkrahës dhe më i sigurt për mësim |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Rregullat e sjelljes në shkollë/klasë janë përcaktuar përmes konsultimeve dhe negociatave me shkollës dhe këshillat e nxënësve. Të gjithë zërat janë dëgjuar plotësisht. Nxënësit luajnë pjesën e tyre si qytetarë të përgjegjshëm në implementinin dhe zbatimin e kodeve të sjelljes në klasë. Ekziston një klimë e vërtetë ndërkulturore dhe nuk ka një qëndrim “ne dhe ata” në mesin e anëtarëve të komunitetit të shkollës. Klasat janë vende për mësim të qëllimshëm dhe të gjallë.* | **Provoni këtë:**<br>• siguroni mundësinë që rregullat e klasës të mund të ripunohen/rishikohen rregullisht nga nxënësit dhe stafi;<br>• vazhdoni tu besoni nxënësve që të marrin udhëheqjen në zgjerimin e lirive të tyre, domethënë, që të zhvillojnë klimën ku sa më të përgjegjshëm që të tregohen nxënësit, aq më tepër të drejta fitojnë;<br>• inkurajoni vizitorët që të vijnë në klasën tuaj për të parë vet cilësinë e lartë të debatit për EQD/EDNJ, komunikimin dhe respektin që tregohet për qëndrimet e të tjerëve.<br>• vazhdoni të punoni me kolegët tuaj për zhvillimin e shkathtësive tuaja. |

## 5.5. Kompetenca nr. 8

Kompetenca nr. 8: zhvillimi i vargut të strategjive për të mundësuar zhvillimin e shkathtësive të diskutimit tek nxënësit, në veçanti për çështjet kundërthënëse
Vargu i strategjive dhe metodologjive të mësimdhënies – përfshirë këtu pyetjet në tërë klasën – për të lehtësuar diskutimin nga nxënësit të çështjeve të ndjeshme/kundërthënëse

### 5.5.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë që …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ demonstrojnë për shembull që:

➜kuptojnë llojet e shkathtësive të nevojshme në diskutimet për qytetarinë. Për shembull:

– shkathtësitë sociale dhe të komunikimit sikur që është zhvillimi i argumentimit, prezantimi i qartë i ideve, të folurit me radhë, përdorimi i komunikimit efektiv jo verbal;
– përdorimi i fjalorit të përshtatshëm dhe koncepteve të EQD (si "qytetar", "themel i përbashkët" dhe "avokim") dhe shmangia e gjuhës fyese apo stereotipe;
– njohja e formave të ndryshme të diskutimit – për shembull, kundërshtuese dhe eksploruese;
– teknikat e debatimit – për shembull, aftësia për ti bindur të tjerët; negocimi i kompromisit apo konsensusi; dhe njohja e shfrytëzimi i retorikës;
– njohja e kornizave ligjore lidhur me limitet e lirisë së shprehjes së nxënësve në kontekstet e EQD/EDNJ.

➜njohja e vargut të strategjive që mund tu ndihmojnë nxënësve në zhvillimin e shkathtësive të tyre për diskutim. Nxënësit duhet të mësohen si të diskutojnë. Strategjitë përfshijnë:

– të bëhet relevante – lidhja e diskutimit me interesat dhe përvojat e nxënësve;
– të bëhet argëtuese – përdorimi i mediave që bëjnë ngritjen e çështjeve që do të diskutohen në mënyrë interesante, për shembull, një rrëfim, videoklip, fotografi, etj;
– të bëhet i qartë qëllimi duke prezantuar temat dhe duke nënvizuar çështjet që do të diskutohen; dhe të inkurajohen nxënësit për të gjeneruar pyetjet për diskutim; për shembull, duke u lejuar atyre të përpilojnë pyetjet e tyre për një temë dhe duke votuar "me sy mbyllur" për pyetjen që do të diskutohet;
– diversifikimi i proceseve grupore dhe metodologjive bashkëpunues; dhe ri-aranzhimi i uljes në grupe të vogla, çifte, në formë rrethi, patkoi apo në formë peshku;
– përsëritja/mbajtja e rregullave themelore për dëgjimin/ të folurit me radhë – madje edhe më mirë, përfshirja e nxënësve që zbatimin e këtyre rregullave;
– shmangia e të folurit të tepërt për veten tuaj – lejimi i hapësirës për nxënësit që të flasin ata vet;

➜ kuptojnë qasjet e ndryshme potenciale për mësimin e çështjeve kundërthënëse. Mosha e nxënësve mund të ndikojë në atë që është më e përshtatshme. E shfrytëzuar në mënyrë rigide, secila qasje ka mangësitë e veta. E përdorur me mençuri dhe në kombinim me njëra tjetrën, të gjitha mund të ndihmojnë në minimizimin e rrezikut të mësimdhënies së anshme. Gjerësisht, janë tri qasje ndaj EDNJ:

– neutrale – që nuk shprehin asnjë lloj të qëndrimeve personale;
– të balancuara – që prezantojnë një varg qëndrimesh, përfshirë këtu ato me të cilat ju personalisht mund të shprehni mospajtim;
– të përkushtuara – përmes të cilave ju i bëni të ditura qëndrimet tuaja.

. ➜I kushtojnë vëmendje të vazhdueshme shmangies së anshmërisë në mësimdhënien e tyre. Për shembull: ata sigurojnë që të gjitha anët e një argumenti do të jenë të dëgjuara; prezantojnë qëndrimet kundërshtuese në mënyrë të balancuar; sfidojnë qëndrimet popullore/konvencionale; nuk i prezantojnë opinionet si fakt; nuk e vendosin veten si burim të vetëm të autoritetit; dhe luajnë rolin e avokatit të djallit;

. ➜promovojnë të menduarit cilësor të EQD/EDNJ përmes pyetjes së tyre. Shembujt e pyetjeve efektive për EQD/EDNJ janë: a mendoni që është e drejtë? A ka të drejtë X ta bëjë këtë? Kush duhet ta ketë fjalën këtu? A duhet të ketë një ligj për këtë? Kush duhet të paguajë për këtë? Prej nga vjen kjo e drejtë? Cila është arsyeja që e thoni këtë? Cila do të ishte gjëja më e mirë për të gjithë? Për cilat gjëra pajtohen të gjithë?

## 5.5.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 8: zhvillimi i vargut të strategjive për të lehtësuar shkathtësitë e nxënësve për diskutim të çështjeve kundërthënëse** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Keni mungesë të vetëbesimit në trajtimin e çështjeve kundërthënëse. Strategjia juaj kryesore është ajo e shmangies. Mund të ndjeni që disa prej çështjeve janë tepër të nxehta për tu trajtuar. Jeni të brengosur lidhur me implikimet e menaxhimit të klasës për nxënësit që kanë opinione të forta dhe kundërshtuese. Jeni të kujdesshëm sa u përket reagimeve të prindërve lidhur me zgjedhjen e temave për diskutim në klasë.* | **Provoni këtë:**<br>• zgjeroni perspektivën tuaj duke vështruar një mësues më me përvojë në organizimin e diskutimit për një çështje kundërthënëse/ të ndjeshme;<br>• mësoni një mësim duke ndjekur strukturën/listën kontrolluese të sugjeruar më sipër, në një fushë ku jeni me vetëbesim për njohurinë e temës suaj;<br>• vlerësoni efikasitetin e mësimit;<br>• njihuni me të tri qasjet e mundshme ndaj EDNJ, në mësimin e çështjeve kundërthënëse dhe me strategjitë e shmangies së anësisë;<br>• lexoni tekstet e sugjeruara në këtë dokument për të kuptuar dhe për të fituar siguri në të shpjeguarit pse është me rëndësi për diskutimin e çështjeve kundërthënëse. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Jeni të ndërgjegjshëm për natyrën kundërthënëse të disa çështjeve dhe keni nisur ti përfshini ato brenda programit mësimor dhe planifikimit të mësimit tuaj. Jeni të vetëdijshëm për shmangien e anësisë në mësimdhënien tuaj. Disa tema mbesin "të paprekshme" për ju.* | **Provoni këtë:**<br>• filloni të mendoni lidhur me shkathtësitë tjera të nxënësve për diskutim që duhen zhvilluar dhe praktikuar;<br>• eksperimentoni me disa nga strategjitë e sugjeruara më sipër;<br>• mendoni për mundësitë e inkorporimit të disa çështjeve moderne dhe kundërthënëse të EQD/EDNJ në mënyrë natyrore në mësimin e lëndës suaj, dhe filloni të rishikoni planifikimin e programit tuaj mësimor;<br>• organizoni një lloj trajnimi specifik në këtë fushë duke përdorur burimet cilësore të jashtme. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Keni pranuar një lloj trajnimi në trajtimin e çështjeve kundërthënëse dhe të ndjeshme. Jeni duke implementuar në mënyrë të vetëdijshme vargun e strategjive për tu ndihmuar nxënësve në zhvillimin e shkathtësive të diskutimit.* | **Provoni këtë:**<br>• ndryshoni mënyrat në të cilat strukturoni diskutimin e çështjeve kundërthënëse nga nxënësit;<br>• gjeni mundësi në trajnimin e tërë stafit për metodologjitë bashkëpunuese dhe dinamikën e grupit;<br>• fokusohuni në zhvillimin e shkathtësive tuaja në bërjen e pyetjeve – mbështetuni në repertorin e pyetjeve efektive për EQD/EDNJ që mund të promovojnë të menduarit më të lartë lidhur me konceptet kyçe të EQD/EDNJ;<br>• mendoni lidhur me mënyrat për të reaguar në çështjet e ngritura spontanisht nga nxënësit, që krijojnë mundësi për mësim; përgjigjuni në pyetjet me një pyetje tjetër dhe inkurajojini nxënësit të gjenerojnë pyetjet e tyre për diskutim. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Çështjet kundërthënëse shihen si qendrore për programin mësimor të EQD/EDNJ. Ju i inkurajoni nxënësit që të shqyrtojnë çështjet dhe reflektoni për balancin e përgjigjeve. Ju kuptoni rëndësinë qendrore të parashtrimit të pyetjeve për nxënësit dhe promovoni të menduarit cilësor të EQD/EDNJ përmes parashtrimit të pyetjeve për nxënësi.* | **Provoni këtë:**<br>• këmbeni praktikën tuaj të morë me mësuesit tjerë të lëndëve të tjera. Zhvilloni këtë kapacitet përmes trajnimit brenda në shkollë; takimet e stafit/trupit pedagogjik janë raste të mira për këtë;<br>• aplikoni shkathtësitë tuaja të mësimdhënies në fushat e reja të programit mësimor të cilat shkolla juaj planifikon ti zhvillojë (për shembull, promovimi i kohezionit të komunitetit apo tema e zgjidhjes së konflikteve);<br>• identifikoni çështjet që janë shqetësim aktual brenda komunitetit të shkollës; për shembull, racizmi, ngacmimi, shqetësimi, "shpullat e gëzimit" dhe privatësia /përdorimi etik i teknologjisë mobile;<br>• gjeni partnerë në komunitet për të ndihmuar në zhvillimin e synimeve tuaja. |

## 5.6. Kompetenca nr. 9

**Kompetenca nr. 9: përdorimi i vargut të qasjeve ndaj vlerësimit**

Shfrytëzimi i vetë-vlerësimit të nxënësve dhe i vlerësimit të bashkëmoshatarëve, për të informuar dhe lavdëruar progresin dhe arritjet e nxënësve në EQD/EDNJ.

### 5.6.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD mund të demonstrojnë që:

. ➜e kuptojnë që procesi i vlerësimit të qytetarisë në fund të fundit duhet të jetë në pronësi të nxënësve – i ndërmarrë nga ata vet dhe jo i bërë për ta

. ➜përdorin një varg strategjish të vlerësimit me qëllim të vlerësimit të progresit të nxënësve nëpër format e ndryshme të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe prirjeve, dhe të pjesëmarrjes.

Mësuesit e papërvojë mund të inkurajohen të hyjnë në menynë e mëposhtme të opsioneve me nxënësit e tyre:

**Njohuria faktike dhe konceptuale**

– pyetësorët me zgjedhje të shumëfishta;
– krahasimi i fjalëve me definicionet;
– identifikimi i ideve/informatave kyçe nga një fragment apo tekst;
– shpjegimi i sfondit të një titulli apo artikulli në gazetë;
– shkrimi i argumenteve për dhe kundër një çështjeje kundërthënëse;
– analizimi i disa statistikave;
– diskutimi i problemeve në lidhje me propozimet për futjen e një ligji të ri.

**Pyetjet dhe komunikimi**

– demonstrimi i shkathtësive të komunikimit përmes një cope të të shkruarit bindës;
– krijimi i prezantimit në PowerPoint në mbrojtje të ndryshimit të një lloji të caktuar;
– krijimi i shfaqjes apo drejtimi i një takimi për ngritje të ndërgjegjësimit për një çështje të caktuar në kuadër të shkollës;
– hulumtimi i një teme (individualisht apo në grupe të vogla) me përdorimin e një vargu resursesh, dhe bërja e prezantimit për të, me gojë apo me shkrim;
– të shkruarit e një letre për një figurë publike (për shembull, një këshilltari, një shefi të policisë apo redaktorit të një gazete lokale) për ti bindur ata lidhur me një çështje të caktuar.

**Pjesëmarrja dhe veprimi i përgjegjshëm**

– kontributi i suksesshëm për punën grupore, duke treguar njohuri për një varg rolesh të nevojshme për funksionimin efektiv të një grupi dhe aftësia për të reflektuar për mënyrën si ka funksionuar grupi si një njësi;
– identifikimi i nevojës për veprim social dhe zhvillimi i strategjive që do të mund të sjellin ndryshime;
– demonstrimi i të kuptuarit të mënyrës së ndikimit në opinionin për një çështje, qoftë ky opinioni publik apo ai i krijuesve lokal apo nacional të politikave;
– të diturit si tu parashtrohen pyetje "ekspertëve" vizitues për një çështje që ka të bëjë me temën (për shembull, të pyeturit e policisë lokale lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me krimin dhe me parandalimin e tij, apo ekspertëve mjedisor lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë

dhe agjendën lokale 21);
– inkurajimi i nxënësve për të zhvilluar serinë e tyre të kritereve të suksesit për detyrat (për shembull, duke pyetur “Si do të dimë që e keni arritur atë?”);

➜ mund të mësojnë nga dhe të aplikojnë praktikat efektive të vlerësimit nga lëndët tjera të EQD. Këto mund të sigurojnë modele për ndërtimin e suksesit progresiv në projektet e EQD.

## 5.6.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 9: përdorimi i vargut të qasjeve ndaj vlerësimit** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Ju rrallëherë vlerësoni punën e nxënësve në EQD apo këtë e bëni në mënyrë arbitrare. Pasi që EQD i mungon definicioni dhe/apo profili në shkollën tuaj, është praktikisht e pamundur tu ofrohet prapaveprim nxënësve për të arriturat dhe progresin e tyre. Mësimet që mund të inkorporojnë një pjesë të përmbajtjes së EQD apo shkathtësive, kanë objektiva të paqarta të mësimit.* | **Provoni këtë:**<br>• definoni synimet e planifikimit tuaj në aspekt të njohurive, shkathtësive dhe pjesëmarrjes në EQD. Ashpërsoni objektivat e mësimit tuaj;<br>• ndani objektivat mësimore të EQD me nxënësit para mësimit. Ndihmoni nxënësit që të kuptojnë kriteret për punë të suksesshme në çështjet dhe projektet e EQD;<br>• ofroni kohë brenda mësimeve për tu lejuar nxënësve që të reflektojnë për mësimin e tyre të EQD. Inkurajoni nxënësit që ti shpjegojnë shkathtësitë dhe proceset e EQD të inkorporuara në mësimin e tyre, për shembull, në seancat e shkurtra plenare pas secilit aktivitet dhe në mbarim të mësimit. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Ka një lloj vlerësimi të punës në EQD por është kryesisht përmbledhës dhe fokusohet në dimensionet e njohurisë përmes aktiviteteve dhe testeve të të kuptuarit. Disa nga mësimet planifikohen dhe kanë objektiva të fokusuara qartë në EQD. Nuk ka mekanizma për të vlerësuar progresin gjatë kohës. Qytetaria dhe pjesëmarrja aktive e nxënësve nuk vlerësohet.* | **Provoni këtë:**<br>• shtoni vargun e mënyrave në të cilat vlerësoni punën e nxënësve në EQD – domethënë jo vetëm letrat por edhe krijimin e ekspozimeve, prezantimeve në PowerPoint, projekteve bashkëpunuese, bisedave bindëse për audiencat e ndryshme, etj.;<br>• krijoni mënyra për të bërë bashkë prova të punës së nxënësve rreth konteksteve të EQD me dosje, portofolë – për të qenë në gjendje për të lartësuar arritjen dhe për të planifikuar mësimet e ardhshme;<br>• në fund të një njësie të punës apo projektit të EQD, eksperimentoni me format e ndryshme të vetë-vlerësimit dhe të vlerësimit të moshatarëve. Cilat aspekte të EQD nxënësit mendojnë se i kanë bërë dhe i kanë mësuar mirë? Si mund të përmirësojnë ata punën e tyre në një rast tjetër? |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Eksiton qasja në nivel të shkollës ndaj vlerësimit dhe shënimit të progresit në aspektet e EQD, që përdoret nga të gjithë mësuesit. Keni filluar të eksperimentoni me një varg të strategjive të ndryshme të vlerësimit, përfshirë këtu vetë-vlerësimin dhe vlerësimin e moshatarëve. Nxënësit marrin prapaveprim për punën dhe/apo projektet e tyre në EQD.* | **Provoni këtë:**<br>• eksperimentoni me vetë-vlerësimin dhe vlerësimin e diversifikuar të moshatarëve (bankat e deklarimeve, shqyrtimi i drejtuar, etj.);<br>• braktisni rrjetet tradicionale të vlerësimit për të përvetësuar llojet më miqësore (sikur që janë “dritat e semaforit” për vetëbesimin, fytyrat e qeshura/ jo të qeshura, dhe “dy yje dhe një dëshirë” – dy elemente specifike të punës së nxënësve të lavdëruara dhe një fushë e kritikës specifike konstruktive për mësimin e ardhshëm);<br>• inkurajoni gjetjen e programit të tërthortë për të përcaktuar cila mësimnxënie rreth EQD po ndodhë në në kuadër të lëndëve të ndryshme të shkollës. Flisni me kolegët tuaj rreth mënyrës së vlerësimit të mësimnxënies në EQD/EDNJ<br>Provoni të menduarit me bashkëpunim nëpër shkollë. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Planet mësimore kanë përfundime të definuara mirë të mësimit të EQD. Vlerësimi përfshin nxënësit tërësisht në proces, dhe identifikon e lartëson arritjet e tyre. Puna e tyre në EQD vlerësohet në mënyrë “formative” ashtu që ata mund të përdorin njohuritë e tyre të EQD, shkathtësitë dhe pjesëmarrjen në punën apo projektet pasuese.*<br>*Ju kuptoni që procesi i vlerësimit të EQD në fund duhet të jetë në pronësi të nxënësve.* | **Provoni këtë:**<br>• shtoni njohuritë tuaja të kërkimit në llojet e ndryshme të të mësuarit tek nxënësit. Inkorporoni disa ide nga kjo në aktivitetet tuaja të vetë-vlerësimit për EQD (për shembull, me përdorimin e gjuhës dhe fjalëve, modeleve dhe logjikës; vizualizimit të fotografive; qasjeve kinestetike ndaj të menduarit të thellë për gjërat; në mënyrë emocionale apo me diagram; dhe ndijore);<br>• përfshini nxënësit në zhvillimit e metodave të vlerësimit që u përshtaten rezultateve të pritura të mësimnxënies;<br>• u mundësoni nxënësve që të ri-përpilojnë /përmirësojnë punën e tyre në EQD pasi të jetë shqyrtuar ajo, dhe flisni me ta lidhur me strategjitë për përmirësim;<br>• organizimi trajnimin me kolegët tuaj për strategjitë novatore të vlerësimit. |

# 6. Grupi C: aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ përmes partneriteteve dhe përfshirjes së komunitetit

## 6.1. Përmbledhje e shkurtër dhe mbështetje teorike

Një shoqëri e shëndoshë dhe multikulturore angazhohet në dialog dhe komunikim demokratik që kalon kufijtë social dhe kulturor. Shkollat janë institucione që mund të ndihmojnë në ndërtimin e urave dhe në thyerjen e barrierave në komunitetet ku të rinjtë mund të jenë duke jetuar "jetë paralele". Një aspekt me rëndësi i qytetarisë përfshirëse domosdo përfshin qasjen pozitive dhe aktive ndaj anti-racizmit dhe të drejtave të njeriut. Shkollat duhet të synojnë të shfrytëzojnë dhe të mbështeten nga konteksti lokal i tyre. Si agjentë kyç në ndërtimin e kohezionit në komunitet, përveç nëse shkollat sforcojnë edukimin e tyre për diversitet brenda kontekstit të tyre lokal, ata rrezikojnë shënjimin në vend të zgjidhjes praktike, duke prekur vetëm sipërfaqen në vend të eksplorimit të mundësive. Mësuesit duhet ti ngulisin "veprimet për ndryshim" si elemente natyrore në vend se si tipare të jashtëzakonshme apo të rralla të mësimdhënies së tyre.

Ky grup i kompetencave përfshin dërgimin e të mësuarit të EQD/EDNJ jashtë klasës. Ai i përgjigjet pyetjes "me kënd mund ta bëjmë ne atë?" Veprimi për EQD/EDNJ nga njerëzit e rinj ka pak mundësi të jetë efektiv nëse nuk është një veprim i bazuar në informata. Prandaj, pyetjet primare të këtij grupi janë:

. • Cilat shkathtësi të trajtimit të informatave dhe të të menduarit kritik janë parakushte kyçe për pjesëmarrjen aktive?
. • Cilat janë llojet e projekteve aktive të qytetarisë që u përshtaten më së miri të rinjve që duan të veprojnë për të bërë ndryshime?
. • Si mund të punojnë mësuesit me partnerët e jashtëm për të lehtësuar organizimin e fushatave nga të rinjtë për çështjet që janë me interes për ta?
. • Pse dhe si dizajnojmë projekte rreth çështjeve si paragjykimi, diskriminimi dhe anti-racizmi?

Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me Kompetencën Nr. 8 pasi që ajo i angazhon nxënësit që të veprojnë për ndryshime, duke prekur nganjëherë çështjet kundërthënëse, dhe përfshin parashtrimin e pyetjeve si një proces qendror i mësimdhënies:

. • Në çfarë shoqërie jetojmë ne?
. • Në çfarë lloj shoqërie dhe bote duam të jetojmë në të ardhmen?
. • Çfarë mund të bëj unë dhe të tjerët për ti ndryshuar gjërat dhe për të bërë ndryshime në botën në të cilën jetojmë?

**Kompetenca nr. 10: mjedisi mësimor që promovon përdorimin e burimeve të ndryshme**

Mjedisi mësimor që u mundëson nxënësve të analizojnë çështjet politike, etike, sociale dhe kulturore, problemet apo ngjarjet, në mënyrë kritike, me shfrytëzimin e informatave nga burime të ndryshme, përfshirë këtu mediat, statistikat dhe resurset me bazë TIK.

**Kompetenca nr. 11: puna bashkëpunuese në kuadër të partneriteteve të duhura në komunitet**

Puna bashkëpunuese me partnerët e duhur (sikur që janë organizatat e komunitetit, OJQ-të apo përfaqësuesit) në planifikimin dhe implementimin e një vargu të mundësive për angazhim të nxënësve në çështjet e qytetarisë demokratike në komunitetet e tyre.

**Kompetenca nr. 12: strategjitë për kundërshtimin e të gjitha formave të diskriminimit**

Strategjitë për kundërshtimin e të gjitha formave të paragjykimit dhe diskriminimit dhe për promovim të anti-racizmit.

**Tabela 6: Grupi C – Aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ përmes partneritetit dhe angazhimit të komunitetit**

## Sfondi teorik

Të kuptuarit e EQD/EDNJ nga mësuesit duhet të përfshijë një perspektivë më të gjerë të edukimit për qytetarinë aktive. Në pajtim me vizionin e Dewey-it[31] për "shkollat si hapësirë demokratike", mësuesit mund të përpiqen tu ofrojnë nxënësve mundësi për zhvillimin e qëndrimeve dhe sjelljes qytetare të tyre duke punuar në projektet shkollore apo të komunitetit. Qëllim kryesor i këtij konceptimi më të gjerë të EQD/EDNJ është të inkurajojë nxënësit që të përdorin atë që kanë mësuar në lidhje me EQD/EDNJ dhe të bartin shkathtësitë njohëse dhe sociale të tyre në pjesëmarrjen praktike dhe aktive. Mësuesit e EQD/EDNJ duhet të jenë të aftë të menaxhojnë dhe të mbështesin format e ndryshme të iniciativave pjesëmarrëse (për shembull, këshillat e nxënësve, iniciativat e përbashkëta me nxënësit dhe prindërit, projektet e komunitetit dhe të mësuarit e shërbimit) në shkollë.

Krijimi i një mjedisi mësimor që promovon përdorimin e burimeve të ndryshme, si dhe gjetja, analizimi dhe shfrytëzimi i informatave, është e rëndësisë parësore pasi që qytetarët duhet të jenë në gjendje të analizojnë politikat publike dhe mbulimin nga mediat të çështjeve bashkëkohore në bazë të dëshmive racionale. Shumë fusha të ndryshme të planit mësimor bëjnë inkorporimin e përpunimit të informatave si një element esencial të mësimnxënies së nxënësve, përfshirë këtu mbledhjen e të dhënave, analizën kritike, qasjet krahasuese, multi-perspektivën, etj. Interneti, shtypi, librat, TV-ja dhe industria e filmit, të gjitha këto ofrojnë material të bollshëm për ti shtyrë nxënësit që të analizojnë çështjet politike, etike, sociale dhe kulturore. Prandaj, të gjithë mësuesit e lëndës duhet të jenë të ndërgjegjshëm që në ndërmarrjen e aktiviteteve të tilla me nxënësit në planet e tyre të punës, në planet mësimore dhe në proceset e mësimdhënies, ata do të zhvillojnë shkathtësi të shumta në lidhje me EQD/EDNJ. Format e ndryshme të mediave, statistikat dhe resurset me bazë në TIK ofrojnë mundësi të bollshme për praktikimin e këtyre shkathtësive në klasë. Nëse të rinjtë duan ti arsyetojnë opinionet e tyre apo të prezantojnë argumente për ndryshime, të gjejnë dhe të përdorin shembujt në mënyrë sa më efektive që është e mundur, është esenciale që të kenë besim në shkathtësitë e tyre për trajtim të informatave.

Puna bashkëpunuese në kuadër të partneriteteve të duhura të komunitetit do të përfshijë projektet e qytetarisë aktive në nivelet lokale, nacionale apo ndërkombëtare, si dhe planifikimin për angazhim të komunitetit në të ardhmen ku të rinjtë kanë mundësi të bëjnë ndryshime. Roli i EQD/EDNJ në edukimin e të rinjve shtrihet përtej kufizimeve formale të klasës. Nxënësit mësojnë gjithashtu si të bëhen qytetarë aktiv përmes lidhjeve të krijuara ndërmjet shkollës dhe partnerëve të ndryshëm në komunitetin e gjerë. Një aspekt me rëndësi i edukimit të mësuesve për EQD/EDNJ, prandaj është sigurimi i ekspertizës për mësuesit që ta organizojnë këtë dimension të mësimit të EQD/EDNJ.

[31] 31. Dewey, J., *Demokracia dhe edukimi*, NY Free Press (1916), 1966. Poashtu në dispozicion në Google books: http://books.google.com. Sipas pikëpamjes së Dewey, roli esencial i shkollës publike është zhvillimi i shoqërive demokratike. Ai argumentin që shkollat publike nuk ekzistojnë vetëm për ti shërbyer publikut, por edhe për "të krijuar publikun" me vlera të përbashkëta, mirëkuptim dhe shkathtësi që do të përkrahin dhe ruajnë komunitetin demokratik. Në këtë kuptim, shkollat publike dhe komuniteti demokratik janë të pandashme.

Shkollat nganjëherë mund të jenë institucione të kufizuara në aspekt të qasjeve dhe praktikave të tyre. Koncepti i angazhimit në partneritete për mësimdhënien e programit mësimor dhe iniciativave të EQD/EDNJ, largohet nga vështrimi tradicional i edukimit ku mësuesi individual mëson planet, mban mësimin dhe shqyrton programin mësimor. Nuk ka dyshim që EQD/EDNJ bëhet më efektiv nëse shkollat mund të shikojnë jashtë dhe përtej modeleve ekzistuese të operimit. Të rinjtë duhet të zhvillojnë atë që Henry Giroux e[32] quan "gjuhë e mundësisë" për ta parë veten si agjentë të ndryshimeve. Mësuesit do të duhet tu ndihmojnë nxënësve të tyre të imagjinojnë një të ardhme më të mirë lokale dhe globale, dhe të sigurojnë mjetet (njohuritë, shkathtësisë dhe vetëbesimin) për të ndërmarrë disa hapa praktik për arritjen e asaj të ardhmeje.

Qasjet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që vënë në plan të parë projektet aktive dhe me pjesëmarrje në EQD/EDNJ në të cilat të rinjtë kanë ndjenjën reale të pronësisë mund të shihen qartë si investim në kapitalin shoqëror për të ardhmen.

Për të qenë në gjendje të ushtrojnë ndikim në ndryshimet reale, shkollat dhe nxënësit padyshim që do të duhet të punojnë pranë dhe me partnerët e ndryshëm që e përbëjnë një "komunitet" dhe që përfshijnë sa më tepër sektorë të komunitetit në procesin e edukimit, që nevojiten për krijim të ndryshimeve: prindërit, familjet, OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile, kishat, grupet e interesit, përfaqësuesit e komunitetit, zyrtarët e zgjedhur, profesionistët e mediave, administratat lokale, etj.

Ekzistojnë të dhëna nga kërkimet në mbështetje të kësaj qasjeje:

- zhvillimi i kompetencave të qytetarisë demokratike me anë të lidhjes së shkollës dhe komunitetit mund të kontribuojë në përmirësimin e problemeve të shoqërisë dhe në promovimin e kohezionit social përmes veprimeve si inkurajimi i krijimit të rrjeteve dhe partneriteteve qytetare përreth EQD/EDNJ[33];
- mësimi i shërbimit[34] si një aktivitet specifik që bën lidhjen e shkollës me komunitetin ka efekte pozitive në fushat e ndryshme të zhvillimit të nxënësve, sikur që janë:
- përgjegjësia personale dhe shoqërore e nxënësve;
- zhvillimi interpersonal i nxënësve dhe aftësia për tu lidhur me grupet e shumëllojshme kulturore: ata kënaqen kur u ndihmojnë të tjerëve, zhvillojnë lidhje me më të vjetrit dhe pajtohen që mund të punojnë bashkë me të moshuarit dhe me personat me paaftësi;
- ndjenja e nxënësve për përgjegjësinë shoqërore dhe qytetare si dhe kompetencat e tyre të qytetarisë: nxënësit e shkollës së lartë kanë zhvilluar ndërgjegjësim më të sofistikuar për kontekstet socio-historike, ata mendojnë për politikat dhe për parimet morale në shoqëri, dhe shqyrtojnë mundësitë për të ushtruar ndikim në ndryshimet shoqërore. Ata duan të jenë politikisht më aktiv;
- mësimi i shërbimit ka ndikim në anëtarët e komunitetit si partnerë të shkollave: ata vijnë si shohin të rinjtë si resurs të vlefshëm të komunitetit.

---

32 Giroux, H., *Kultura e ideologjisë dhe procesi i shkollimit*, Temple University Press, Philadelphia/ Falmer Press, Londër, 1981.

33 Këshilli i Evropës, *"Të mësuarit dhe të jetuarit e demokracisë*. Koncept dokument", Komiteti ad hoc i ekspertëve për Vitin evropian të qytetarisë përmes edukimit, CAHCIT, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2005.

34 Billig, S. dhe Shelley, H., *Hulumtim në shkollat K-12 i mësimit të shërbimit me bazë në shkollë. Mbledhja e provave*. PhiDelta Kappan, Science Education, Bloomington, në një studim të sponsoruar nga Korporata Carnegie Corporation e Nju Jorkut dhe CIRCLE (Qendra për informim dhe kërkim në mësimin dhe angazhimin qytetar), 2000.

• kërkimet tjera për ndikimin e të mësuarit të shërbimit tregojnë që kjo është një praktikë legjitime dhe e fuqishme që u lejon nxënësve të kuptojnë më mirë konceptet që kanë të bëjnë me qytetarinë demokratike, ndërsa kontribuojnë për komunitetet e tyre dhe i plotësojnë nevojat autentike të komunitetit[35].

Është me rëndësi të njihet fakti që disa shkolla fillojnë me përparësi të caktuara, kur është fjala për zhvillimin e angazhimit të komunitetit në mbështetje të EQD/EDNJ. Një rrezik i qartë nga fokusimi në kapitalin social është që, sikur me të gjitha llojet tjera të kapitalit, sa më i madh të jetë stoku që e keni në fillim, aq më i fuqishëm është potenciali për zhvillim të mëtejmë[36]. Shkollat mund të mos i shërbejnë vetëm një komuniteti por disa komuniteteve të fragmentuara dhe të ndryshme. Mësuesit duhet të jenë të kënaqur me ndërmarrjen e hapave të sigurt dhe nganjëherë të hapave të vegjël në aspekt të ecjes përpara në këtë fushë.

Strategjitë për kundërshtim të të gjitha formave të diskriminimit duhet të mësohen për tu ndihmuar nxënësve që të kuptojnë kompleksitetin e çështjes. Të kuptuarit e racizmit, dhe të formave të tjera të paragjykimit dhe diskriminimit sikur që janë seksizmi, homofobia dhe diskriminimi religjioz në raport me mënyrën në të cilën ato bashkërisht mund të shërbejnë për të dëmtuar demokracinë, janë tipare esenciale të cilitdo programi të edukimit që synon të promovojë alfabetizmin politik të qytetarëve. Nxënësit duhet të kuptojnë që fjala e lirë nuk është absolute. Komentet raciste apo anti-semitike nuk kanë vend në shkolla, dhe shkollat kanë obligim ligjor që të monitorojnë, regjistrojnë dhe të veprojnë në rast të incidenteve raciste. Racizmi njihet zyrtarisht në kuadër të parimeve globale të OKB-së dhe në politikat qeveritare në nivelet evropiane dhe nacionale si një nga forcat që operon për të kufizuar të drejtat qytetare të minoriteteve dhe që dëmton parimet e demokracisë. Neni 13 i Konventës së OKB për të drejtat e fëmijës (1989) thotë që, "Fëmijët duhet të kenë të drejtën e lirisë së shprehjes … për aq sa kjo nuk dëmton të drejtat dhe reputacionet e të tjerëve[37]." Konventa evropiane për të drejtat e njeriut (1950) thotë në Nenin 10, paragrafët 1 dhe 2, që "Gjithsecili ka të drejtë në lirinë e shprehjes…

Ushtrimi i këtyre të drejtave, pasi që mbart me vete detyra dhe përgjegjësi mund tu nënshtrohet atyre … kushteve … që janë … të domosdoshme në një shoqëri demokratike[38]."

Shkollat janë vende kyçe për të promovuar mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve dhe për të luftuar jo tolerancën dhe ekstremizmin religjioz. Edukimi ka një rol parësor në sfidimin e paragjykimeve; ndërtimin e mirëkuptimit ndërmjet individëve dhe komuniteteve; fuqizimin e grupeve në situatë të pafavorshme; dhe për inkurajimin e debatit të hapur dhe me respekt. Secili program serioz i EQD/EDNJ duhet ti pajisë të rinjtë me njohuri dhe shkathtësi për kundërshtimin e racizmit si një forcë anti –demokratike dhe për të kuptuar funksionin themelor të racizmit, anti-semitizmit dhe të diskriminimit në shoqëritë tona, si dhe dimensionet e tyre ekonomike e politike. Një projekt i tillë duhet gjithashtu tu mundësojë të rinjve zhvillimin e një serie të identiteteve të sigurta dhe me besim në

---

35 Ibid

36 Zacharakis-Jutz, J. dhe Flora, J., "Çështjet dhe përvojat me përdorimin e hulumtimit me pjesëmarrje për forcim të kapitalit social në zhvillimin e komunitetit", në Armstrong, P., Millerm, N. dhe Zukas, M. (eds), *Kalimi i kufijve, thyerja e barrierave*, Universiteti i Londrës, 1997.

37 Shih: www.unesco.org/education/pdf/CHILD_E.PDF.

38 Shih: www.hri.org/docs/ECHR50.html#C.Art10.

vete si qytetarë; "qytetarët e rinj me besim në identitetet e tyre, do të jenë në pozitë të fuqishme që të sfidojnë imazhet stereotipe të minoriteteve që aktualisht ndihmojnë në përkrahjen e praktikave diskriminuese[39]."

Të dhënat nga kërkimet tregojnë që një qasje e përbashkët, e përvetësuar nga shumë mësues për mësimin e çështjeve kundërthënëse, sikur që janë diskriminimi dhe racizmi, është që të anashkalohen ato. Për shembull, në një kritikë të hollësishme të mënyrës si një shkollë e integruar në Irlandën Veriore i është qasur mësimit të edukimit për mirëkuptim reciprok, Donnelly[40]ka treguar që: "Shumica e mësuesve bëjnë 'zgjedhje kritike' që reflektojnë dhe forcojnë 'kulturën e shmangies', ku çështjet e diskutueshme politike apo religjioze shmangen në vend se të eksplorohen." Shkollat duhet të jenë të përgatitura për trajtimin e temave kundërthënëse në lajme, sikur që janë debatet për migrimin dhe integrimin e komuniteteve të emigrantëve: "Është detyrë e të gjitha shkollave që të adresojnë çështjet e 'si jetojmë bashkë' dhe 'trajtimin e dallimeve, sado të vështira apo kundërthënëse të jenë ato"[41].

EQD/EDNJ prandaj ka një rol fundamental për të lozur në zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive për raporte efektive në komunitet, për identitete të përbashkëta dhe për mënyra të sigurta në të cilat do të shpreheshin dallimet. Kjo nënkupton edukimin për qytetari kozmopolitane[42]. Është me rëndësi që të rinjtë të jenë në gjendje të kapërcejnë perspektivat e ngushta nacionale lidhur me identitetin dhe diversitetin, dhe të rrënjosin të menduarit e tyre brenda një perspektive më globale të të drejtave të njeriut. Qasja e të drejtave të njeriut është me rëndësi sepse prezanton idenë fundamentale që madje edhe qeveritë demokratike mund të jenë shtypëse, veçmas në trajtimin e grupeve minoritare. Vlerat e të drejtave të njeriut dhe kodet e parimet ndërkombëtare ofrojnë një perspektivë me të cilën bëhet vlerësimi kritik i nivelit real të barazisë në shoqëri.

Vlen të identifikohen (mbase përmes këshillit të shkollës) projektet nga jeta reale që mund të ndihmojnë në ndërtimin e kohezionit në komunitet dhe të ndërtuara drejt ngjarjeve përmbajtësore sikur që janë ekspozitat, fushatat dhe debatet, me përfshirjen jo vetëm të shkollës por edhe të komunitetit, për të parë "kush jemi ne".

---

[39] Osler, A., Raporti Crick diferencat, barazia dhe drejtësia racore", *Curriculum Journal*, Vëllimi 11(1), 2000, fq. 25-37.

[40] Donnelly, C., "Cili çmim për harmoninë? Metodat e mësuesve për bartjen e etosit të tolerancës dhe respektit për diversitetin në një shkollë të integruar në Irlandën e Veriut", *Educational Research*, Vëllimi46 (1),

[41] Ajegbo, K., *Shqyrtim i programit mësimor: diversiteti dhe qytetaria*, DfES, 2007.

[42] Për zhvillimin e konceptit të "qytetarisë kozmopolite" shih Held, D., "Demokracia dhe rendi i ri ndërkombëtar", në Achibugi, D. dhe Held, D. (eds), *Cosmopolitan democracy*, Polity Press, Cambridge, 1995; Osler, A. dhe Starkey, H.,"Të mësuarit për qytetari kozmopolite: debate teorike dhe përvojat e të rinjve", *Educational Review*, 55 (3),2003, fq. 243-254.

## 6.2. Kompetenca nr. 10

**Kompetenca nr. 10: mjedisi mësimor që promovon përdorimin e resurseve të ndryshme**
Mjedisi mësimor që u mundëson nxënësve të analizojnë çështjet politike, etike, sociale dhe kulturore, problemet apo ngjarjet në mënyrë kritike, me përdorimin e informatave nga burimet e ndryshme, përfshirë këtu mediat, statistikat dhe resurset e bazuara në TIK.

### 6.2.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Në mënyrë specifike, mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ do të demonstrojnë për shembull që:

➔I përdorin të dhënat e mbledhura në mësimdhënien e lëndës së tyre, për të zhvilluar argumentet lidhur me nevojën për projekte të EQD/EDNJ. Për shembull:

– mësuesit e historisë mund të kërkojnë nga nxënësit që të gjejnë, nga burimet e ndryshme të mediave, informata për shoqëritë jodemokratike në të kaluarën. Të dhënat e mbledhura dhe konkluzionet e nxjerra mund të shërbejnë për krahasim me situatën në botën moderne;
– mësuesit e gjeografisë mund të kërkojnë nga nxënësit mbledhjen e të dhënave për ndotjen apo humbjen e resurseve, dhe të kalojnë në diskutimin e perspektivave të ardhshme të qëndrueshmërisë globale, duke i dhënë diskutimit një esencë të fuqishme të përgjegjësisë dhe konsumerizmi etik;
– mësuesit e muzikës apo të artit mund të përdorin trashëgiminë kulturore dhe ndikimin e arteve për të promovuar ndjenjën e identitetit.

. ➔u mundësojnë nxënësve analizimin dhe diskutimin e aspekteve të mediave që kontribuojnë në njohuritë dhe shkathtësitë për EQD/EDNJ. Për shembull, analizimi i reklamave dhe ndikimi i tyre; eksplorimi i mbulimit kundërshtues të lajmeve në lajmet e ndryshme; liria e shtypit; si mundet TV të formojë opinionin; dhe si anketat në media dhe të opinionit mund të ndikojnë në zgjedhjet në demokraci;

. ➔krijojnë mundësi për nxënësit për eksportimin e vlerës pozitive dhe të limiteve të statistikave:

– vlerat pozitive: provat statistikore, që do të duhej tu nënshtroheshin analizave të njëjta si çdo lloj tjetër i provave, ndihmon për të siguruar një lloj gur-themeli për argumentet dhe debatet. Statistikat mund të ndihmojnë për të pasur një masë të qartë, të pavarur dhe të drejtë të asaj që ndodhë në jetën publike; qeveritë lokale dhe nacionale i përdorin statistikat në krijimin e politikave, dhe shërbimet publike rregullisht prodhojnë statistika me të cilat synojnë matjen e progresit të bërë në fushat e politikave të caktuara. Grupet e presionit prodhojnë gjithashtu statistika për ti mbështetur argumentet e tyre;
– kufizimet: vlera e statistikave varet nga saktësia e mënyrave në të cilat mblidhen dhe prezantohen informatat; nga mënyra në të cilën bëhen pyetjet; dhe nga besueshmëria e atij të prodhon informatat. Statistikat mund të fabrikohen nga regjimet politike të paskrupullta apo të "shtrembërohen" në regjimet demokratike. Ato janë të pjesshme dhe/apo selektive; disa gjëra është vështirë të maten në mënyrë sasiore.

→përdorin resurset me bazë në TIK në mënyrë efektive për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve në EQD/EDNJ:

– kjo mundëson kërkimin dhe analizën e thellë të çështjeve moderne sociale e politike;

– informatat nuk trajtohen në mënyrë pasive – kërkimi është i strukturuar. Nxënësit bëjnë diç me informatat që i shqyrtojnë;

– mundësitë për të "bërë ndryshim" dhe për ti bindur të tjerët përfshihen në aktivitetet bashkëpunuese të grupit dhe në punën në projekt;

– nxënësit bëjnë zgjedhje kritike dhe kreative lidhur me mënyrën e komunikimit të ideve të tyre.

## 6.2.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 10: mjedisi mësimor që promovon përdorimin e burimeve të ndryshme** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Ju nuk keni menduar se si mediat e ndryshme, statistikat dhe TIK mund të jenë pjesë e mësimdhënies suaj, si burim, metodë dhe temë. Thuajse krejt pak keni shqyrtuar se si këto resurse mund të pasurojnë mësimdhënien tuaj dhe të fusin përmbajtjen dhe metodologjinë e EQD/EDNJ në mësimdhënien tuaj. Ndjeheni të papërgatitur për ti përdorur mediat, statistikat dhe TIK në mësimdhënien tuaj.* | **Provoni këtë:**<br>• filloni duke gjetur mediat e përshtatshme, statistikat dhe resurset e TIK (gazetat, revistat, buletinet, Raportet, transmetimet e lajmeve, ueb faqet, etj.) që mbështesin planin tuaj mësimor;<br>•siguroni që keni besim në metodat e përdorimit të atyre resurseve në mësimdhënien tuaj, nëse ka nevojë duke kërkuar mundësi për trajnim;<br>• konsultohuni me kolegët tuaj dhe gjeni disa ide të reja;<br>• analizoni resurset që keni identifikuar. Si përshtaten ato me programin tuaj mësimor? Si mund të ndihmojnë ato në zhvillimin e shkathtësive kërkimore dhe analitike të nxënësve në lidhje me çështjet moderne? |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Jeni të vetëdijshëm që mediat, statistikat dhe TIK mund të kontribuojnë për mësimdhënien tuaj në klasë. Ju keni identifikuar një përmbajtje relevante dhe planifikoni disa aktivitete në mësimdhënien tuaj në klasë. Është një përpjekje e limituar dhe nuk jeni të sigurt sa ka qenë efektive mësimdhënia juaj në zhvillimin e shkathtësive analitike dhe kërkimore të nxënësve.* | **Provoni këtë:**<br>• ndërsa planifikoni mësimet tuaja, përfshini mediat, statistikat apo aktivitetet me bazë në TIK, duke identifikuar qartë synimet dhe qëllimet për këtë;<br>• siguroni që keni mjaft resurse për secilin nxënës apo grup;<br>• përgatisni instruksione të qarta (tabela pune, detyra, lista të gjërave që duhen bërë, etj.) për nxënësit;<br>• mbani mësim dhe vlerësoni mësimin duke përdorur punën e nxënësve si tregues kyç të suksesit;<br>• kërkoni nga studentët që të ndajnë me klasën atë që kanë mësuar gjatë procesit |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Keni gjetur një mënyrë sistematike për të përdorur mediat, statistikat dhe TIK në mësimdhënien tuaj në klasë dhe për të bërë lidhjet me EQD/EDNJ. I përdorni shpesh ato, madje nganjëherë në mënyrë të qartë si element i parë në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve. Lidhjet me EQD/EDNJ edhe më tej mund të përfaqësojnë koincidencë të përmbajtjes së lëndës se sa "mësim të thellë".* | **Provoni këtë:**<br>• u jipni nxënësve një rol më të pavarur në planifikimin e përdorimit të mediave, statistikave dhe TIK në mësimet e tyre. Provoni të përfshini çështjet me interes për ta në mësimdhënien tuaj, për të maksimizuar angazhimin dhe interesimin e nxënësve;<br>• bashkëpunoni me kolegët tuaj. Inkurajojini ata që të zhvillojnë punën ekipore ndërmjet mësueseve të lëndëve të ndryshme për të arritur qëllimet dhe synimet e EQD/EDNJ dhe për të mbështetur qasjen demokratike në tërë shkollën;<br>• gjithnjë merrni informata prapavepruese në lidhje me efektet e mësimdhënies suaj (mbase përmes përdorimit të vetë-vlerësimit apo vlerësimit të moshatarëve). |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Përdorimi i mediave, statistikave dhe TIK në mësimdhënien tuaj në klasë – dhe bërja e lidhjeve eksplicite me çështjet, shqetësimet dhe vlerat e EQD/EDNJ – është bërë pjesë natyrore dhe e pandarë e performansës suaj profesionale.* | **Provoni këtë:**<br>• transformoni nxënësit tuaj nga përdorues të mediave dhe të TIK në krijues dhe prodhues të informacionit;<br>• inkurajojini ata që të zhvillojnë shkathtësitë e avokimit dhe të bindjes në raport me një çështje që i shqetëson ata, duke përdorur informata dhe mjete në mbështetje të argumenteve të tyre;<br>• ndani njohuritë dhe shkathtësitë tuaja me kolegët. |

## 6.3. Kompetenca nr. 11

**Kompetenca nr. 11: puna bashkëpunuese në kuadër të partneriteteve të duhura me komunitetin**

Puna bashkëpunuese me partnerët e duhur (sikur që janë komuniteti, OJQ-të apo përfaqësuesit e organizatave vullnetare) në planifikimin dhe implementimin e vargut të mundësive për angazhim të nxënësve në çështjet e qytetarisë demokratike në komunitetet e tyre.

### 6.3.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD do të demonstrojnë për shembull që:

- janë në gjendje të formojnë lidhje pune me grupet e komunitetit, duke identifikuar partnerë të përshtatshëm dhe të përkushtuar që pajtohen për dobinë reciproke dhe punojnë në mënyrë të strukturuar;
- janë në gjendje të ndërtojnë dhe të thellojnë partneritetet me partnerët (prindërit, familjet, OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile, kishat, grupet e interesit, përfaqësuesit e komunitetit, zyrtarët e zgjedhur, profesionistët e mediave, administratat lokale, muzetë, bibliotekat, etj.), duke u pajtuar për një vizion të përbashkët dhe përcaktim të synimeve. Parimet drejtuese të partneriteteve shkollë/komunitet ka mundësi të përfshijnë: barazinë dhe respektin reciprok; përqendrimin në nxënësit dhe përfshirjen e tyre, qartësinë e vizionit dhe të synimeve, sinqeritetin, përkushtimin e vazhdueshëm, gatishmërinë për të provuar qasje të reja dhe realizmin rreth asaj që mund të bëhet;
- janë vigjilent për çështjet e balancimit të mësimit tek nxënësit; është me rëndësi të monitorohet natyra e komunikimit të tyre me të rinjtë për të shmangur "futjen e pakoordinuar të anësisë ideologjike nga ata që mendojnë se kanë të drejtë;[43]
- mund të identifikojnë një varg të "veprimeve për ndryshim" që do të shtojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve në EQD dhe do të jenë me dobi për komunitetin. Për shembull:

– të shkruarit dhe/apo prezantimi i një rasti para të tjerëve lidhur me një shqetësim apo çështje; komunikimi dhe shprehja e qëndrimeve publikisht përmes buletinit informativ, ueb faqes apo medias tjetër;
– zhvillimi i konsultimeve, votimeve apo zgjedhjeve; kontributi për politikat lokale/të komunitetit;
– organizimi i një takimi, konference, forumi apo debati; përfaqësimi i qëndrimeve të të tjerëve (për shembull në një organizim, takim apo ngjarje);
– krijimi, rishikimi apo ripunimi i një politike organizative;
– organizimi dhe ndërmarrja e një ekspozite, fushate, shfaqjeje, tubimi në komunitet (për shembull, dramë, festim apo ditë e hapur);
– krijimi dhe zhvillimi i një grupi veprues apo rrjeti;

- mund të menaxhojnë përfshirjen e partnerëve nga komuniteti, duke asistuar për shembull kur të rriturit që nuk mbajnë mësim vazhdojnë "tu flasin" të rinjve për një periudhë të gjatë. Mësuesit duhet të sigurojnë që të gjithë të rriturit në klasë janë të qartë për rolet e tyre në mësim dhe si mund të japin kontribut;
- mund të shqyrtojnë bashkërisht dhe të vlerësojnë suksesin e cilitdo projekti të përbashkët, të konsultohen me nxënësit për përshtypjet e tyre; të mendojnë si të ndajnë punën e nxënësve në EQD me prindërit dhe me komunitetin me anë të buletineve informative, prezantimeve, ueb faqeve etj; dhe të themelojnë qartësinë lidhur me partneritet e ardhshme.

43. Gearon, L., "OJQ-të dhe edukimi: disa gjykime paraprake", *Reflecting Education*, fq 17, 2 tetor 2006.

44. Lista e inspiruar nga QCA, *Luaj pjesën tënde: qytetaria pas moshës 16 vjeçare*, QCA, Londër, 2004.

## 6.3.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 11: puna bashkëpunuese brenda partneriteteve të duhura me komunitetin** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Partnerët nga komuniteti shfrytëzohen pak ose aspak në aktivitetet rreth programit mësimor. Vizitorët përdoren në mënyrë ad hoc individuale. Prindërit dhe komunitetit përgjithësisht janë të painformuar për qasjen e shkollës ndaj EQD/EDNJ. Shkolla nuk ka shqyrtuar krijimin e faqes për EQD/EDNJ në ueb faqen e shkollës, ku komuniteti do të kishte qasje.* | **Provoni këtë:**<br>• shikoni për disa aleatë fillestarë që mund të jenë të interesuar të punojnë me nxënësit në shkollën tuaj (për shembull prindërit me lidhje me OJQ-të apo me grupet e presionit; përfaqësuesit e organeve lokale që bëjnë punë edukative; dhe këshilltarët lokal);<br>• krijoni një apo dy projekte të programit mësimor që përmbajnë "veprimin për ndryshim" dhe/apo i inkurajojnë nxënësit që të "bëjnë dallim" në lidhje me një çështje me interes për ta. Vlerësoni rezultatet;<br>• mundohuni të krijoni disa udhëzime të politikës së shkollës në lidhje me shfrytëzimin më efektiv të vizitorëve të jashtëm. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Agjencitë lokale dhe nacionale përdoren në një masë si resurse për mbështetjen e aktiviteteve në klasë. Përfaqësuesit e komunitetit përdoren në një masë të caktuar për mbështetjen e aktiviteteve të EQD/EDNJ. EQD/EDNJ përmendet në buletinet informative të shkollës dhe në komunitetin e gjerë. Shkolla ka një ueb faqe që përfshin faqen për EQD/EDNJ.* | **Provoni këtë:**<br>• përpiquni të thelloni partneritetet me grupet specifike të komunitetit apo me OJQ-të që mbështesin projektet e EQD/EDNJ – për shembull, përmes pajtimit të një vizioni të përbashkët dhe përcaktimit të objektivave vjetore;<br>• bisedoni me prindërit e nxënësve për të identifikuar fushat e shqetësimit për komunitetin lokal, dhe më pas orientoni kërkimin tuaj për partnerë relevant për trajtimin e kësaj çështjeje;<br>• punoni me kolegët për të përcaktuar shtrirjen dhe shkallën e përfshirjes së shkollës me partnerët nga komuniteti në lidhje me çështjet dhe mundësitë për EQD/EDNJ;<br>•përmirësoni informimin e vizitorëve nga komuniteti apo vizitorëve nga OJQ-të ashtu që përfshirja e partnerëve nga jashtë të mos shihet nga nxënësit si një ngjarje e njëhershme por si pjesë e procesit mësimor. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Gjetja/kontrollimi i resurseve të komunitetit përkrahë planifikimin për aktivitetet e EQD/EDNJ. Partnerët nga komuniteti pranojnë udhëzime të qarta për rolin e tyre. komunikimi për aktivitetet është i vazhdueshëm. Rezultatet e projektit dhe arritjet e nxënësve publikohen (dhe përkthehen nëse ka nevojë) në ueb faqe dhe u dorëzohen prindërve gjatë ngjarjeve speciale (për shembull takimeve me prindër).* | **Provoni këtë:**<br>• diversifikoni vargun e kanaleve të komunikimit përmes të cilave publikoni faktin që EQD/EDNJ ekziston dhe shpjegoni atë për prindërit dhe për palët lokale të interesuara;<br>• informoni palët lokale kyçe për progresin që keni bërë në shkollën dhe/apo klasën tuaj në fushën e EQD/EDNJ përmes buletineve informative apo përmes njoftimit të të arriturave të nxënësve përmes shtypit lokal, ueb faqes së shkollës apo kanaleve të tjera në media;<br>• identifikoni mënyrat për pasurim të mëtejmë të përvojës së nxënësve në EQD/EDNJ përmes përfshirjes më të madhe të OJQ-ve në shkollën/klasën tuaj – për shembull, përfaqësuesit nga organizatat mjedisore, organizatat bamirëse, grupet e presionit apo organizatat globale. Shikoni si të ndizni dhe të zbërtheni idealizmin (nganjëherë latent) të nxënësve. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Partnerët nga komuniteti organizojnë, mbështesin dhe iniciojnë aktivitete të EQD/EDNJ në shkollë në partneritet të plotë dhe efektiv. Mekanizmat e komunikimit drejtohen nga nxënësit dhe janë dinamike – duke ofruar informata dhe resurse për prindërit dhe komunitetin.* | **Provoni këtë:**<br>• i tërë komuniteti përfiton nga një shkollë prosperuese. Organizoni projekte që u mundësojnë nxënësve të punojnë bashkë me një varg të partnerëve nga komuniteti në përmirësimin e shërbimeve të ndryshme që kanë ndikim në të rinjtë (për shembull, objektet rekreative, çështjet e transportit dhe të gjelbërimit);<br>• vazhdoni të shqyrtoni dhe të vlerësoni partneritetet dhe mundësitë për projekte të ardhshme;<br>• mbështetni nxënësit në përpjekjet e tyre për grumbullim të fondeve për fushatat e tyre dhe iniciativat tjera;<br>• shikoni për mënyra që mundësojnë që projektet të drejtohen nga nxënësit me më pak përfshirje nga të rriturit/mësuesit. |

## 6.4. Kompetenca nr. 12

**Kompetenca nr. 12: strategjitë për sfidimin e të gjitha formave të diskriminimit**
Strategjitë për sfidimin e të gjitha formave të paragjykimit dhe diskriminimit, dhe për promovim të anti-racizmit

### 6.4.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë që …"

Në mënyrë specifike, mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ do të demonstrojnë për shembull që:

➜krijojnë mjedisore gjithëpërfshirëse mësimore në klasë në të cilat kontributi i të gjithë nxënësve vlerësohet, qëndrimet stereotipe sfidohen, dhe nxënësit mund të vlerësojnë dhe ti shikojnë pozitivisht dallimet tek të tjerët. Ata iniciojnë projekte që përfitojnë nga diversiteti në klasë dhe në shkollë. Për shembull:

– me krijimin e paraqitjeve që marrin formën e reflektimit për çështjet përkatëse;
– me prezantimin e imazheve pozitive për të arriturat e të gjitha grupeve;
– me përzgjedhjen e resurseve mësimore për nxënësit që janë të përshtatshme për interesat, përvojat dhe nevojat e tyre;
– me dekurajimin e stereotipeve dhe me inkurajimin e qëndrimeve pozitive drejt kontributit për një shoqëri të njerëzve të ndryshëm;
– me inkurajimin e qëndrimeve pozitive ndaj diversitetit gjuhësor tek nxënësit;
– me shfaqjen e fleksibilitetit në grupimin e strategjive që u japin nxënësve mundësinë të përjetojnë punën bashkëpunuese me moshatarët nga sfondet e ndryshme dhe me nevoja të ndryshme. Me fjalë të tjera: nxënësit përgatiten për të jetuar në shoqëri me diversitet dhe ndërvarësi;

➜kuptojnë që diskriminimi, racizmi dhe anti-semitizmi vijnë në forma të ndryshme. Ato mund të definohen si fjalë apo veprime që kanë si cak individin apo grupin, qoftë të pranishëm ose jo, që nënkupton agresionin, poshtërimin, përqeshjen, uljen e vetëbesimit të personit për shkak të çështjeve të prejardhjes, nacionalitetit, religjionit, gjinisë, orientimit seksual, paaftësisë apo pamjes. Incidentet e këtij lloji përfshijnë:

– abuzimin verbal, kërcënimet, përdorimin e emrave përçmues, fyerjeve, anti-feminizmin, shakatë diskriminuese racist/anti-Semitike, komentet raciste "të rastit" gjatë diskutimeve dhe përqeshjen e zakoneve kulturore (për shembull, ushqimi, muzika, religjioni, veshjet);
– sulmi fizik, ngacmimi, sjellja provokative si vënia e shenjave raciste, dhe nxitja e të tjerëve për tu sjellë në mënyrë raciste;
– refuzimi për të bashkëpunuar me nxënësit tjerë apo të rriturit për shkak të dallimeve të perceptuara; sjellja e materialeve raciste në shkollë;

➜tregojnë ndërgjegjësim praktik për konceptin e identiteteve të shumëfishta dhe ndryshuese dhe si punojmë me këto identitete. Zhvillimi i identiteteve të shumëfishta është esencial për të gjithë të rinjtë, ashtu që të mund të bashkërendojnë vlerat personale apo "private" me ato të komunitetit publik;

➜janë të ndërgjegjshëm për politikat nacionale dhe lokale dhe procedurat për trajtimin e incidenteve të sjelljes së papranueshme dhe për hapat që do të merren në shkollë për trajtimin e incidenteve raciste dhe anti-semite. Janë të qartë për rregullat themelore të klasës – për shembull, "pa poshtërime" apo "mos kaloni në terren personal";

➜në mënyrë aktive promovojnë mundësitë e barabarta dhe tregojnë mirëkuptim për

mënyrën si mund të veprojë pabarazia në dhe jashtë shkollës. Ata janë të vetëdijshëm për "dinamikën e fuqisë" dhe si racizmi, anti-semitizmi dhe të gjitha format e diskriminimit luajnë rol të veçantë në shoqëritë tona, duke siguruar përsëritjen e pandërprerë të modeleve të dominimit ekonomik e politik. Ata zhvillojë shkathtësitë e lehtësimit të projekteve duke punuar përkrah nxënësve, për tu dhënë mundësinë e nisjes së kundërshtimit të llojeve të ndryshme të pabarazisë dhe përfshihen në projektet e ndërtimit të urave që ndihmojnë në pajtimin e dallimeve dhe në krijimin e ndjenjës së përbashkët të përkatësisë dhe komunitetit.

## 6.4.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 12: strategjitë për sfidimin e të gjitha llojeve të diskriminimit (Pjesa 1)** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Nuk i shihni çështjet që lidhen me paragjykimet e nxënësve, qëndrimet stereoptipe, apo qëndrimet raciste (të shprehura apo të nënkuptuara) si çështje me interes për shkollën, mësuesin apo zonën lokale, apo nuk jeni të gatshëm ti trajtoni ato.*<br>*Temat ku racizmi mund të bëhet çështje kanë tendencë të shmangen. Jeni të pasigurt sa i përket njohurive tuaja për kulturat e ndryshme dhe mund të ndjeheni më mirë nëse nuk thoni asgjë se sa të shkaktoni ofendim pa qëllim. Prania e atyre temave në programin mësimor është e limituar. Mund të ketë politika nacionale apo shkollore në lidhje me luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë së racave por dokumentet kanë zënë të vënë pluhur mbi to. Ka pasur pak ose aspak trajnim të mësuesve në këtë çështje* | **Provoni këtë:**<br>• informohuni dhe gjeni trajnimin për këtë çështje;<br>• lexoni libra për çështjet e pabarazisë dhe diskriminimit në sistemin shkollor; situatën e komunitetit rom në Evropë; dhe për racizmin dhe anti-semitizmin në shoqëritë tona;<br>• mos supozoni që paragjykimet, diskriminimi dhe racizmi nuk janë problem nëse popullata e shkollës suaj është relativisht homogjene dhe nuk përmban shumë grupe minoritare;<br>• filloni duke siguruar që skemat tuaja të punës dhe planeve mësimore për EQD/EDNJ ofrojnë disa mundësi që nxënësit të merren me stereotipat, të kuptojnë si duhet natyrën e paragjykimit dhe diskriminimit, dhe përfshini një mori perspektivash kulturore;<br>• zhvilloni aktivitete që promovojnë ndjeshmërinë dhe vetëdijesimin për natyrën dinamike të kulturës dhe identiteteve. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Shkolla ka një politikë moderne të barazisë që mbulon shumicën e fushave dhe funksioneve relevante. Literatura raciste është e paligjshme dhe grafitet ofenduese janë të ndaluara dhe largohen. Vërejtjet negative dhe përgjithësimet lidhur me grupet e njerëzve kundërshtohen vazhdimisht. Stafi i shkollës reagon drejt dhe në mënyrë konsistente ndaj incidenteve me motive raciale, pasi që ka pranuar një trajnim. Materialet mësimore gjithnjë e më tepër reflektojnë diversitetin lokal, nacional e global por qasjet ndaj mësimit kanë tendencë të jenë mjaft të sigurta dhe shmangin kundërthëniet. Ju frikësoheni që rregullat bazë për diskutim të hapur dhe debat nuk mund të aplikohen kur debatohen çështjet në lidhje me racën. Frikësoheni që diskutimi i hapur inkurajon apo madje legjitimon qëndrimet raciste të nxënësve, duke shkaktuar ofendim për të tjerët në klasë dhe mbase duke përhapur qëndrime të papranueshme në shkollë.* | **Provoni këtë:**<br>• për momentin tërë puna juaj në lidhje me paragjykimin, diskriminimin dhe racizmin është reaguese në vend se proaktive. Shikoni për hapat pozitiv që mund ti ndërmerrni për përmirësimin e mundësive mësimore për nxënësit në lidhje me këto çështje;<br>• nëse është e mundur, inkurajoni nxënësit që e shohin veten dhe të tjerët si të ndryshëm, që të komunikojnë dhe të mësojnë bashkë;<br>• shikoni për trajnimet rreth strategjive në klasë në lidhje me mësimin e çështjeve kundërthënëse;<br>• shikoni për trajnimet rreth metodologjive për ngritje të vetëdijes për prirjet ndërkulturore. Këtu, ndërkulturore i referohet të kuptuarit të individualitetit të barabartë, dhe ndërgjegjësimit për natyrën dinamike të kulturës dhe të shumësisë së identiteteve të secilit qytetar;<br>• siguroni që brenda programit mësimor do të mbulohet sjellja ndërpersonale në mesin e nxënësve, Përfshirë këtu thirrjen me emra ofendues dhe ngacmimin, dhe që kjo do të lidhet me çështjet më të gjera të mësimit të EQD. |

| Kompetenca nr. 12: strategjitë për sfidimin e të gjitha llojeve të diskriminimit (Pjesa 2) | |
|---|---|
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Politika e shkollës për barazinë racore është e lehtë për tu kuptuar dhe e përshtatshme për audiencat dhe nevojat e ndryshme.*<br>*Shkolla bartë mesazhe të dukshme dhe konsistente që diversiteti lartësohet dhe racizmi shpallet i paligjshëm. Ndonëse trajnimi për tërë shkollën për metodologjitë e duhura për ndryshim të qëndrimeve ndaj të tjerëve nuk është mbajtur ende, çështjet e cilësisë gjithnjë e më shumë adresohen përmes trajnimit në shërbim.*<br>*Aktivitetet dhe resurset theksojnë çështjet globale, përvojat dhe shqetësimet.* | **Provoni këtë:**<br>• krijoni një kod të sjelljes për të promovuar raportet e mira dhe respektin reciprok; shfaqeni në mënyrë të dukshme në hapësirat e përbashkëta;<br>• mendoni për mënyrën në të cilën planet tuaja mësimore, resurset dhe zgjedhjet rreth mësimdhënies reflektojnë nevojat mësimore të të gjithë nxënësve në klasë;<br>• inkurajoni kolegët që të diskutojnë politikat e barazisë/mundësive të barabarta dhe çështjet tjera lidhur me këto dhe që të punojnë bashkërisht në identifikimin e zgjidhjeve; dhe organizoni trajnimin e moshatarëve duke përdorur resurset për trajnim;<br>• inkurajoni nxënësit që të vënë në dyshim stereotipat në media, në materialet mësimore dhe në kulturën popullore;<br>• promovoni imazhe pozitive në postera, ekspozita dhe shfaqje;<br>• gjeni resurse dhe studime të rasteve që i japin minoritetet në role jo-stereotipe;<br>• ftoni folës, prindër apo përfaqësues të komunitetit në një diskutim të përgatitur mirë me nxënësit tuaj për temën e barazisë;<br>• loboni për trajnim të tërë shkollës për ndërgjegjësim ndërkulturor |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Shkolla ka hartuar një plan për tu bërë shkollë gjithëpërfshirëse. Politika e barazisë në mënyrë aktive informon jetën e përditshme dhe punën në shkollë, përfshirë këtu programin mësimor, etosin dhe politikat e punësimit dhe është e lidhur me një plan veprimi. Stafi i shkollës kupton nevojën për kundërshtim të të gjitha formave të diskriminimit dhe për promovim të raporteve përfshirëse, dhe janë të trajnuar, të mbështetur dhe të autorizuar për ta bërë këtë.*<br>*Posterët, ekspozitat dhe shfaqjet e punës theksojnë diversitetin, gjithëpërfshirjen dhe qytetarinë globale dhe shfaqen në hapësirat e përbashkëta. Pabarazitë dhe padrejtësitë sociale kundërshtohen dhe debatohen.* | **Provoni këtë:**<br>• raportoni dhe monitoroni incidentet racist, seksuale apo diskriminuese në mënyrë më sistematike dhe përdorni gjetjet për të bazuar politikat, programet mësimore dhe menaxhimin e sjelljes, si dhe reagimet strategjike lokale/rajonale;<br>• gjeni partnerë në komunitet për tu ndihmuar që të organizoni projekte me synim të forcimit të mjedisit gjithëpërfshirës të shkollës;<br>• inkurajoni shqyrtimin dhe monitorimin e rezultateve të të gjithë nxënësve: mund të ketë veprime dhe intervenime që sugjerohen nga modelet e shfaqura;<br>• vazhdoni me përmirësimin e praktikës suaj;<br>• lartësoni sukseset tuaja dhe  pozitiv dhe gjithëpërfshirës të shkollës. |

# 7. Grupi D: implementimi dhe vlerësimi i qasjeve të EQD/EDNJ me pjesëmarrje

## 7.1. Përmbledhje e shkurtër dhe mbështetje teorike

Ky grup i kompetencave i angazhon mësuesit në reflektimin dhe vlerësimit e natyrës së efikasitetit të qasjeve ndaj EQD/EDNJ që janë implementuar, si në lidhje me kulturën e tërë shkollës dhe etosin, por edhe në lidhje me praktikën e mësimdhënies në klasat individuale. Kjo i referohet pyetjes "si mund ta bëjmë më mirë këtë?"

. • Sa kemi qenë efektiv në angazhimin e nxënësve në proceset e vendimmarrjes?
. • Sa mirë e kemi krijuar mundësinë për mësim të padyshimtë duke bërë modelimin e EQD/EDNJ në vend se të mbahet mësim për të?
. • Në aspekt të vlerësimit të mësimnxënies nga nxënësit[45], sa ka qenë efektive qasja jonë ndaj mësimit?
. • Çfarë duhet ende të mësojmë për të përmirësuar rezultatet tona?

**Kompetenca nr. 13: vlerësimi i angazhimit të nxënësve në vendimmarrje**

Vlerësimi i masës në të cilën nxënësit mund të thonë fjalën e tyre për gjërat që kanë ndikim në ta dhe sigurimi i mundësive për pjesëmarrje të nxënësve në vendimmarrje.

**Kompetenca nr. No. 14: modelimi i vlerave, qëndrimeve dhe prirjeve të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut**

Demonstrimi i vlerave pozitive, qëndrimeve dhe prirjeve për EQD/EDNJ që priten nga të rinjtë – për shembull, modelimi i një qëndrimi aktiv qytetar; raportet e drejta, të hapura dhe të respektueshme me nxënësit; përdorimi i stilit demokratik të mësimdhënies dhe përfshirja e nxënësve në planifikimin dhe pronësinë e aktiviteteve edukative.

**Kompetenca nr. 15: shqyrtimi, monitorimi dhe vlerësimi i metodave të mësimdhënies dhe të mësimit nga nxënësit**

Mundësia dhe gatishmëria për shqyrtimin, monitorimin dhe vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe të nxënies së mësimit nga nxënësit, dhe shfrytëzimi i këtij vlerësimi për të bazuar planifikimin në të ardhmen dhe zhvillimin profesional për mësimin e EQD/EDNJ.

**Tabela 7: Grupi D – Implementimi dhe vlerësimi i qasjeve me pjesëmarrje të EQD/EDNJ**

Zëri dhe pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje është me rëndësi. Nxënësit kanë të drejtë të përfshihen në vendimet që ndikojnë në ta; kjo përmirëson raportet dhe promovon dialogun në shkollë; dhe ç'është më me rëndësi, është një rast për të mësuar EQD/EDNJ.

Shumë mësues të EQD/EDNJ mendojnë që përfshirja e nxënësve në vendimmarrjen në klasë është një hap i mirë drejt procesit që në fund do të fuqizojë ata për pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme në shoqëri. Megjithatë, provat nga kërkimet tregojnë që në realitet, nxënësit marrin shumë pak vendime

---

45 Vlerësimi me përdorimin e qasjeve të EQD/EDNJ, sikur që janë: përfshirja e nxënësve në vlerësimin e tyre, vlerësimi formativ, vlerësimi për mësim, procesi përballë përmbajtjes, dhe vlerësimi pa nivele.

për të mësuarit e tyre, dhe rrallëherë përfshihen në projektet në të cilat ata dhe shokët e tyre të klasës përcaktojnë synime që janë me rëndësi për ta. Prandaj mësuesit nuk duhet të supozojnë që është lehtë të sigurohet një rol i pavarur vendimmarrës në edukimin e nxënësve: struktura e klasës, koha e limituar për aktivitete jo-instruktive, dhe vendimmarrja nga lartë-poshtë u kontribuojnë kushteve që e bëjnë të vështirë për mësuesit që të punojnë bashkë me mësuesit dhe me stafin tjetër.[46]

Për të nisur ndryshimet, mësuesit duhet fokusuar në fushat ku pjesëmarrja e nxënësve është më e drejtpërdrejtë:

. • rregullat dhe politikat e shkollës, politikat e sanksioneve dhe shpërblimeve (për shembull, anti-seksiste, anti-raciste, anti-ngacmuese, politikat e mundësive të barabarta, dhe kodet e veshjes dhe uniformat);
. • përmbajtja dhe struktura e programit mësimor, dhe metodat e mësimnxënies dhe mësimdhënies;
. • çështjet sociale: hapësirat sociale/aktivitetet jashtë shkollës, mirëpritja e nxënësve të rinj, organizimi i mbrëmjeve me prindër dhe mirëqenia e nxënësit.

Janë tri elemente të ndërlidhura të EDNJ në lidhje me njohurinë dhe të kuptuarit që u duhen mësuesve për përmbushjen e kësaj kompetence:

. • njohuria për strategjitë dhe aktivitetet e mësimdhënies që promovojnë vendimmarrjen dhe proceset e të menduarit;
. • të menduarit kritik dhe analiza [47]e mundësive ekzistuese mësimore për nxënësit;
. • njohuria dhe të kuptuari e synimeve të edukimit për qytetari – dhe veçmas – cila duhet të jetë natyra e "zërit të nxënësit" në lidhje me çështjet që i prekin ata.

Modelimi dhe demonstrimi i vlerave, parimeve dhe qëndrimeve të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut është mënyra më efektive "e padyshimtë" për ti mësuar ato. Mesazhi dhe mediumi duhet të jenë koherent, ku fundi dhe fillimi takohen me njëra tjetrën. Esenciale për këtë qasje të veçantë të koherencës janë disa parimet bazë:[48]

. • qytetaria aktive mësohet më së miri duke vepruar, jo duke mbajtur ligjërata – individëve duhet dhënë mundësinë e eksplorimit të çështjeve të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut, dhe jo tu thuhet si duhet të mendojnë apo të sillen;
. • edukimi për qytetari aktive nuk ka të bëjë vetëm me absorbimin e njohurive faktike, por me të kuptuarit praktik, me shkathtësitë dhe me vlerat e prirjet;
. • mjedisi mësimor është mesazhi – nxënësit mund të mësojnë vetëm po aq, nëse jo më tepër,

---

[46] Goodlad, J.,*Një vend i quajtur shkollë*, McGraw-Hill, Nju Jork, 1984. Mund të gjendet në Google books: http://books.google.com.

[47] Të menduarit kritik të mësuesve është i dobishëm në ato situata ku mësuesit duhet të marrin vendime në mënyrë të arsyeshme dhe reflektive; për shembull, çfarë të bëjnë, si, dhe ku ti përfshijnë nxënësit në proceset e vendimmarrjes. Analiza kritike e mësuesve është një formë e gjykimit, e fokusuar në mënyrë specifike në observimin e reagimit apo sugjerimeve të nxënësve, që merr parasysh provat dhe kredibilitetin e burimeve të ndryshme të informacionit sikur që është të menduarit e nxënësve, sjelljet, shqetësimet dhe emocionet. Mësuesit këtu kuptojnë kontekstin e aktiviteteve mësimore të tyre dhe janë në gjendje të angazhohen në procesin e vlerësimit të tërthortë të zhvillimit të planit mësimor, dhe të interesave e shqetësimeve të nxënësve.

[48] Huddleston, T., 2005, op. cit.

lidhur me qytetarinë demokratike përmes shembujve që u tregohen nga mësuesit dhe në mënyra në të cilat organizohet jeta në shkollë, sa edhe përmes metodave formale të mësimdhënies.

Në trajnim, modelimi i vë mësuesit në pozita të nxënësve. Ai u mundëson atyre të shohin dhe të përjetojnë EQD/EDNJ nga perspektiva e nxënësit. Aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies së EQD/EDNJ duhet të modelohen nga trajnuesi, për shembull, menaxhimi i diskutimeve, si të organizohet puna në projekt, dhe si të planifikohen mësimet dhe skemat e punës. Trajnuesit duhet të modelojnë gjithashtu llojin e vlerave demokratike dhe të prirjeve të cilat ata presin nga mësuesit ti demonstrojnë para nxënësve të tyre, sikur që është respekti dhe gatishmëria për zgjidhjen e konflikteve përmes argumentit dhe debatit.

Megjithatë për të qenë efektiv, modelimi duhet të pasohet nga një periudhë e reflektimit. Mësuesve u duhet kohë për të reflektuar për mënyrën e aplikimit në situatat e ardhshme të asaj që kanë mësuar gjatë trajnimit të tyre. Është me rëndësi që trajnuesi të dizajnojë aktivitete për të inkurajuar pjesëmarrësit që të reflektojnë për mësimin, për konceptet dhe vlerat, dhe për ti ndarë me moshatarët. Mësuesit dhe trajnuesit duhet të inkurajohen që të praktikojnë vetë-reflektimin. Ka kategori të ndryshme të reflektimit varësisht nga qëllimi apo objekti i reflektimit[49]. Tipari më i dallueshëm i procesit të reflektimit kritik është fokusi i tij në kërkimin për supozimet[50]. Prandaj, është e dobishme si për mësuesit fillestarë ashtu edhe ata me përvojë, që të nxjerrin në dritë supozimet e tyre të padyshimta.

Ka mënyra të ndryshme për nxjerrjen në dritë të supozimeve. Për shembull:

- mund të ndërgjegjësohemi më tepër për përvojat tona si nxënës apo mësues, duke shkruar ditarë personal të mësimdhënies. Ne shfrytëzojmë reflektimin autobiografik sepse është një pikënisje e mirë për ta parë veten më qartë si mësues, nxënës apo trajnues. Këto depërtime janë një ndikim të thellë dhe të gjatë;
- të parit e vetes sonë përmes syve të nxënësve mund të jetë befasues apo edhe çorientues, pasi që mund të zbulojmë që nxënësit nuk po i interpretojnë veprimet tona në mënyrën që e mendojmë ne. Shpesh, jemi thellësisht të befasuar nga diversiteti i kuptimeve me të cilat nxënësit lexojnë veprimet dhe fjalët tona;
- të parit e vetes sonë përmes syve të kolegëve tanë është një mënyrë tjetër për reflektim kritik. Për shembull, nëse i pyesim kolegët çfarë mendojnë se janë shkaqet tipike të rezistencës së nxënësve ndaj mësimit dhe si i kanë trajtuar ata këto shkaqe, mund të dëgjojmë përgjigje që sugjerojnë për lexime të reja të problemit;
- konfrontimi i qëndrimeve tona me literaturën teorike është një mënyrë tjetër e kërkimit për supozimet.

Modelimi duhet të planifikohet dhe implementohet me kujdes. Pasi që modelimi është një metodë "implicite" e mësimdhënies, duhet të mbrohet nga indoktrinimi. Për këtë arsye, është me rëndësi të promovohet liria e shprehjes së nxënësve, reflektimi për besimet dhe pritjet, të menduarit kritik,

---

[49] Zeichner, K., "Praktikuesi reflektues", në Reason, P. dhe Bradbury, H. (eds), *Doracak për kërkimet rreth veprimit: pyetje dhe praktikë me pjesëmarrje*, Sage, Londër, 2001. Reflektimi kritik do të thotë që mësuesit apo trajnuesit stimulohen që të reflektojnë për aspektet etike, sociale dhe politike të praktikës së tyre. Aktiviteti meta-njohës bën angazhimin e nxënësve për të reflektuar mbi besimet dhe vlerat e tyre.

[50] Cf. Brookfield, S.D., *Të bërit mësues me reflektim kritik*, Jossey-Bass Publishers, San Francisco, 1995. Supozimet janë besime që merren si të mirëqena lidhur me botën dhe vendin tonë në të. Ato duken të padyshimta dhe zakonisht janë të patundura. Praktikuesit shpesh ndërmarrin veprimet e tyre në bazë të supozimeve që nuk janë ekzaminuar.

vendimmarrja dhe pjesëmarrja e lirë aktive në çështjet e qytetarisë. Kjo nënkupton njohuritë dhe të kuptuarit e teorisë njohëse sociale dhe të implikimeve edukative për modelimin e praktikave në të mësuarit nga nxënësit të kompetencave të qytetarisë.

Shqyrtimi, monitorimi dhe vlerësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies u ofron mësuesve mundësinë për përmirësim të vazhdueshëm të proceseve të mësimdhënies/mësimnxënies. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë mënyra për shfrytëzimin e tërë prapaveprimit nga nxënësit dhe nga burimet tjera (për shembull, kolegët, këshilltarët dhe mbikëqyrësit e arsimit të lartë) për të përmirësuar performansën e tyre. katër pyetje tipike dhe të thjeshta mund të konsiderohen[51]:[51]

. • Çfarë po përpiqem të bëj?
. • Si po e bëj atë?
. • Si mund ta di që po e bëj mirë?
. • Çfarë mund të bëj për ta përmirësuar?

(Shih veglat e vetë-vlerësimit dhe listën kontrolluese të EQD/EDNJ për vlerësimin, në shtojcë.)

---

[51] AUE (Asociacioni i Universiteteve Evropiane) udhëzime për vetë-vlerësimin, shih : www.eua.be.

## 7.2. Kompetenca nr. 13

**Kompetenca nr. 13: vlerësimi i përfshirjes së nxënësve në vendimmarrje**
Vlerësimi i masës në të cilën nxënësit kanë mundësi të shprehen për gjërat që kanë ndikim në ta dhe sigurimi i mundësive për pjesëmarrje të nxënësve në vendimmarrje.

### 7.2.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ demonstrojnë që:

. ➜Ofrojnë dhe matin ndikimin e nxënësve në çështjet që janë parësore për mësimin e tyre dhe për jetën e tyre të përditshme në shkollë, për shembull në metodat e mësimdhënies, politikat e shkollës apo në planifikimin e programit mësimor. Ata i besojnë aftësisë së nxënësve për të marrë përgjegjësi për mësimnxënien e tyre;

. ➜I inkurajojnë nxënësit që të përfshihen në procesin e mësimdhënies. Mësuesit dhe nxënësit bëjnë planifikimin e përbashkët të aktiviteteve rreth qytetarisë. Procedurat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë sistematike nga nxënësit. Nxënësit gjithashtu vlerësojnë punën e vet;

. ➜u ndihmojnë nxënësve për të analizuar mësimin e tyre duke organizuar procese të vlerësimit, ashtu që metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të hapura për vlerësim nga nxënësit. Si rrjedhim, ky vlerësim do tu ndihmojë mësuesve në përmirësimin e praktikës së tyre;

. ➜janë të angazhuar në rend të parë në pajisjen e nxënësve me shkathtësi për ushtrimin e qytetarisë efektive, duke u ofruar mundësi për eksplorim, dhe synojnë të përcaktojnë një kuadër të qartë brenda të cilit nxënësit mund të mendojnë lirshëm;

. ➜e dinë si tu ndihmojnë nxënësve në definimin e situatave dhe çështjeve, në bazë të përvojave të nxënësve për qytetarinë që përfshijnë dyshimin, pasigurinë apo vështirësinë, ku duhet të vendosin çfarë të bëjnë apo çfarë të besojnë. Ata konfrontojnë ndjenjën personale të nxënësit për të drejtën dhe të gabuarën, dhe vargun e vlerave personale me këndvështrimet tjera. Përmes këtij procesi, ata janë në gjendje të vlerësojnë në çfarë niveli të mirë kanë ofruar mundësi për të menduarit kritik tek nxënësit;

. ➜i përfshijnë nxënësit në çështjet e jetës reale, që kanë të bëjnë me komunitetin shkollor dhe u ndihmojnë në identifikimin dhe përzgjedhjen e strategjive për zgjidhjen e problemeve, bashkëpunojnë me të tjerët në zgjidhjen e problemeve dhe për të qenë të hapur ndaj zgjidhjeve të ndryshme dhe provave që mund të jenë në kundërshtim me këndvështrimet e preferuara. Më pas, mësuesit mund të vlerësojnë pjesëmarrjen e tyre duke zhvilluar bashkë me nxënësit, një shqyrtim para/pas të situatës problematike;

. ➜u ndihmojnë nxënësve të diskutojnë në situatat që përfshijnë një lloj dykuptimësie dhe kompleksiteti. Për shembull, në një konflikt në shkollë apo dilemë, mësuesit mund tu ndihmojnë nxënësve që të vendosin në mënyrë kritike dhe etike për një zgjidhje duke përdorur pyetjet si: Çfarë do të bënit nëse …? Çfarë mendoni …? Cilat janë qëndrimet e njerëzve të tjerë? Cilat janë ndjenjat e tyre dhe vlerat? Ata mbajnë regjistrime (tekste, video) të përgjigjeve të nxënësve, për të observuar ndryshimet në shkathtësitë e tyre në EQD/EDNJ.

## 7.2.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 13: vlerësimi i përfshirjes së nxënësve në vendimmarrje** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Ju i frikësoheni, apo mbase e kundërshtoni përfshirjen e nxënësve në vendimmarrje.* | **Provoni këtë:**<br>• mësoni më tepër për çështjen. Gjeni informata lidhur me teorinë e vendimmarrjes dhe kërkimet, dhe lexoni disa shembuj të hapave për të promovuar një proces më gjithëpërfshirës të vendimmarrjes,për shembull: si funksionojnë këshillat e nxënësve gjetiu?<br>• reflektoni për përvojat tuaja të mëhershme në lidhje me situatat me alternativa komplekse të vendimmarrjes.<br>Mendoni për, dhe fokusohuni në vlerat që janë me rëndësi për ju. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Ju nuk kundërshtoni pjesëmarrjen e nxënësve por i frikësoheni humbjes së kontrollit të situatës. Ndjeni që ju duhen më shumë informata lidhur me shembujt konkret të mësuesve që promovojnë proceset e vendimmarrjes.* | **Provoni këtë:**<br>• gjeni një shkollë apo klasë ku bëhet kjo dhe observoni dhe dëgjoni shembujt konkret;<br>Identifikon dhe shikoni videoregjistrimet mbi aktivitetet mësimdhënëse në klasë;<br>• observoni dhe regjistroni llojin e pyetjeve që mësuesit i përdorin për të mbështetur proceset e vendimmarrjes së nxënësve.<br>Pyetjet sokratike janë shembuj të mirë të mbështetjes së të menduarit kritik të nxënësve dhe të vendimmarrjes së tyre;<br>• loboni për mundësi trajnuese mbi mësimin bashkëpunues dhe punën në grup. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Ju kuptoni rëndësinë e përfshirjes së nxënësve në vendimmarrje. Keni nisur të prezantoni aktivitetet e nxënësve për të promovuar vendimmarrjen. Përdorni metoda të ndryshme të konsultimit me fëmijët. Por kjo merr kohë dhe nganjëherë i ktheheni metodave tradicionale lartë-poshtë.* | **Provoni këtë:**<br>• pyesni nxënësit apo kolegët dhe regjistroni në video aktivitetet e mësimdhënies;<br>• kërkoni nga ata të observojnë dhe të bëjnë komente. Mund të përgatisni një rrjetë për komentet nëse dëshironi;<br>• vështroni videoregjistrimin dhe bëni vetë-observimin tuaj;<br>• krahasoni rezultatet e observimeve të nxënësve apo kolegëve tuaj; reflektoni për dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet observimit tuaj dhe observimeve të nxënësve apo kolegëve;<br>• hartoni strategji për përmirësimin e metodave tuaja: që marrin më pak kohë, që i bëjnë detyrat më të qarta dhe më të shkurtra, regjistroni vendimet për referencë në të ardhmen, themeloni rutinat, etj.;<br>• shtoni repertorin tuaj dhe të shkollës, të strategjive për konsultim me nxënësit. Për shembull: këshillat e klasës dhe të shkollës, diskutimet në grup, takimet punuese të nxënësve, grupet e planifikimit, pyetësorët/anketat dhe kutitë e sugjerimeve. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Ju njihni përgjegjësitë tuaja si mësues për fuqizimin e nxënësve me një proces të hapur dhe të përgjegjshëm të vendimmarrjes, dhe u jipni nxënësve mundësinë e fjalës. Ju ndjeni që ka nevojë për një reflektim më etik mbi zgjedhjet dhe për më tepër mundësi për reflektim meta-njohës.* | **Provoni këtë:**<br>• shikoni pandërprerë për mungesën e koherencës ndërmjet përgjegjësisë suaj si mësuese dhe veprimeve tuaja, për ti fuqizuar nxënësit dhe për të dhënë liri dhe zë për nxënësit tuaj;<br>• a mund të zgjeroni masën e përfshirjes së nxënësve?<br>• hartoni një plan të veprimit për të siguruat që konsultimet me nxënës do të përfshihen në planin tuaj të përmirësimit apo zhvillimit të shkollës;<br>• caktoni një regjim kohor të zakonshëm në mësimdhënien tuaj për qëllime të reflektimit, dhe hartoni strategji për zhvillim autonom të vetë-reflektimit tek nxënësit. |

## 7.3. Kompetenca nr. 14

**Kompetenca nr, 14: modelimi i vlerave, qëndrimeve dhe prirjeve të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut**

Demonstrimi i vlerave, qëndrimeve dhe prirjeve pozitive të EQD/EDNJ që priten nga të rinjtë – për shembull, modelimi i një pozicioni aktiv qytetar; raportet e drejta, të hapura dhe të respektueshme me nxënësit; përdorimi stilit demokratik të mësimdhënies; dhe përfshirja e nxënësve në planifikimin dhe pronësinë mbi aktivitetet edukative

### 7.3.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD mund të demonstrojnë që:

. ➜reflektojnë mbi arsyet e mësimdhënies së tyre, dhe pse mbajnë mësim në mënyrën e caktuar. Ata synojnë të bazojnë praktikën e tyre në vlerat demokratike thelbësore, sikur që janë drejtësia, paanësia dhe dhembshuria. Nga këto vlera ata nxjerrin udhërrëfyesit për mënyrën e lidhjes me nxënësit dhe si të bëjnë organizimin e klasës. Ata bëjnë përpjekje për të krijuar kushtet në të cilat të gjithë zërat (përfshirë këtu zërin e tyre) mund të flasin dhe të jenë të dëgjuar, dhe në të cilat proceset edukative shihen si negociata të vërteta.

. ➜janë të vetë-ndërgjegjshëm për llojin e gjuhës që përdorin në klasë, janë të hapur dhe transparent në artikulimin e proceseve mësimore me nxënësit, dhe janë të përgatitur të modelojnë proceset mentale të tyre me nxënësit. Këto procese mund të përfshijnë reflektimin kritik, vlerësimin dhe ndarjen e përvojave dhe të njohurive me të tjerët;

. ➜injurajojnë nxënësit që të reflektojnë për përvojat e tyre dhe proceset mësimore; kjo përfshin zgjedhjen e temave që u interesojnë atyre;

. ➜modelojnë komunikimin demokratik. Mësuesit u ofrojnë mundësi nxënësve për të shprehur lirshëm opinionet e tyre për çështjet politike, sociale e kundërthënëse. Ata i stimulojnë nxënësit që ti prezantojnë ato çështje në klasë. Ata janë të hapur ndaj opinioneve të nxënësve që janë në kundërshtim me opinionin e tyre. Ata i inkurajojnë nxënësit që ti shprehin opinionet që dallojnë nga ato të shumicës së moshatarëve të tyre dhe nga ato të tyret. Ata prezantojnë pikëpamje të ndryshme apo perspektiva të ndryshme për një çështje. Ata i i inkurajojnë nxënësit që të diskutojnë çështjet politike apo sociale lidhur me të cilat njerëzit kanë opinione të ndryshme. Mësuesit modelojnë mospajtimin me respekt për tjetrin dhe kritikat konstruktive. Ata krijojnë rregulla për diskursin demokratik që eksploron sfidon supozimet për "tjetrin" që në mënyrë të pashmangshme importohen në klasë nga shoqëria e gjerë;

. ➜ata janë të ndërgjegjshëm dhe vigjilent për praninë e fuqisë në klasën e tyre, potencialin e saj për keqpërdorim dhe efektet e tij në nxënësit. Ata janë të vetëdijshëm dhe e dinë që veprimet e tyre mund ti pushojnë apo ti aktivizojnë zërat e nxënësve. Ata dëgjojnë seriozisht dhe me vëmendje atë që thonë nxënësit. Ata qëllimisht krijojnë momente reflektimi atëherë kur shqetësimet e nxënësve dhe jo agjenda e mësuesit.– janë në fokus të aktivitetit në klasë. Ata bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të mësuar çfarë ndjejnë nxënësit lidhur me çështjet e shqetësimit të përbashkët dhe këtë informacion e bëjnë publik. Ata i inkurajojnë nxënësit që reflektojnë për veprimet dhe sjelljet e tyre dhe synojnë të bëjnë përshtatjen e punës së tyre si reagim ndaj shqetësimeve të nxënësve. Ata u besojnë nxënësve dhe inkorporojnë mësimin me moshatarët në repertorin e mësimdhënies së tyre;

. ➜dinë si të perceptojnë stilet e ndryshme të të mësuarit tek nxënësit dhe mënyrat e të menduarit. Ata bëjnë dizajnimin e klasave që grishin zhytjen në mendime dhe përdorin strategji fleksibile për të fuqizuar të menduarit tek nxënësit, sikur që janë pyetjet, eksperimentimi, kërkimi i kuptimit, kreativiteti, refleksioni meta-njohës dhe sfidimi i paragjykimeve.

## 7.3.2. Grafiku i progresit

### Kompetenca nr. 14: modelimi i vlerave, qëndrimeve dhe prirjeve të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut

| | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Ndjeheni më komod kur "ju jeni përgjegjës". Nuk jeni të vetëdijshëm për pushtetin dhe ndikimin që keni mbi të tjerët kur flisni apo prezantoni një temë.* | **Provoni këtë:**<br>• hulumtoni dhe lexoni më tepër për këtë metodë;<br>• reflektoni për përvojat tuaja të mëhershme lidhur me shkathtësitë e komunikimit për të cilat mendoni se kanë ndikuar në mësimin apo sjelljen e të tjerëve. Mendoni si dhe pse keni pasur fuqinë të ndikoni mbi të tjerët. A ka pasur njerëz që nuk janë ndikuar nga shkathtësitë tuaja të komunikimit? Pse jo?<br>• planifikoni një mësim apo aktivitet me shfrytëzimin e modelimit. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Ndjeni që ju nevojiten më shumë informata për shembujt konkret të praktikave të modelimit tek mësuesit dhe që të qartësoni atë që mësohet përmes modelimit. Ndjeheni të brengosur dhe të merakosur lidhur me efektet e të njohjes më të madhe të pushtetit dhe ndikimit tuaj mbi të mësuarit e të tjerëve.* | **Provoni këtë:**<br>• observoni praktikat e të tjerëve në modelim;<br>• gjeni disa video regjistrime të debateve në klasë lidhur me temat e qytetarisë;<br>• reflektoni dhe krahasoni situatën që keni observuar me vlerësimin tuaj të mënyrave në të cilat ju komunikoni dhe ndikimet tuaja mbi të tjerët |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Keni nisur të prezantoni temat e EQD/EDNJ. Për shembull, çështja e demokracisë në shkollë dhe pesha që u jepet "zërave të nxënësve". Ndjeheni të brengosur për shkak se ka shumë mënyra dhe çështje që duhet shqyrtuar, dhe shumë aktorë që duhen përfshirë. Keni frikë që sapo keni hapur kutinë e Pandorës dhe nuk do të jeni në gjendje të kontrolloni pasojat.* | **Provoni këtë:**<br>• modeloni me kolegët tuaj fillimisht në temën e njëjtë dhe përdorni vlerësimin e këtij sesioni për të përmirësuar dhe për të përgatitur më mirë modelimin tuaj në klasë;<br>• kërkoni nga nxënësit apo kolegët që të regjistrojnë në video mësimdhënien tuaj;<br>• shikoni videoregjistrimin dhe bëni vetë-observimin tuaj; kërkoni nga kolegët apo nga nxënësit që të veprojnë njësoj;<br>• krahasoni të dyja observimet dhe reflektoni për dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet observimit tuaj dhe observimit të nxënësve apo të kolegëve. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Ju njihni përgjegjësinë tuaj si mësues për ti fuqizuar nxënësit tuaj me kompetencat e qytetarisë në mjedisin demokratik, duke respektuar vullnetin e lirë të tyre. Keni besim që parimet e EQD/EDNJ përhapin qëndrimin tuaj në klasë. Ndjeni që ka nevojë për një reflektim më etik.* | **Provoni këtë:**<br>• shikoni pandërprerë për mungesën e koherencës ndërmjet përgjegjësisë suaj si mësues dhe veprimeve tuaja për fuqizimin e nxënësve dhe për tu dhënë atyre liri dhe zë;<br>• pas një sesioni, organizoni prapaveprimet e nxënësve lidhur me atë që sapo kanë përjetuar. Përdoreni këtë prapaveprim për tu mbajtur vigjilent lidhur me metodën tuaj të modelimit;<br>• ftoni kolegët që të observojnë klasën tuaj dhe ofroni përkrahje nëse ata duan të zhvillojnë vet shkathtësitë që i keni demonstruar ju. |

## 7.4. Kompetenca nr. 15

**Kompetenca nr. 15: shqyrtimi, monitorimi dhe vlerësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimit të nxënësve**

Mundësia dhe gatishmëria për të shqyrtuar, monitoruar dhe vlerësuar metodat e mësimdhënies dhe mësimin e nxënësve dhe përdorimi i këtij vlerësimi për të bazuar planifikimin e ardhshëm dhe zhvillimin profesional në mësimdhënien e EQD/EDNJ.

### 7.4.1. Përshkrim dhe shembuj: "mësuesit që përmbushin këtë kompetencë do të demonstrojnë …"

Mësuesit që përmbushin këtë kompetencë të EQD/EDNJ demonstrojnë që:

. Janë të vetëdijshëm që të vlerësohet mësimi i nxënësve përmes qytetarisë aktive nënkupton që qenit të informuar për proceset, përvojat dhe praktikat e projekteve efektive të qytetarisë aktive dhe analizimin kritik të konteksteve/aktiviteteve të EQD/EDNJ, dhe të proceseve mësimore dhe të rezultateve;

. Ata e shohin veten si qytetarë dhe si mësues të qytetarisë përmes syve të nxënësve të tyre që i vlerësojnë ata në bazë të qëndrimeve, strategjive dhe aktiviteteve të përdorura;

. Ata bëjnë vetë-shqyrtimin e aspekteve të ndryshme të mësimdhënies së EQD dhe përdorimin e instrumenteve të ndryshme;

. Ata reflektojnë mbi pedagogjinë dhe procesin teknik të mësimit dhe mësimdhënies që e përdorin në praktikën e tyre. Për shembull, ata reflektojnë mbi përdorimin e llojeve të ndryshme të pyetjeve që mund të pengojnë apo të lejojnë të shprehurit e lirë të nxënësve;

. Ata janë në gjendje të reflektojnë për sistemet e vlerave etike, sociale dhe politike, dhe për sistemet e vlerave që merren si mirëqena, në të cilat janë të bazuara qëndrimet e tyre ndaj EQD;

. Ata dinë mënyra të ndryshme për zhvillimin e vetë-reflektimit dhe të vetë-vlerësimit. Ata përdorin ditarë personal të mësimdhënies si pikënisje për ta parë veten më qartë si mësues dhe si nxënës;

. Ata bëjnë konfrontimin e përvojave të tyre të mësimdhënies me përvojat e kolegëve të tyre që mund të kenë pasqyrime të imazheve të veprimeve dhe qëndrimeve të atyre vet. Për shembull, ata mund ti pyesin kolegët cilat sipas mendimit të tyre janë shkaqet tipike të rezistencës së nxënësve ndaj ndryshimit të qëndrimeve të tyre, dhe zhvillojnë aktivitete dhe strategji që promovojnë angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive;

. Ata krahasojnë dhe ballafaqojnë veprimet/praktikat e tyre, dhe qëndrimet, me literaturën teorike për mësimdhënien dhe mësimin e EQD. Për shembull, ata mund ta interpretojnë ngacmimin nga nxënësit/mungesën e disiplinës si një gjë të shkaktuar nga vet personaliteti i tyre. Literatura për nxënësit minoritarë mund të shpjegojë mungesën e disiplinës si një kontradiktë edukative dhe politike në bazë të idesë që edukimi mund të kapërcejë shtypjen dhe realitetin.

## 7.4.2. Grafiku i progresit

| **Kompetenca nr. 15: shqyrtimi, monitorimi dhe vlerësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimit të nxënësve** | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Ju ndjeni që bartja e njohurive për EQD/EDNJ tek nxënësit është e mjaftueshme për të treguar që jeni të përkushtuar ndaj lëndës dhe nuk ka nevojë të ndryshoni metodologjitë tuaja pasi ju po bëni më të mirën. Ju vërtetë nuk bëni vlerësimin e vetes suaj në lidhje me EQD/EDNJ, dhe mund të mos jeni të motivuar apo mund të mos keni resurset për të vetë-vlerësuar praktikën tuaj.* | **Provoni këtë:**<br>• përdorni rezultatet e vlerësimit të nxënësve tuaj, nga ana juaj, për ti diskutuar me ta idetë e gabuara më të shpeshta që janë nxjerr në pah nga ky vlerësim. Përpiquni të kuptoni shkakun në praktikën tuaj për këtë keqinterpretime;<br>• shqyrtoni rezultatet e mësimit tuaj;<br>• kuptoni efektin e metodologjive tuaja në perceptimin e tyre të EQD/EDNJ duke biseduar me ta për disa nga çështjet të cilat ju mendoni se ata është dashur ti kenë përvetësuar;<br>• flisni me kolegët tuaj për të ditur rreth praktikave të tyre, me fokus special në synimet dhe metodat. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Shkolla nuk ka një politikë për vlerësimin e aspektit të EQD/EDNJ në mësimdhënie. Ju u shpërndani nxënësve tuaj kohë pas kohe pyetësorë të caktuar lidhur me efikasitetin e mësimdhënies suaj vetëm sa për të dituar si jeni duke vepruar. Ju i diskutoni me kolegët tuaj rezultatet e atyre pyetësorëve. Prapëseprapë, ju rrallëherë merrni parasysh prapaveprimet për ndryshimin e metodologjive tuaja.* | **Provoni këtë**<br>• shpërndani pyetësorët tek nxënësit tuaj. Përpiloni pyetësorët në atë mënyrë që do të keni perceptimin e efekteve të metodologjive tuaja në sjelljet e nxënësve tuaj;<br>• diskutoni rezultatet e pyetësorëve me nxënësit tuaj;<br>• përfshini shkollën në procesin e vetë-vlerësimit dhe nxisni interesin e kolegëve tuaj në monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e përvojave të nxënësve në EQD/EDNJ;<br>• merrni parasysh observimet e nxënësve dhe të kolegëve tuaj. Përpiquni të ndryshoni metodologjitë në përputhje me këtë prapaveprim. Përpiquni ti përdorni ato për bërjen e përmirësimeve. |
| **Hapi 3 3 (i përforcuar)**<br>*Shkolla ka një projekt për përmirësimin e cilësisë së edukimit në lidhje me EQD/EDNJ, ndonëse ky nuk është ende i qartë. Ka një të kuptuar të gjerë që shkolla po përpiqet të përmirësojë proceset e mësimdhënies/mësimnxënies së EQD/EDNJ. Jeni të gatshëm të bashkëpunoni. Megjithatë, nuk dini si ti përkrahni këto politika.* | **Provoni këtë:**<br>• shpërndani pyetësorët tek nxënësit dhe zhvilloni diskutimin të fokusuar në metodologjitë tuaja dhe në ndikimin e tyre në sjelljet e nxënësve tuaj;<br>• inkorporoni në aktivitetet tuaja të mësimdhënies dhe të mësimnxënies çështjet e ngritura nga nxënësit;<br>• përfshini shkollën në procesin e promovimit të ndërgjegjësimit për EQD/EDNJ të zhvilluar nga nxënësit. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Shkolla ka një projekt të qartë për përmirësimin e cilësisë së edukimit lidhur me EQD/EDNJ. Nxënësit dhe grupet e interesit dëgjohen dhe përfshihen në proceset. Rezultatet e pyetësorëve të nxënësve merren për bazë në përmirësimin e procesit të mësimdhënies/mësimnxënies. Metodologjitë dhe rezultatet mësimore shqyrtohen rregullisht. Nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive në projekt dhe ndihmojnë në identifikimin e çështjeve që kanë nevojë për përmirësime* | **Provoni këtë:**<br>• përdorni tërë prapaveprimin e mundur për të monitoruar pandërprerë performansën tuaj, duke krijuar kështu mundësinë për përmirësim të vazhdueshëm;<br>• shtoni ndërgjegjësimin e nxënësve për qëllimet tuaja, shfrytëzoni përkushtimin e tyre për tu ndihmuar në arritjen e qëllimeve;<br>• vlerësoni masën në të cilën nxënësit shfrytëzojnë atë që e kanë mësuar me ju, në jetët e tyre të përditshme.<br>Diskutoni gjetjet tuaja me ta dhe përpiquni të nxirrni mësime të përbashkëta për të ardhmen;<br>• shikoni për praktika të mira gjetiu që të mund të standardizoni aktivitetin tuaj me rastet e ngjashme.<br>• ftoni mësuesit tjerë në klasën tuaj për "të përhapur" praktikën tuaj të mirë. |

# 8. Resurset për grupet tjera të interesit

Ndonëse kompetencat e përmendura këtu u adresohen në rend të parë mësuesve dhe edukatorëve të mësuesve, rëndësia, gjerësia dhe universaliteti i EQD/EDNJ përfshin gjithashtu në mënyrë të qartë disa grupe të tjera të rëndësishme të interesit – përfshirë këtu krijuesit e politikave, drejtuesit e shkollave dhe institucionet e arsimit të lartë.

## 8.1. Krijuesit e politikave

Për të qenë i suksesshëm, EQD/EDNJ ka nevojë për njohje dhe përkrahje nga krijuesit e ndryshëm të politikave – anëtarët e parlamentit, zyrtarët qeveritarë, administrata lokale, këshilltarët, etj. – që formulojnë parimet dhe dizajnojnë kushtet për EQD/EDNJ. Është më se i dobishëm nëse:

. • rëndësia e EQD/EDNJ shprehet në dokumentet legjislative;
. • udhërrëfyesit praktik inkorporohen në aktet tjera normative;
. • ky aspekt përkrahet dhe garantohet nga alokimet e nevojshme buxhetore për implementimin e ndryshimeve në programe mësimore dhe për ndryshimet më të gjera.

Vargu i publikimeve të Këshillit të Evropës për EQD/EDNJ – përfshirë këtu këtë doracak – synon tu ofrojë krijuesve të politikave një të kuptuar të qartë të esencës dhe domosdoshmërisë së EQD/EDNJ në lidhje me promovimin e përfshirjes sociale. Synon të nënvizojë:

. • rëndësinë e EQD/EDNJ në edukimin e të rinjve;
. • EQD/EDNJ synon të zhvillojë qasje të reja dhe angazhuese ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies.

## 8.2. Drejtorët dhe udhëheqësit e shkollave

Qasjet e EQD/EDNJ janë zhvilluar në mënyrën më të suksesshme kur janë përkrahur nga përkushtimi dhe angazhimi aktiv i liderëve të lartë të shkollave. Të gjitha provat dhe kërkimet tregojnë që kjo përkrahje është jetike.

Të gjithë mësuesit që punojnë në shkolla, në një mënyrë apo një tjetër, marrin pjesë në krijimin e kulturës së shkollës. Sa më tepër që kultura përmbushë qëllimet dhe synimet e demokracisë, aq më mirë. Drejtorët dhe liderët e shkollave do të mund të konsideronin implikimet në lidhje me trajnimet për kompetencat e përmendura këtu dhe përfitimet e përfshirjes së caqeve për zhvillimet në fushën e EQD/EDNJ brenda planeve vepruese vjetore për përmirësimet në shkolla. “Auditimi ” në nivel të shkollës i gjendjes së EQD/EDNJ dhe identifikimi i hapave pasues mund të jetë një pikënisje e mirë në implementimin e planit të veprimit.

Është gjithashtu shumë e rekomanduar që EQD/EDNJ të bëhet një komponentë më esenciale të trajnimit të mësuesve në shërbim dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm. Shpresohet që kompetencat dhe ilustrimet përcjellëse me shembuj, ofrojnë ide praktike për të gjithë edukatorët e mësuesve.[52] Seminaret e tyre apo ngjarjet trajnuese do të synojnë pajisjen e mësuesve pjesëmarrës me njohuri, shkathtësi, qëndrime, vlera dhe prirje për zhvillimin e qasjeve efektive ndaj EQD/EDNJ në praktikat e tyre. Janë disa forma të dallueshme të mësimit në të cilat të gjithë mësuesit duhet të jenë të rrjedhshëm dhe me vetëbesim, përfshirë këtu diskutimet, luajtjen e roleve, simulimet dhe punën

[52] Përfshirë organizatat joqeveritare dhe trajnuesit.

bashkëvepruese/bashkëpunuese në projekte, që mund të përdoren që të gjitha në mënyrë efektive në mësimdhënien e të gjitha lëndëve, përfshirë këtu EQD/EDNJ. Mësuesit duhet gjithashtu të zhvillojnë shkathtësitë e dizajnimit të aktiviteteve përreth situatave reale në komunitet apo në mjedisin më të gjerë, për të zhvilluar strategji për adresimin e çështjeve të ndjeshme dhe kundërthënëse.

"Grafiku i progresit" në vijim është një tërësi e sugjerimeve për mënyrat në të cilat drejtorët dhe drejtuesit tjerë të shkollave mund të identifikojnë fazën në të cilën "janë", në lidhje me të kuptuarit e tyre të – dhe angazhimin në– çështjet që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ, dhe më pas të fillojnë me implementimin e disa ndryshimeve në qasjet ekzistuese.

| | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Shkolla (dhe pjesa më e madhe e mësuesve individual) janë në një fazë të hershme të zhvillimit të EQD/EDNJ. Ata mund të kenë të paqartë natyrën dhe qëllimet e EQD/EDNJ. Ofrimi i planit mësimor për EQD/EDNJ nuk është i planifikuar në ndonjë mënyrë koherente apo specifike. Shkollat dhe/apo mësuesit mund të besojnë që është i mjaftueshëm ekzistimi i një etosi që promovon EQD/EDNJ në kuptimin më të gjerë.* | **Provoni këtë:**<br>• trajnimi dhe vetëdijesimi për ndryshimet pozitive që EQD/EDNJ mund të sjellë në shkolla (përmirësimi i metodave të mësimdhënies e të mësimnxënies, krijimi i një shkolle gjithëpërfshirëse, edukimi i qytetarëve aktiv demokratik të së nesërmes) është me rëndësi kyçe këtu. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*Shkollat dhe/apo mësuesit individual do ta shpijnë EQD/EDNJ përpara. Mësuesit kanë nisur të kuptojnë potencialin e EQD/EDNJ për angazhimin e të rinjve dhe për përmirësimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre. Stafi ka nisur të identifikojë programin themelor.*<br>*Ekspertiza më e gjerë e stafit po zhvillohet përmes trajnimin dhe përkrahjes. Çështjet mund të përfshijnë:*<br>*• besimin e tepruar në resurset e publikuara;*<br>*• mungesën e njohurive për temat specifike të EQD/EDNJ;*<br>*• mungesën e besimit në shkathtësitë e mësimdhënies së EQD/EDNJ në mënyra aktive dhe të hapura.* | **Provoni këtë:**<br>• në këtë fazë, ruajtja e momentumit është thelbësore. Inkurajoni stafin që të vazhdojnë përpjekjet e tyre dhe siguroni trajnim për EQD/EDNJ për tërë stafin;<br>• u ndihmoni mësuesve të identifikojnë dhe të punojnë me partnerët lokal në krijimin e themeleve të bashkëpunimit për projektet e qytetarisë aktive me përfshirjen e nxënësve. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*Shkollat në këtë fazë do të kenë në vend struktura efektive të lidershipit për EQD/EDNJ. Një program koherent i EQD/EDNJ është duke u zhvilluar në dhe përtej klasave të mësuesve individual. Mësuesit kanë nisur të krijojnë lidhjet efektive me komunitetin. Ka një vetëbesim relativ rreth njohurisë për temat dhe bëhet identifikimi i mëtejmë i nevojave për trajnim në një shkallë të gjerë të qasjeve aktive ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shqetësimet në këtë fazë kanë të bëjnë me menaxhimin e ndryshimit dhe me frikën nga pasojat e pamenduara të novacionit.* | **Provoni këtë:**<br>Caqet kyçe për mësuesit individual mund të përfshijnë:<br>• krijimin e lidhjeve me prindërit, agjencitë lokale dhe me anëtarët tjerë të komunitetit;<br>• përdorimin e TIK për përmirësim të mësimdhënies dhe mësimnxënies;<br>• zhvillimin e thellësisë dhe cilësisë së shkathtësive, njohurive dhe të pjesëmarrjes së nxënësve në EQD/EDNJ;<br>• Kremtimin e suksesit!! |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*Shkolla në këtë fazë ka marrë masa efektive për EQD/EDNJ dhe mësuesit individual do të kenë zhvilluar disa qasje të sofistikuara dhe efektive të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ekipet e mësuesve ndajnë një vizion dhe mirëkuptim të përbashkët, por do të jenë fleksibil në mënyrën e ndryshimit të tij, për të plotësuar nevojat e nxënësve. Shkollat kanë krijuar lidhje efektive me komunitetin.*<br>*Të arriturat e nxënësve njihen dhe pranohen. Mësuesit kanë pritje të larta lidhur me atë që mund të arrihet nga nxënësit, duke u bazuar në arritjet e mëhershme të tyre. Teknologjitë e reja do të jenë faktor kyç në efikasitetin e mësuesve në klasë. Mësuesit do të kenë mjaft vetëbesim për tu dhënë fjalën nxënësve në përcaktimin e agjendës dhe në provimin e ideve të reja. Objektivat në këtë fazë kanë të bëjnë me novacionin dhe me strategjitë e reja për mbajtjen e momentumit dhe të përkushtimit për zhvillimin e shkathtësive profesionale të tyre.*<br>*Çështjet kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe rifokusimin.* | **Provoni këtë:**<br>Caqet mund të përfshijnë:<br>• ndarjen e praktikës së mirë me kolegët dhe me shkollat tjera;<br>• zhvillimin e mëtejmë të qasjeve novatore për inkurajim të përfshirjes autentike në qytetarinë aktive dhe të mësuarit e pavarur;<br>• mbështetjen dhe zhvillimin e mëtejmë të proceseve të vlerësimit me pjesëmarrje, me përfshirjen e nxënësve dhe të partnerëve të shkollës në proces;<br>• kremtimin e suksesit. |

**Tabela 8: Grafiku i progresit për drejtorët dhe drejtuesit e shkollave**

## 8.3. Në arsimin e lartë

Është e drejtë të thuhet që përgjithësisht, ka pasur një mungesë të ndërgjegjësimit në edukimin evropian të mësuesve për EQD/EDNJ si një kërkesë themelore e përgatitjes profesionale. Aktualisht, ka koncepte dhe të kuptuar të ndryshëm të synimeve të edukimit dhe të rolit profesional të mësuesit, që ndikojnë në implementimin e kurseve të EQD/EDNJ. Përgjithësisht, diskursi edukativ dominohet nga dy koncepte konkurruese të rolit të mësuesit:

- koncepti i parë karakterizohet nga mbizotërimi i përkrahjes për zhvillimin njohës të fëmijëve në fusha e definuara të dijes. Në kuadër të këtij koncepti, mësuesit definohet si specialist që përcjell informatat dhe njohuritë për lëndën specifike, dhe ndjehet më pak përgjegjës për edukimin shoqëror dhe demokratik;
- koncepti teorik i dytë lidhet më tepër me të kuptuarit më të gjerë të procesit edukativ dhe të rëndësisë së procesit të socializimit që ngjan në mjedisin e shkollës. Ky është më i zakonshëm në fazën fillore të edukimit. Ata mësues që identifikohen me konceptin e dytë, kanë tendencë të vënë në plan të parë rolin pastoral të tyre dhe e shohin veten e tyre më tepër si edukatorë social. Fokusi i tyre është i lidhur më tepër me përkrahjen e zhvillimit personal dhe social të nxënësve të tyre.

Puna në EQD/EDNJ ofron mundësinë për balancim të këtyre koncepteve konkurruese dhe për integrimin e tyre në një të kuptuar gjithëpërfshirës të rolit profesional të mësuesit si instruktor dhe si edukator në shumë aspekte.

Nuk mund të kërkojmë nga institucionet e arsimit të lartë (IAL) – institucione vërtet të pavarura dhe autonome – futjen e EQD/EDNJ të detyrueshëm në programet mësimore bazë për edukim të mësuesve apo në planet mësimore të kurseve të tyre. Megjithatë, ne ndjejmë që është me rëndësi të binden dekanët (apo ekuivalentët e tyre) për përparësitë profesionale pozitive të mbushjes së boshllëkut të përmendur më sipër dhe për integrim të EQD/EDNJ në objektivat themelore të institucioneve të tyre. Ky është një proces i të mësuarit që kërkon kohë dhe veprime të vazhdueshme. Sido që të jetë, mund të bëhen disa përpjekje për të përmirësuar pranimin e rëndësisë qendrore të EQD/EDNJ si pjesë e ekspertizës themelore të mësuesve fillestarë, dhe për përshtatjen dhe zhvillimin e mëtejmë të qasjeve të reja në përputhje me këto.

Trupat esencial për mbështetjen e implementimit të EQD/EDNJ janë institucionet e trajnimit të mësuesve. Dekanët e të gjitha departamenteve të kolegjeve dhe universiteteve për trajnim të mësuesve, si dhe zhvilluesit dhe liderët e kurseve, mund të ndërtojnë kapacitetet dhe qëndrueshmërinë në fushën e EQD/EDNJ me anë të përfshirjes së moduleve speciale në planet mësimore të mësuesve fillestarë dhe të atyre me përvojë, dhe përmes shënjimit të rëndësisë së këtyre kurseve. Për institucionet që merren me trajnimin e mësuesve, sfidë themelore mund të jetë njohja e EQD/EDNJ si një qasje e përgjithshme që duhet përfshirë në trajnimin e të gjithë mësuesve të ardhshëm pa marrë parasysh këndën apo specializimin e tyre. Është me rëndësi të gjenden mënyra për të informuar dhe ndikuar në kolegjet e edukimit të mësuesve në një shkallë të gjerë të lëndëve, për përfitimet e EQD/EDNJ dhe për zbatueshmërinë e tij në kontekst të lëndëve të ndryshme.

“Grafiku i progresit” në vijim është një seri i sugjerimeve për mënyrat në të cilat IAL-të mund të identifikojnë fazën në të cilën “janë”, në lidhje me të kuptuarit e tyre të – dhe angazhimin në– çështjet që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ, dhe më pas të fillojnë me implementimin e disa ndryshimeve në qasjet ekzistuese:

| | |
|---|---|
| **Hapi 1 (fokusimi)**<br>*Në kuadër të institucionet ka një qasje të limituar ndaj EQD/EDNJ, në esencën me një fokusim në mësuesit e historisë dhe të shkencave shoqërore; nuk ekziston një perspektive e përgjithshme e EQD/EDNJ. IAL-të janë në një fazë të hershme të zhvillimit të EQD/EDNJ dhe besojnë që mjafton të ekzistojë një mirëkuptim për edukimin që promovon EQD/EDNJ në kuptimin më të gjerë (për shembull, duke siguruar mundësi të barabarta të mësimdhënies e të mësimnxënies lidhur me metodologjitë interaktive dhe bashkëpunuese në lëndët specifike).* | **Provoni këtë:**<br>• fitoni më tepër njohuri për parimet dhe vlerat e EQD/EDNJ dhe për potencial që ai ofron për mësimdhënie dhe mësimnxënie më të mirë për edukimin e qytetarëve aktiv të së nesërmes;<br>• shfrytëzoni çdo mundësi për të ngritur ndërgjegjësimin për temat e EQD/EDNJ në lidhje me përmbajtjen e lëndës. Për shembull, mundohuni të trajtoni temat si drejtësia sociale, e drejta në edukim për të gjithë, përfshirja sociale dhe diversiteti, dhe të zhvilloni strategji për tu marrë me disa prej këtyre realiteteve. |
| **Hapi 2 (në zhvillim)**<br>*IAL-të dhe/apo mësuesit individual do ta shpijnë EQD/EDNJ përpara. Ka nisur të ketë një mirëkuptim më të thellë të përbashkët për potencialin e EQD/EDNJ në angazhimin e nxënësve dhe në përmirësimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre. Institucionet kanë nisur të identifikojnë programin bazë si pjesë të edukimit të të gjithë nxënësve.*<br>*Ka një interes të shtuar nga edukatorët tjerë të mësuesve dhe nga mësuesit e lëndëve për EQD/EDNJ.* | **Provoni këtë:**<br>• në këtë fazë, ruajtja dhe rritja e momentumit është thelbësore, duke i dhënë përkrahje të vazhdueshme përkushtimit që ndryshme rrezikon të dështojë;<br>• zhvilloni ekspertizën me përkrahjen e partnerëve të jashtëm;<br>• përkrahja e lidershipit të IAL është tepër e dëshirueshme, duke integruar në këtë mënyrë EQD/EDNJ në profilin institucional, dhe duke angazhuar sa më tepër mësimdhënës dhe nxënës që është e mundur. |
| **Hapi 3 (i përforcuar)**<br>*IAL-të kanë themeluar struktura efektive për EQD/EDNJ. Një program koherent është duke u zhvilluar si pjesë e edukimit të mësimdhënësve. Mësimdhënësit Individual bëjnë inkorporimin e aspekteve të EQD/EDNJ në disiplinat e tyre.*<br>*Institucionet ofrojnë një shkallë të gjerë të kurseve të mundësive për mësimdhënie dhe mësimnxënie aktive për të zhvilluar cilësitë e njohurive dhe të shkathtësive të nxënësve në EQD/EDNJ.* | **Provoni këtë:**<br>Ideja e pjesëmarrjes aktive/angazhimit demokratik eksplorohet pandërprerë. Çështjet kyçe mund të përfshijnë:<br>• zhvillimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në aktivitetet që kanë të bëjnë me EQD/EDNJ;<br>• përfshirjen e unioneve të nxënësve në organizimin e aktiviteteve me institucionin;<br>• krijimin e lidhjeve me agjencitë lokale, me anëtarët tjerë të komunitetit dhe me OJQ-të;<br>• njoftimin e nxënësve me aktivitetet planifikuese që lidhen me komunitetin (të mësuarit për projektet/shërbimin);<br>Puna praktika është shumë e dobishme këtu<br>• krijimin e rrjeteve me institucionet e ngjashme dhe me sektorin e edukimit joformal. |
| **Hapi 4 (avancuar)**<br>*IAL-të në këtë fazë kanë marrë masa efektive për EQD/EDNJ dhe mësuesit individual do të kenë zhvilluar disa qasje të sofistikuara dhe efektive të mësimdhënies dhe mësimnxënies për këtë temë. Ka një lidhje gjithnjë më të mirë ndërmjet programeve trajnuese para dhe gjatë shërbimit. Objektivat në këtë fazë kanë të bëjnë me novacionin dhe me strategjitë e reja për mbajtjen e momentumit dhe mbajtjen e përkushtimit në të gjitha nivelet e institucionit.* | **Provoni këtë:**<br>Caqet mund të përfshijnë:<br>• ndërtimi i ekipeve në radhët e kolegëve;<br>• mësimdhënia ndërdisiplinore e EQD/EDNJ;<br>• zhvillimi i kurseve të mëtejme që shpijnë drejt shkallës së magjistraturës në EQD/EDNJ;<br>• zgjerimi i mundësive trajnuese për EQD/EDNJ në trajnimin në shërbim të mësuesve;<br>• rritja e vlerësimit dhe e kontrollimit të rezultateve për të mbështetur praktikat e mësimdhënies. |

**Tabela 9: Grafiku i progresit për IAL-të**

## 8.4. Shënjimi i kompetencave të EQD/EDNJ për grupet e ndryshme të interesit

| Grupet e interesit | Njohuria dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ | Planifikimi, menaxhimi i klasës, mësimdhënia dhe vlerësimi | EQD/EDNJ në veprim – Partneritetet dhe përfshirja e komunitetit | Implementimi dhe vlerësimi i qasjeve me pjesëmarrje të EQD/EDNJ |
|---|---|---|---|---|
| Krijuesit e politikave | ➜ siguroni që rezultatet mësimore lidhur me EQD/EDNJ janë të artikuluara qartë brenda kornizave dhe udhëzimeve për planin mësimor;<br>➜ siguroni që liderët e shkollës do të trajnohen dhe informohen në hollësi<br>➜ alokoni resurset për të mbështetur trajnimin dhe reformën në këtë fushë. | ➜ siguroni që liderët nacional të arsimit do të nënvizojnë statusin dhe rëndësinë e EQD/EDNJ;<br>➜ vendosni EQD/EDNJ në zemër të planit mësimor;<br>➜ siguroni përkrahje për të gjithë mësuesit si dhe shembuj të praktikës së mirë në klasë në lidhje me EQD/EDNJ përmes materialeve të shtypura, videoregjistrimeve të rasteve dhe trajnimeve. | ➜ përkrahni OJQ-të me resurse dhe mundësoni iniciativat shkollore;<br>➜ krijoni regjistrat nacional dhe rajonal të grupeve përkrahëse të komunitetit;<br>➜ fusni statusin dhe legjitimitetin në fushatat anti diskriminim/anti-raciste. | ➜ jini të hapur ndaj angazhimit të nxënësve dhe dëgjoni zërat e nxënësve;<br>➜ promovoni këshillat e shkollës dhe mënyrat tjera për ti bërë shkollat më të hapura dhe demokratike; propozoni udhërrëfyes për këshillat gjithëpërfshirës së shkollës;<br>➜ ofron resurse dhe buxhet për trajnimin mbi EQD/EDNJ gjatë shërbimit. |
| Drejtorët | ➜ njihuni me shkakun pse kjo fushë ka rëndësi dhe me studimet e rasteve për ndryshimin që programet efektive të EQD/EDNJ mund të sjellin në shkolla;<br>➜ përkushtohuni ndaj trajnimit dhe përkrahjes për mësuesit në shkollën tuaj, kur ata zhvillojnë qasje të reja. | ➜ emroni një koordinator për EQD/EDNJ dhe i përkrahni ata në zhvillimin e praktikës në shkollë;<br>➜ zhvilloni strategji që shpijnë EQD/EDNJ përpara në lidhje me tri C-të e qytetarisë – kultura e mbarë shkollës, Plani mësimor dhe përfshirja e komunitetit. | ➜ inkurajoni në mënyrë aktive qasjet e reja dhe novatore për angazhim të komunitetit;<br>➜ bëni të qartë përkrahjen tuaj për projektet e qytetarisë aktive që zhvillojnë shkathtësitë, qëndrimet dhe prirjet e nxënësve në lidhje me EQD/EDNJ. | ➜ mirëprisni sugjerimet nga mësuesit dhe nxënësit për mënyrat e bërjes së shkollës një vend më të mirë;<br>➜ përkushtohuni personalisht për përfshirjen e EQD/EDNJ dhe qytetarisë aktive në planin vjetor të përmirësimeve të shkollës;<br>➜ tregoni përkrahjen tuaj për iniciativat e stafit tuaj duke mbrojtur punën e tyre para niveleve të larta të administratës. |
| Trajnuesit/ Edukatorët e mësuesve | ➜ përfshini referenca për përmbajtjen dhe formulimin e kompetencave në "njohuritë" për EQD/EDNJ në modulet e trajnimit përkatës para dhe pas shërbimit. | ➜ punoni në planifikimin për mësim të EQD/EDNJ;<br>➜ ofroni drejtim për mësuesit në mësimdhënien e çështjeve kundërthënëse. | ➜ ndihmoni mësuesit të mendojnë në hollësi sfidat praktike të EQD/EDNJ në veprim. Ofroni shembuj të studimit të rasteve dhe zgjidhje. | ➜ krijoni hapësirë për reflektim në kuadër të moduleve trajnuese;<br>➜ kërkoni të përshtatni mundësitë për trajnime me nevojat e shfaqura të mësuesve. |
| Mësuesit | ➜ aplikoni disa nga këshillat për njohuritë rreth EQD/EDNJ në klasë. | ➜ eksperimentoni me disa nga aktivitetet e sugjeruara në klasë;<br>➜ fusni kundërthënie dhe aktualitet në mësimet tuaja. | ➜ planifikoni një sekuencë të mësimeve që përfshijnë partnerin nga komuniteti dhe ku nxënësit mund ti mbrojnë ndryshimet. | ➜ qëndroni me mendje të hapur dhe reflektim. |

# 9. Konkluzion

Me shfaqjen e trendëve të reja shoqërore, dhe me ndryshimet në komunitetet lokale dhe ato globale, roli i edukimit po zhvillohet më tej për të plotësua nevojat e sotme të nxënësve. EQD/EDNJ është themel i paqes dhe dialogut evropian dhe botëror të së nesërmes. Çështjet e menaxhimit të konflikteve, respekti për diversitet, përgjegjësia ndërkulturore dhe të kuptuarit e të drejtave dhe përgjegjësive të qytetarëve janë çështje qendrore në mjediset shkollore.

Mësuesit tani kanë nevojë për kompetenca kolektive (drejt punës bashkëpunuese dhe inteligjencës kolektive) dhe kompetenca që zhvillohen vazhdimisht (drejt adaptimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional). Ky libër është një përpjekje për të njohur gjerësinë në rritje të përgjegjësive të mësuesit dhe një vegël për tu ndihmuar atyre në përvetësimin e shkathtësive të nevojshme – njohurive, shkathtësive dhe prirjeve – për ti mësuar të rinjtë që të kuptojnë botën e tyre dhe të bëhen qytetarë aktiv.

Përmes zhvillimit të katër fushave të kompetencave themelores (njohuria për EQD/EDNJ, praktika në klasë përfshirë këtu qasjet e programit të tërthortë, zhvillimi dhe vlerësimi i partneriteteve), shpresojmë që të gjithë mësuesit do të jenë në gjendje të përdorin këtë model të kompetencave për implementim të EQD/EDNJ në shkollë dhe në komunitet, dhe që të gjithë edukatorët e mësuesve do të motivohen të inkorporojnë EQD/EDNJ në planet mësimore të tyre. Ndonëse sot theksi vihet shpesh në të arriturat akademike, ky publikim demonstron rëndësinë e njëjtë të vlerave, shkathtësive sociale dhe të pjesëmarrjes që duhet të ofrohen nga edukimi për të rinjtë në shoqërinë tonë globale.

Shpresojmë që mundësia për kreativitet që ofrohet nga EQD/EDNJ, ashtu si është demonstruar këtu, do ti shpijë mësuesit dhe nxënësit në një rrugë të kënaqshme, ku ofrohet hapësirë për shprehje të ideve dhe idealeve. EQD/EDNJ është argëtues; në këtë drejtim, ai përbën një aset me rëndësi për mësuesit që duan të angazhojnë plotësisht nxënësit në mësimnxënien e tyre.

Duam të përfundojmë me një referencë për përfshirjen sociale. Lexuesi do të kuptojë, kur ai/ajo të ketë planifikuar një projekt të EQD/EDNJ, që synim parësor, që i përshkon të gjitha aktivitetet, është gjithëpërfshirja: praktikat e mira në EQD/EDNJ rezultojnë në klasa gjithëpërfshirëse, në shkolla gjithëpërfshirëse dhe në të rinj që përgatiten të veprojnë për një komunitet dhe shoqëri më gjithëpërfshirëse.

> Fëmijët kanë të drejtë të shprehin qëndrimet e tyre për të gjitha çështjet me interes për ta, dhe që pikëpamjet e tyre të merren seriozisht në pajtim me moshën dhe pjekurinë e tyre.
>
> Neni 12, Konventa e OKB për të drejtat e fëmijës

# 10. Shtojcë

## 10.1. Hapat për vetë-vlerësim

Hapat për vetë-vlerësim janë reflektim i gjetjeve nga kërkimet për shqetësimet e mësuesve në fazat e ndryshme të jetës së tyre profesionale.

Shqetësimi është definuar si një paraqitje e përzier e ndjenjave, preokupimeve, mendimeve dhe peshës që i jepet një çështje apo detyre të caktuar. Reiman dhe Thies-Sprinthall kanë identifikuar gjashtë kategori të shqetësimeve tek mësuesit, që i kanë shkallëzuar në katër hapa. Sipas këtyre fazave, sugjerohen disa veprime të mundshme për trajnim dhe vetë-zhvillim.

Në hapat 1 dhe 2, mësuesit kryesisht merren me veten; në hapin 3, mësuesit merren më tepër me detyrën që duhet kryer; dhe në hapin Step 4 mësuesit merren me ndikimin e mësimdhënies së tyre në nxënësit.

Ndjenjat e ndryshme që shfaqet brenda fazave.

| Hapat/fazat | Pyetjet përkatëse | Pyetjet përkatëse |
|---|---|---|
| **Hapi 1**<br>**Niveli i egos**<br>**Shqetësimi:**<br>**• mungesa e njohurisë.** | Nuk jam fare i interesuar në programin e ri. Ndjehem apatik. | • ofroni informata. |
| **Hapi 2**<br>**Niveli i egos**<br>**Shqetësimet:**<br>**• informatat;**<br>**• personale.** | Më duhen më tepër informata për … jam kureshtar.<br>Si do të ndikojë ky program i ri në mua?<br>A do ta pëlqejnë atë prindërit/nxënësit dhe a do të më respektojnë për përfshirjen dhe të provuarit e një gjëje të re? Ndjehem në siklet. | • Qartësoni pritjet dhe arsyen për novacionin;<br>• përshkruani si do të ndikojë novacioni në personin;<br>• dëgjoni në mënyrë aktive;<br>• organizoni një grup mbështetës të bazuar në shqetësimet. |
| **Hapi 3**<br>**Niveli i detyrës**<br>**Shqetësimi:**<br>**• menaxhimi.** | Nuk kam pasur asnjëherë kohë të mjaftueshme për të bërë krejt atë që nevojitet. Si mund ti përballoj të gjitha këto iniciativa të reja dhe punën me letra? Ndjehem i frustruar.<br>A do të humbas kontrollin e klasës nëse shfrytëzoj debatin për një çështje kundërthënëser?<br>Shqetësimet rreth mësimit dhe menaxhimit. | • ofroni shembuj konkret të menaxhimit;<br>• bëni që mësuesi të observojë një mësues tjetër të suksesshëm; |
| **Hapi 4**<br>**Niveli i ndikimit**<br>**Shqetësimet**<br>**• pasojat;**<br>**• bashkëpunimi;**<br>**• rifokusimi.** | A po krijojnë të gjithë nxënësit lidhjen me mësimin? Ndjehem i në mëdyshje dhe i suksesshëm. Mezi pres ta ndaj këtë me kolegët e mi. Ndjehem i emocionuar.<br>Do të doja të adaptoj dhe rikonceptoj mësimdhënien time dhe planin mësimor për ti plotësuar më mirë nevojat e nxënësve. Ndjehem me vetëbesim. | • Bashkëpunimi i jashtëm dhe lidhjet. |

**Tabela A1: Pyetësor për fazat e shqetësimeve**

53. Reiman, A.J., & Thies-Sprinthall, L., *Udhëheqja dhe mbikëqyrja e zhvillimit të mësuesve*. New York: Addison-Wesley Longman, 1998.

## 10.2. Rubrikat e vetë-vlerësimit

| Grupi | Kompetenca | Fokusimi | Në zhvillim | I përforcuar | I avancuar |
|---|---|---|---|---|---|
| **Njohuria dhe të kuptuarit e EQD/EDNJ** | Kompetenca nr. 1: synimet dhe qëllimet e EQD/EDNJ. | | | | |
| | Kompetenca nr. 2: kornizat kyçe ndërkombëtare për QD/EDNJ | | | | |
| | Kompetenca nr. 3: përmbajtja e programit mësimor të EQD/EDNJ | | | | |
| | Kompetenca nr. 4: kontekstet e implementimit të EQD/EDNJ | | | | |
| **Aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ në klasë dhe në shkollë** | Kompetenca nr. 5: planifikimi i qasjeve, metodave dhe mundësive për mësim | | | | |
| | Kompetenca nr. 6: inkorporomi i parimeve dhe praktikave të EQD/EDNJ në mësimdhënie | | | | |
| | Kompetenca nr. 7: themelimi i rregullave bazë për një etos pozitiv të shkollës | | | | |
| | Kompetenca nr. 8: zhvillimi i vargut të strategjive për të lehtësuar shkathtësitë për diskutim të nxënësve | | | | |
| | Kompetenca nr. 9: përdorimi i vargut të qasjeve ndaj vlerësimit | | | | |
| **Aktivitetet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies që zhvillojnë EQD/EDNJ përmes partneriteteve dhe komunitetit** | Kompetenca nr. 10: mjedisi mësimor që promovon përdorimin e burimeve të ndryshme | | | | |
| | Kompetenca nr. 11: puna bashkëpunuese me partneritetet e duhura me komunitetin | | | | |
| | Kompetenca nr. 12: strategjitë për sfidimin e të gjitha formave të diskriminimit | | | | |
| **Implementimi dhe vlerësimi i qasjeve të EQD/EDNJ me pjesëmarrje** | Kompetenca nr. 13: vlerësimi i përfshirjes së nxënësve në vendimmarrje | | | | |
| | Kompetenca nr. 14: modelimi i vlerave, qëndrimeve dhe prirjeve të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut | | | | |
| | Kompetenca nr. 15: shqyrtimi, monitorimi dhe vlerësimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimit të nxënësve | | | | |
| **Gjykimi i gjithmbarshëm** | **Të gjitha kompetencat** | | | | |

Tabela A2: Rubrikat e vetë-vlerësimit

## 10.3. Plani i veprimit për zhvillim profesional (plani i veprimit për vetë-vlerësim të EQD/EDNJ për mësuesit individual dhe edukatorët e mësuesve)

| **Fusha për zhvillim** | **Veprimet** | **Kush?** | **Kur?** | **Kriteret e suksesit për caqet që janë përmbushur** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

**Tabela A3: Model për planin e veprimit të mësuesve për qëllimet e zhvillimit profesional**

# 11. Referencat dhe resurset

## 11.1. Resurset e cituara në doracak

### Referencat e cituara në parathënie

Backman, E. dhe Trafford, B., *Qeverisja demokratike e shkollave*, Publikimet e Këshillit të Evropës, Strasburg, 2007.

Bîrzea, C. et al., *Studim mbarë-evropian për edukimin për politikat e qytetarisë demokratike*, Publikimet e Këshillit të Evropës, Strasburg 2004.

Bîrzea, C. et al., *Vegël për sigurim të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike në shkolla*, Publikimet e Këshillit të Evropës, Strasburg, 2005.

Këshilli i Evropës, Edukimi për qytetari demokratike dhe të drejta të njeriut, *Programi i aktiviteteve* (2006-2009), "të mësuarit dhe të jetuarit e demokracisë për të gjithë", DGIV/EDU/CAHCIT (2006) 5, 14 Mars 2006.

Eurydice, *edukimi për qytetari në shkollat e Evropës*, 2005.

Huddleston, T., *Nga zëri i studentit tek përgjegjësia e përbashkët: praktika efektive në qeverisjen demokratike të shkollës në shkollat evropiane*, Rrjeti i fondacioneve evropiane dhe i Këshillit të Evropës 22 Maj 2007.

Huddleston, T. (ed.), *vegël për trajnimin e mësuesve për edukimin për qytetari demokratike dhe të drejta të njeriut*, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2005.

Naval, Print dhe Iriate, "edukimi qytetar në Spanjë: shqyrtim kritik i politikës", (Online) *Buletini i edukimit në shkencat shoqërore*; dhe Osler e Starkey, kapitulli 10, 2005 (shih më poshtë, Grupi A).

### Referencat e cituara në Hyrje

Bîrzea, C. et al., *Vegël për sigurim të cilësisë së edukimit për qytetari demokratike në shkolla*, Publikimet e Këshillit të Evropës, Strasburg.

Bolivar, *Non scholae sed vitae discimus: limites y problemas de la transversalidad* [Limitet dhe problemet e qasjes së programit të tërthortë] *Revista de Educacion*, 309, pp. 23-65, Enero-Abril 1995.

Komisioni Evropian, drejtoria e përgjithshme e edukimit dhe kulturës, *parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimet e mësuesve*, prezantuar në Konferencën testuese evropiane për parimet e përbashkëta evropiane për kompetencat dhe kualifikimet e mësuesve, Bruksl, 20-21 qershor 2005.

Kerr, D., "Qytetaria: lokale, nacionale dhe ndërkombëtare", në Gearon, L. (ed.), *Të mësuarit për mbajtjen e mësimit për qytetari në shkollë të mesme*, Londër, 2003.

OECD, "Definimi dhe përzgjedhja e kompetenca kyçe", DeSeCo publications, 2005, www.oecd.org/dataoecd/47/61/35070367.pdf.

ORE (Observatoire des Reformes en Education), *Rishikimi i konceptit të kompetencës si një parim organizues për programet e studimit: nga kompetenca në veprim kompetent*, ORE, Montreal, 2006.

Weinert, Franz E., *Konceptet e kompetencës*, Instituti Max Planck për kërkime psikologjike, Munih, 1999.

## Referencat e cituara në pasqyrën e përgjithshme


Crick, B., *Edukimi për qytetari dhe mësimdhënia e demokracisë në shkolla*, raporti Crick, Londër: QCA, 1998.

Davies, I., "Cila njohuri e lëndës nevojitet për të mbajtur mësim për qytetarinë dhe si mund të promovohet ajo? Dokument diskutimi për shqyrtim nga edukatorët e mësuesve të rinj", 2003, Citized website: www.citized.info.

Habermas J., *Teoria e veprimit komunikative*, Vëllimi 1, Kembrixh, Britani e Madhe: Polity Press, 1984.

Habermas, J., *Teoria e veprimit komunikative*, Vëllimi 2, Kembrixh, Britani e Madhe: Polity Press, 1987.

Luke, A., Muspratt, S., & Freebody, P. (eds), *Konstruktimi i alfabetizmave kritik: praktikë tekstuale e mësimdhënies dhe mësimnxënies*, Cresskill NJ: Hampton Press, 1997.

McNamara, D., "Nohuria për lëndën dhe aplikimi i saj: problemet dhe mundësitë për edukatorët e mësuesve", *Buletini i edukimit për mësimdhënie*, 17 (2), fq. 113-128, 1991.

Reece, P. dhe Blackall, D., "Bërja e lajmit: alfabetizmi për qytetari", http://makingnewstoday.uow.edu.au (March 2008).

Schulman, L., "Ata që kuptojnë: rritja e dijes në mësimdhënie", *Educational Researcher*, 15, fq. 4-14, 1986.


## Referencat për grupin A


Audigier, F., *Konceptet bazë dhe kompetencat themelore për edukimin për qytetari demokratike*, Këshilli i Evropës, 2000.

Banks, J.A., *Doracak i kërkimit rreth edukimit multikulturor*, Simon & Schuster/Macmillan, New York, 1995.

Davies, I., "Cila njohuri e lëndës nevojitet për të mbajtur mësim për qytetarinë dhe si mund të promovohet ajo? Dokument diskutimi për shqyrtim nga edukatorët e mësuesve të rinj", Citized website: www.citized.info, 2003.

McNamara, D., "Nohuria për lëndën dhe aplikimi i saj: problemet dhe mundësitë për edukatorët e mësuesve", *Buletini i edukimit për mësimdhënie*, 17(2), 1991.

Naval, C., Print, M. and Veldhuis, R., "Edukimi për qytetari demokratike në Evropën e re", *Buletini evropian i edukimit*, 37(2), 2002.

Osler, A. dhe Starkey, H., "Edukimi për qytetari demokratike: shqyrtim i hulumtimeve, politikës dhe praktikës 1995-2005", *Academic Review*, BERA, 2005.

QCA, *Edukimi për qytetari dhe mësimdhënia e demokracisë në shkolla*, raporti Crick, QCA, London, 1998.

Shulman, L., "Ata që kuptojnë: rritja e dijes në mësimdhënie", *Educational Researcher*, 15, pp. 4-14, 1986.

Sliwka, E., Diedrick, M. dhe Hofer, M. (eds), *Edukimi për qytetari – Teoria, kërkimet, praktika*, Waxmann, Münster, 2006.

Torney-Purta, J. et al., *Qytetaria dhe edukimi në njëzet e tetë vende: njohuria qytetare dhe angazhimi në moshën katërmbëdhjetë vjeçare*, Asociacioni ndërkombëtar për vlerësimin e arritjeve në arsim

(IEA), Amsterdam, 2001.

Wieviorka, M., *Arena e racizmit*, Sage, London, 1995.

**Referencat për grupin B**

Backman, E. dhe Trafford, B., *Qeverisja demokratike e shkollave*, Publikimet e Këshillit të Evropës, Strasburg, 2007.

Black, P. et al., *Vlerësimi për mësim: vënia e tij në praktikë*, Open University Press, New York, 2003.

Cunningham. J., "Të drejtat, përgjegjësitë dhe etosi i shkollës", in Baglin Jones, E. and Jones, N. (eds), *Edukimi për qytetari: idetë dhe perspektivat për studim* programit të tërthortë, Kogan Page, London,1992. Devries, R. dhe Zan, B., *klasat morale, fëmijët moral: krijimi i atmosferës krijuese në edukimin e hershëm*, Columbia University Press, New York, 1994.

Duerr, K., Spajic-Vrkasˇ, V. dhe Ferreira Martins, I., *Strategjitë për mësim të qytetarisë demokratike*,
Këshilli i Evropës, 2000.

Goleman, D., *Inteligjenca emocionale*, Bantam Books, New York, 1995.

QCA, *Edukimi për qytetari dhe mësimdhënia e demokracisë në shkolla*, raporti Crick, QCA, Londër, 1998.

Rogers, B., *Gjuha e diciplinës: qasje praktike ndaj menaxhimit efektiv të klasës*,
Northcote House Publishers, Plymouth, 1994.

**Referencat për grupin C**

Ajegbo, K., "Shqyrtim i programit mësimor: diversiteti dhe qytetaria", DfES, Londër, 2007.

Billig, S. dhe Shelley, H., *Hulumtim në shkollat K-12 i mësimit të shërbimit me bazë në shkollë. Mbledhja e provave*. PhiDelta Kappan, Science Education, Bloomington, në një studim të sponsoruar nga Korporata Carnegie Corporation e Nju Jorkut dhe CIRCLE (Qendra për informim dhe kërkim në mësimin dhe angazhimin qytetar), 2000.

Citizenship Foundation, *Edukimi për qytetari, diversitet dhe barazi racore: udhërrëfyes praktik*, Citizenship Foundation, Londër, 2003.

Këshilli i Evropës, "Të mësuarit dhe të jetuarit e demokracisë. Dokument koncept", Komiteti Ad hoc i ekspertëve për Vitin evropian të qytetarisë përmes edukimit, CAHCIT, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2005.

Dewey, J., *Demokracia dhe edukimi*, NY Free Press, Nju Jork (1916) 1966. Poashtu mund të gjendet në Google books: http://books.google.com.

Donnelly, C., "Cili çmim për harmoninë? Metodat e mësuesve për bartjen e etosit të tolerancës dhe respektit për diversitetin në një shkollë të integruar në Irlandën e Veriut", *Educational Research*, Vëllimi46 (1), 2004.

Giroux, H., *Kultura e ideologjisë dhe procesi i shkollimit*, Temple University Press, Philadelphia/ Falmer Press, Londër, 1981.

Gearon, L., "OJQ-të dhe edukimi: disa gjykime paraprake", *Reflecting Education*, 2 tetor 2006.

Gowran, S., Hapja e dyerve*: partneriteti i shkollës dhe komunitetit në ndërgjegjësim për pushtetin dhe iniciativat e edukimit social*, draft udhëzime për zhvillim të partneritetit, Njësia për zhvillim të programit mësimor, CDVEC dhe Agjencia për luftim të varfërisë, Dublin, 2004.

Hart, R., *Pjesëmarrja e fëmijëve: teoria dhe praktika e përfshirjes së qytetarëve të rinj në zhvillimin e komunitetit dhe në kujdesin për mjedisin*, Earthscan, Londër, 1997.

Held, D., "Demokracia dhe rendi i ri ndërkombëtar", në Achibugi, D. dhe Held, D. (eds), *Cosmopolitan democracy*, Polity Press, Cambridge, 1995.

Osler, A., "Raporti Crick: diferenca, barazia dhe drejtësia racore", *Curriculum Journal*, 11(1), 2000.

Osler, A. dhe Starkey, H.,"Të mësuarit për qytetari kozmopolite: debate teorike dhe përvojat e të rinjve", *Educational Review*, 55 (3),2003.

QCA, *Luaj pjesën tënde: qytetaria pas moshës 16 vjeçare*, QCA, Londër, 2004.

Zacharakis-Jutz, J. dhe Flora, J., "Çështjet dhe përvojat e përdorimit të hulumtimit me pjesëmarrje për forcim të kapitalit social në zhvillimin e komunitetit", në Armstrong, P., Millerm, N. dhe Zukas, M. (eds), *kalimi i kufijve, thyerja e barrierave*, Universiteti i Londrës 1997.

## Referencat për grupin D

Backman, E. dhe Trafford, B., *Qeverisja demokratike e shkollave*, Publikimet e Këshillit të Evropës,

Strasburg, 2007.

Bandura, A., *Themelet sociale të mendimit dhe të veprimit: teoria e njohjes sociale*, Prentice-Hall, Englewood Cliffs, NJ, 1986.

Barell, J., *Mësimdhënia për futje në mendime. Strategji të klasës për përmirësim të zhvillimit intelektual*, Longman, Londër, 1991.

Brookfield, S.D., *Si të bëheni mësues me reflektim kritik*, Jossey-Bass, San Francisco, 1995.

Goodlad, J., *një vend i quajtur shkollë*, McGraw-Hill, Nju Jork, 1984. Në dispozicion në Google books: http://books.google.com.

Huddleston, T. (ed.), *vegël për trajnimin e mësuesve për edukimin për qytetari demokratike dhe të drejta të njeriut*, Këshilli i Evropës, Strasburg 2005.

Huddleston, T. dhe Kerr, D. (eds), *Gjetja e kuptimit të qytetarisë: doracak për zhvillimin profesional të vazhdueshëm*, Hodder Education, Londër, 2006.

Rowe, D., *Puna e këshillave të shkollës*, Citizenship Foundation, Londër, 2003.

Zeichner, K., "Praktikuesi reflektues", në Reason, P. dhe Bradbury, H. (eds), *Doracak për kërkimet rreth veprimit: pyetje dhe praktikë me pjesëmarrje*, Sage, Londër, 2001.

## Referencat e cituara në Shtojcë

Reiman, A.J., & Thies-Sprinthall, L., *Udhëheqja dhe mbikëqyrja e zhvillimit të mësuesve,* Addison-

Wesley LongmanReiman, Nju Jork, 1998.

## 11.2. Resurset tjera

### Resurset për vlerësim dhe kontrollim

Black, P. et al., “Natyra dhe vlera e vlerësimit për mësim”, 2003, www.umds.ac.uk/content/1/c4/73/57/formative.pdf.

Jerome, L., “Vlerësim i edukimit për qytetari ”, 2003, www.citized.info/pdf/commarticles/Lee_Jerome_Assessment_workshop.pdf.

Klenowski, V., *zhvillimi i portofolave për mësim dhe vlerësim: proceset dhe parimet*, RoutledgeFalmer, Londër, 2002.

QCA, *Vlerësimi i qytetarisë*, HMSO, Londër, 2006.

### Resurset për trajtim të çështjeve kundërthënëse

Citized, “raport i konferencës për mësimdhënien e çështjeve kundërthënëse”, 2006, www.citized.info/pdf/conferences/31_03_06report.pdf.

Citizenship Foundation, *Mësimdhënia për Irakun dhe për çështjet tjera kundërthënëse*, 2003, www.citizenshipfoundation.org.uk/main/resource.php?s124

Claire, H. Dhe Holden, C. (eds), *Sfida e mësimit të çështjeve kundërthënëse*, Trentham Books, Oakhill, 2007.

Gollob, R. and Krapf, P., *të jetuarit në demokraci – plane mësimore për nivelin e mesëm të ulët* (EQD/EDNJ Vëllimi III), Këshilli i Evropës, Strasburg, 2008.

OSCE, “Parimet drejtuese të Toledo – Mësimdhënia për religjionet dhe besimet”, 2008. www.osce.org/publications/odihr/2007/11/28314_993_en.pdf.

## Agjentët e shitjes për publikimet e Këshillit të Evropës
## Agents de vente des publications du Conseil de l'Europe

**BELGJIKË**

*La Librairie Européenne The European Bookshop Rue de l'Orme, 1 BE-1040 BRUXELLES Tel.: +32 (0)2 231 04 35 Fax: +32 (0)2 735 08 60 E-mail: order@libeurop.be http://www.libeurop.be*

*Jean De Lannoy/DL Services Avenue du Roi 202 Koningslaan BE-1190 BRUXELLES Tel.: +32 (0)2 538 43 08 Fax: +32 (0)2 538 08 41 E-mail: jean.de.lannoy@dl-servi.com http://www.jean-de-lannoy.be*

**BOSNJË DHE HERCEGOVINË**

*Robert's Plus d.o.o. Marka Maruliça 2/V BA-71000, SARAJEVO Tel.: + 387 33 640 818 Fax: + 387 33 640 818 E-mail: robertsplus@bih.net.ba*

**KANADA**

*Renouf Publishing Co. Ltd. 1-5369 Canotek Road CA-OTTAWA, Ontario K1J 9J3 Tel.: +1 613 745 2665 Fax: +1 613 745 7660 Toll-Free Tel.: (866) 767-6766 E-mail: order.dept@renoufbooks.com http://www.renoufbooks.com*

**KROACI**

*Robert's Plus d.o.o. Marasoviçeva 67 HR-21000, SPLIT Tel.: + 385 21 315 800, 801, 802, 803 Fax: + 385 21 315 804 E-mail: robertsplus@robertsplus.hr*

**REPUBLIKË ÇEKE**

*Suweco CZ, s.r.o. Klecakova 347 CZ-180 21 PRAHA 9 Tel.: +420 2 424 59 204 Fax: +420 2 848 21 646 E-mail: import@suweco.cz http://www.suweco.cz*

**DANIMARKË**

*GAD Vimmelskaftet 32 DK-1161 KØBENHAVN K Tel.: +45 77 66 60 00 Fax: +45 77 66 60 01 E-mail: gad@gad.dk http://www.gad.dk*

**FINLANDË**

*Akateeminen Kirjakauppa PO Box 128 Keskuskatu 1 FI-00100 HELSINKI Tel.: +358 (0)9 121 4430 Fax: +358 (0)9 121 4242 E-mail: akatilaus@akateeminen.com http://www.akateeminen.com*

**FRANCË**

*La Documentation française (diffusion/distribution France entière) 124, rue Henri Barbusse FR-93308 AUBERVILLIERS CEDEX Tél.: +33 (0)1 40 15 70 00 Fax: +33 (0)1 40 15 68 00 E-mail: commande@ladocumentationfrancaise.fr http://www.ladocumentationfrancaise.fr*

*Librairie Kléber 1 rue des Francs Bourgeois FR-67000 STRASBOURG Tel.: +33 (0)3 88 15 78 88 Fax: +33 (0)3 88 15 78 80 E-mail: librairie-kleber@coe.int http://www.librairie-kleber.com*

**GJERMANI/AUSTRI**

*UNO Verlag GmbH August-Bebel-Allee 6 DE-53175 BONN Tel.: +49 (0)228 94 90 20 Fax: +49 (0)228 94 90 222 E-mail: bestellung@uno-verlag.de http://www.uno-verlag.de*

**GREQI**

*Librairie Kauffmann s.a. Stadiou 28 GR-105 64 ATHINAI Tel.: +30 210 32 55 321 Fax.: +30 210 32 30 320 E-mail: ord@otenet.gr http://www.kauffmann.gr*

**HUNGARI**

*Euro Info Service Pannónia u. 58. PF. 1039 HU-1136 BUDAPEST Tel.: +36 1 329 2170 Fax: +36 1 349 2053 E-mail: euroinfo@euroinfo.hu http://www.euroinfo.hu*

**ITALI**

*Licosa SpA Via Duca di Calabria, 1/1 IT-50125 FIRENZE Tel.: +39 0556 483215 Fax: +39 0556 41257 E-mail: licosa@licosa.com http://www.licosa.com*

**MEKSIKË**

*Mundi-Prensa México, S.A. De C.V. Río Pánuco, 141 Delegacíon Cuauhtémoc MX-06500 MÉXICO, D.F. Tel.: +52 (01) 55 55 33 56 58 Fax: +52 (01) 55 55 14 67 99 E-mail: mundiprensa@mundiprensa.com.mx http:// www.mundiprensa.com.mx*

**HOLANDË**

*Roodveldt Import BV Nieuwe Hemweg 50 NL-1013 CX AMSTERDAM Tel.: + 31 20 622 8035 Fax.: + 31 20 625 5493 Website: www.publidis.org Email: orders@publidis.org*

**NORVEGJI**

*Akademika Postboks 84 Blindern NO-0314 OSLO Tel.: +47 2 218 8100 Fax: +47 2 218 8103 E-mail: support@akademika.no http://www.akademika.no*

**POLONI**
*Ars Polona JSC 25 Obroncow Street PL-03-933 WARSZAWA Tel.: +48 (0)22 509 86 00 Fax: +48 (0)22 509 86 10 E-mail: arspolona@arspolona.com.pl http://www.arspolona.com.pl*

**PORTUGALI**
*Livraria Portugal (Dias & Andrade, Lda.) Rua do Carmo, 70 PT-1200-094 LISBOA Tel.: +351 21 347 42 82 / 85 Fax: +351 21 347 02 64 E-mail: info@livrariaportugal.pt http://www.livrariaportugal.pt*

**FEDERATË RUSE**
*Ves Mir 17b, Butlerova ul. RU-101000 MOSCOW Tel.: +7 495 739 0971 Fax: +7 495 739 0971 E-mail: orders@vesmirbooks.ru http://www.vesmirbooks.ru*

**SPANJË**
*Mundi-Prensa Libros, s.a. Castelló, 37 ES-28001 MADRID Tel.: +34 914 36 37 00 Fax: +34 915 75 39 98 E-mail: libreria@mundiprensa.es http://www.mundiprensa.com*

**ZVICËR**
*Planetis Sàrl 16 chemin des pins CH-1273 ARZIER Tel.: +41 22 366 51 77 Fax: +41 22 366 51 78 E-mail: info@planetis.ch*

**MBRETËRI E BASHKUAR**
*The Stationery Office Ltd PO Box 29 GB-NORWICH NR3 1GN Tel.: +44 (0)870 600 5522 Fax: +44 (0)870 600 5533 E-mail: book.enquiries@tso.co.uk http://www.tsoshop.co.uk*

**SHTETET E BASHKUARA dhe KANADA**
*Manhattan Publishing Company 468 Albany Post Road US-CROTON-ON-HUDSON, NY 10520 Tel.: +1 914 271 5194 Fax: +1 914 271 5856 E-mail: Info@manhattanpublishing.com http://www.manhattanpublishing.com*

**Publikimet e Këshillit të Evropës**
*FR-67075 STRASBOURG Cedex Tel.: +33 (0)3 88 41 25 81 – Fax: +33 (0)3 88 41 39 10 – E-mail: publishing@coe.int – Website: http://book.coe.int*